

**Veprat penale kundër detyrës zyrtare në Kosovë , gjatë periudhës
kohore 2004 - 2014**

Doktoranti
Fatmir Çollakaj

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Fakultetin e Drejtësisë me profil E Drejta Publike për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr. Ass. Lulzim Tafa

Numri i fjalëve: 58 000

Tiranë, Gusht 2016

ABSTRAKTI

Keqpërdorimi me detyrë zyrtare , ku bën pjesë edhe korupsioni si njëra ndër veprat penale të kategorisë së tillë , nuk është një dukuri e re. Kjo dukuri është e pranishme gati në çdo shtet, madje edhe pavarësisht shkallës së tij të zhvillimit si dhe nivelit të demokracisë. Siç edhe përkon me natyrën njerëzore, keqpërdorimi i detyrës zyrtare manifestohet e shtrihet diku në relacionin ndërmjet racionalitetit që imponojnë ligjet në njërën anë, dhe në anën tjetër “vullnetit” të individit që të tejkalojë normat shoqërore që janë si produkt i botëkuptimeve socio etike.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, këto shkelje të ligjit hyjnë në kuadër të kategorisë të veprave penale kundër detyrës zyrtare, të përfshira brenda kapitullit XXIX. Ky studim merret me këtë kategori të veprave penale, duke u përpjekur që përmes një hulumtimi cilësor empirik e teorik , të sqaroj tendencën e rritjes së intenzitetit , shkaqet si dhe performancën e institucionëve përkatëse në luftimin dhe parandalimin e kësaj dukurie dukurie në Kosovë. Gjithsesi, kryesit e veprave penale kundër detyrës zyrtare , dëshirojnë një kuadër ligjor të brishtë, kurse mbrojtja nga to dhe parandalimi dhe luftimi i këtyre veprave kërkon një sistem të konsoliduar ligjor. Kosova aktualisht është ende në procesin e konsolidimit institucional, për çka në këtë drejtim ka edhe mbështetjen e një legjislacioni modern, i cili i është përshtatur plotësisht të drejtës evropiane, logjikshëm pasi që synimi dhe njëherazi prioritet i shtetit të ri, është anëtarësimi në Unionin Evropian.

A është keqpërdorimi i detyrës zyrtare sot më i theksuar në Kosovë ? Apo ndoshta është një trend i pritshëm në kuadër të rrethanave në një vend i cili po përjeton tranzicionin e stërzgatur të pasluftës. Është fakt, se përkundër angazhimeve institucionale për luftimin e tij, kurse këto angazhime së paku ishin deklarative, keqpërdorimi i detyrës zyrtare vështirë të thuhet se ka tendencën e uljes. Megjithëse në këtë aspekt, posaçërisht në ca vite të fundit, në Kosovë janë hartuar edhe strategji të posaçme të veprimit.

ABSTRACT

Misuse of official position, including corruption as one of criminal acts, is not a new phenomenon. Such a misuse of official position is present in almost all the countries, regardless of their development and the level of democracy. As it is in the human nature, misuse of office is manifested and extended due to the relation between the rationality that the laws impose, on the one hand, and the will of the individuals to surpass and violate the civil norms which result as a product of socio-ethic viewpoints.

According to the Criminal Code of the Republic of Kosovo, chapter XXIX respectively, such violations of law enter into the category of criminal acts against office. This study covers this category of criminal acts, attempting to explain, through an empirical, qualitative and theoretical research, the tendency of the increase of intensity, the reasons as well as the performance of the institutions responsible for the combat and prevention of such a phenomenon in Kosovo. The persons who commit such criminal acts against office take advantage of a fragile legal framework, whereas preventing and combating it requires a consolidated legal system. Kosovo is currently in the process of institutional consolidation with the assistance of a modern legislation in line with European Law considering that Kosovo aspires to become a European Member State.

Is the misuse of official position more evident in Kosovo nowadays? Is it perhaps an expected trend in a situation when the country is in the phase of a prolonged post-war transition? It is evident that the misuse of office position is not declining, despite the commitments on the part of the institutions to prevent and combat it as well as the governments' special action strategies.

FALENDERIM

Në gjithë punën, studimin dhe realizimin e këtij projekti, apo punimit tim të temës, ndjejë obligim dhe arsye, por edhe kënaqësi të shpreh mirënjohjen dhe respektin për njerëz dashamirë të mijë, posaçërisht mentorin tim, Prof. Dr. Lulzim Tafa, i cili gjatë fazave të këtij procesi më ka këshilluar e ndihmuar shumë, deri në fazën e fundit të përmbylljes së punimit.

Me shumë respekt, ndjejë kënaqësi të falënderoj familjen time, të cilët me mund dhe sakrificë bënë të mundur që unë sot të jem këtu.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I.....	9
Hyrje	
1.1.Shtrimi i problemit.....	12
1.2. Qëllimi i studimit.....	13
1.3 . Rëndësia e studimit	13
1.4. Hipotezat e punimit dhe pyetjet kërkimore.....	15
1.5 Metodatat dhe metodologjia e kërkimit	14
1.6. Mundësitë dhe kufizimet	16
1.7. Përmbajtja e punimit doktoral sipas kapitujve	17
KAPITULLI II	19
Keqpërdorimi i detyrës zyrtare në të kaluarën dhe sot	19
2.1.Trajtimi i keqpërdorimit me pushtetin në të kaluarën.....	19
2.2. Vështrim historik i dukurisë së keqpërdorimit të detyrës zyrtare	22
2.2.1. Ligji mbi mbrojtjen e të mirave materijale i vitit 1946.....	22
2.2.2. Ligji mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare i vitit 1948.....	23
2.2. 3. Ligji Penal i Krahinës Autonome të Kosovës , viti 1997	24
2.3. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare si sfidë globale	25
Kapitulli III.....	32
E Drejta Ndërkombëtare dhe Legjislacioni në Kosovë	32
3.1. E drejta ndërkombëtare	32
3.2. Legjislacioni i Unionit Evropian.....	38
3.3. Korniza kushtetuese e Kosovës	43

3.4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës	44
3.5. Legjislacioni Penal në Kosovë	46
Kapitulli IV	50
Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare	50
4.1. Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Republikën e Sllovenisë ...	50
4.2. Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në R. e Gjermanisë.....	52
4.3. Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Britaninë e Madhe	53
4.4. Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në R. e Shqipërisë.....	54
<u>KAPITULLI V</u>	<u>58</u>
5.1. Përkufizimi i veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare	579
5.1.1. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar	70
5.1.2. Konflikti i interesit	74
5.1.3 Përvehtësimi në detyrë	75
5.1.4. Mashtrimi në detyrë	78.
5.1.5. Përdorimi i pa autorizuar i pasurisë.....	79
5.2 Marrja dhe dhënja e mitos	80
5.3. Ushtrimi i ndikimit	87
5.4. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore.....	90
5. 5. Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	93.
5.6. Falsifikimi dhe manipulimi me dokumente zyrtare.....	94
5.7 Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme.....	96
5. 8 Përvehtësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo egzekutimit të vendimit gjyqësor.....	98
5.9 Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave , i dhuratave , i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare	99
5.10. Mekanizmat institucional për luftimin e korupsionit	102
Kapitulli VI. Error! Bookmark not defined.	
Tregues statistikorë dhe vështrim empirik.....	114
6.1. Vështrim i përgjithshëm.....	114

6.2. Aktiviteti i Gjykatave	116
6. 3. Raportimet e Prokurorisë mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare	119
6.4. Raportimet e Policisë mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare	131
6 . 5. Aktiviteti i Agjencisë Kundër Korrupsion në hetimi e rasteve korruptive gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.....	136
Kapitulli VII	
Praktika gjyqësore në Republikën e Kosovës lidhur me procesimin dhe gjykimine korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare.....	148
7.1 Vështrim i përgjithshëm.....	148
7.2 Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e shpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar neni 422 i KPK , Gjykata Themelore Prishtinë , Departamenti për krime të rënda	149
7.3. Vështrim analitik i një aktgjykimi nga vepra penale përvetësimi në detyrë neni 425 i KPK , Gjykata Themelore Prishtinë , Departamenti për krime të rënda	152
74. Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e marrjes së ryshfetit neni 428 i KPK , Gjykata Themelore Prishtinë , Departamenti për krime të rënda...	155
7.5 Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e marrjes së ryshfetit neni 428 i KPK , Gjykata Themelore Ferizaj , Departamenti për krime të rënda...	157
7.6 Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e ushtrimit të ndikimit neni 431 i KPK , Gjykata Themelore Ferizaj , Departamenti për krime të rënda .	160
7.7 Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e përvetësimit në detyrë neni 425 i KPK , Gjykata Themelore Ferizaj , Departamenti për krime të rënda.....	162
7.8 Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e ushtrimit të ndikimit neni 431 i KPK , Gjykata Themelore Ferizaj , Departamenti për krime të rënda.....	164
7.9 . Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e dhënja e ryshfetit neni 429 i KPK , Gjykata Themelore Ferizaj , Departamenti për krime të rënda.....	166
7.10. Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e përvetësimit në detyrë neni 425 i KPK , Gjykata Themelore Ferizaj , D. për krime të rënda.....	168

7.11 Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e shpërdorimit të pozites apo autoritetit zyrtar neni 422 i KPK , Gjykata Themelore Ferizaj , Departamenti për krime të rënda 171

7.12. Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e nxjerrjes së kundëligjshme të vendimeve gjyqësore neni 432 i KPK , Gjykata Themelore Ferizaj , Departamenti për krime të rënda173

Përfundimi 175

Rekomandime..... 176

Bibliografia 181

KAPITULLI I

Hyrje

Dukuritë shoqërore , në stadin e tanishëm të zhvillimit shumdimensional të shoqërisë meritojnë një studim të thellë , në njërën anë për të kënaqur kureshtjen dhe plotësuar nevojat e gnosisit tonë , e në anën tjetër për të qenë njohuria në shërbim të përmirësimit të standardit të jetës dhe krijimit të mirëqenjes së qëndrueshme të një shoqërie. Edhe ky projekt i studimit , ky punim doktore me ton të eksplorativ dhe studimor prezencën , intenzitetin , modalitetet e një dukurie negative , kategoritë të veprave penale siq është keqpërdorimi me detyrë zyrtare brenda një periudhe të caktuar kohore . Qdo dukuri e ka edhe gjenezën e vet , rrjedhën apo fazat e saj . Për të përcjellur , përfshirë sa më mirë dukurinë e hulumtuar edhe studimet ndahen në kapituj apo pjesë. Qëllimshëm ky studim është ndarë në disa pjesë për të ardhur gradualisht te spektri statistikorë-empirik, analiza këto që janë barometri më i saktë i shprehur në vlera numerike të nivelit të veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Statistikat e prezantuara janë marrë nga burime zyrtare të organeve kompetente, siç janë Gjykatat, Prokuroria e Shtetit, Policia e Shtetit, Agjencia Kundër Korrupsionit, por edhe nga burime të tjera aty ku ato konsiderohen relevante dhe me interes për të shtjelluar më tej këtë dukuri e kompletuar këtë studim. Sidoqoftë për të ardhur deri aty, ky studim fillon me një kapitull, ku fenomeni i keqpërdorimit të detyrës zyrtare shqyrtohet nga një këndvështrim historik më i thellë, i cili arrin të na bind se fenomeni nuk i takon thjeshtë botës të sotme moderne, e as nuk është i shpikur nga njerëzit e saj. Në fakt, ai ishte i pranishëm, pavarësisht vendit dhe kulturave, kurse si i tillë ai edhe ishte preokupim në të gjitha kohërat. Në këtë kapitull është e pashmangshme edhe një qasje e cila shpalos perceptimin teorik të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, kurse siç do të shohim qysh moti kishte përpjekje të organizuara nga ana e shteteve, mekanizma ligjorë dhe udhëzime të sakta të dhëna administratës për ta luftuar atë.

Siç edhe do të tregohet gjatë rrjedhës së studimit, jo gjithmonë objekt i veprave penale që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e detyrës zyrtare janë zyrtarët, në raste të caktuara janë edhe qytetarët të cilët i mundësojnë një zyrtari publik që të korruptohet. E këtu, bëhet fjalë edhe për persona fizik, sikurse për persona juridik, respektivisht përfaqësues të operatorëve ekonomik të ndryshëm të cilët vijnë në shprehje në kuadër të relacioneve

të shumëllojshme me institucionet publike, si p.sh me rastin e tenderave publik për furnizim, kryerje të shërbimeve, etj. Në kategorinë e veprave penale të kategorisë së korupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare siq edhe u tha më lartë hynë edhe vepra penale dhënja e ryshfetit e specifikuar saktë në Kodin Penal të Republikës së Kosovës me nenin 429 , të cilën vepër kryesisht e kryejnë personat fizik , e jo personat zyrtar.

Kur bëhet fjalë për nocionin “zyrtar” apo “zyrtar publik”, këtë duhet kuptuar në një kontekst të gjerë të bartësve të funksioneve të ndryshme në institucione publike si dhe përgjithësisht sektorit publik, pavarësisht rangut administrativ, qendrorë apo lokal, kurse pashmangshëm këtu përfshihen edhe bartës të posteve të rëndësishme shtetërore, pavarësisht nëse bëhet fjalë për poste ku individët zgjedhën me mandat nga populli apo për poste ku individët emërohen nga institucionet përkatëse kompetente për emërimet e tyre.

Cilado që të jetë mënyra dhe rruga me anë të së cilës ata vijnë deri te postet zyrtare (institucionale), në vende me traditë demokratike dhe përgjithësisht në vendet ku ka një kohë të gjatë jetë institucionale të stabilizuar, e në të cilat është bazuar edhe legjislacioni aktual kosovar në fuqi, asnjëherë nuk ka shkallë të tillë të imunitetit, i cili e mbron shkelësin e detyrave, kompetencave dhe autorizimeve zyrtare.

Pikërisht për këtë, shteti krijon mekanizma monitorues, të cilët gjithashtu do të trajtohen gjatë këtij studimi pasi që të njëjtët janë pjesë e mozaikut të gjerë institucional të Kosovës për të cilin parasupozohet që mbështetur në autorizime të luftojë korrupsionin. Se si funksionojnë këta mekanizma dhe deri ku arrin autoriteti i tyre, kjo paraqet një dilemë e cila domosdoshmërisht zë vend gjatë trajtimit të këtij studimi.

Për të realizuar këtë studim, është përdorur metodologji e cila trajton jo thjeshtë vetëm aspektet kushtetuese dhe ligjore, por edhe një literaturë më e gjerë, e cila dukurinë e keqpërdorimit të detyrës zyrtare mund ta ketë në fokus parësorë, apo edhe dytësorë. Pikërisht për këtë qëllim, nuk do të ketë koncentrim vetëm në literaturën e cila ka të bëjë ekskluzivisht me profesionin i cili i përket profilit juridik-penal, por edhe libra të cilët japin burime të rëndësishme mbi mënyrën e trajtimit të akteve korruptive përgjatë historisë dhe të kohërave tona gjithashtu.

Kjo e pasuron studimin me këndvështrime të shumëllojshme filozofike, letrare, politike apo edhe me ndonjë segment tjetër, ngase edhe vetvetiu shkenca e drejtësisë nuk mund të izolohet dhe të trajtojë problemet si e vetme duke e injoruar ambientin rrethues në hapësirë kohore, apo edhe aspekte të botës kulturore e sociale, e që së bashku disi imponojnë botëkuptime të një shoqërie të caktuar, kurse duhet thënë se pashmangshëm me këtë, kjo bëhet faktor ndikues në funksionimin e jetës institucionale brenda një shteti.

Fatkeqësisht e kaluara jo e largët e Kosovës, sidomos ajo politike lë edhe sot gjurmët e saj, veç tjerash edhe në kuadër të zbatimit të sistemit të drejtësisë në vend. Jo për atë se ajo ka ndikuar në ndonjë mënyrë në përpilimin e ligjeve, por ka ndikuar dhe vazhdon të ketë ndikim në perceptimin e tyre nga ana e një opinionit të gjerë, element kyç ky i cili pamundëson zbatimin e plotë të kuadrit ligjorë dhe të të drejtës penale në veçanti, si dhe në pasigurinë e personave zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si në rastin e gjykatësve, prokurorëve, etj.

Ndoshta për këtë duhet më tepër kohë, e ndoshta duhet të ndryshojë vetë qasja e politikës dhe politikbërësve, në mënyrë që te popullata të ketë më shumë vetëdije drejtë perceptimit dhe akceptimit të mirëfilltë të sistemit të drejtësisë, por përtej kësaj gjithashtu shfaqet patjetër edhe nevoja e tejkalimit të disa botëkuptimeve sociale, të cilat paradoksalisht e bëjnë një vepër penale si rasti i keqpërdorimit të detyrës zyrtare, të jetë e trajtuar si një dukuri e pranueshme shoqërore, fenomen gati normal, apo edhe si një mundësi e zakonshme praktike për të realizuar qëllime të caktuara, pra jo si një fenomen apo dukuri negative dhe mbi të gjitha jo si një shkelje ligjore dhe vepër penale.

Në të vërtetë efektet zingjirore të ndërsjella ndërmjet ligjeve, janë e vetmja mundësi që të mos lejohet hapësirë për keqpërdoruesit e detyrës zyrtare, duke pamundësuar jo thjesht vetëm parandalimin apo identifikimin e inkriminimeve por në rast të konstatimit se një inkriminim ka ndodhur, atëherë të mundësohet edhe trajtimi adekuat nga ana e shtetit, zbatimi i masave ndëshkuese me efekt në pasuri apo benefite tjera të përfituara në mënyrë joligjore, si rezultat i keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

1.1. Shtrimi i problemit

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare përveç që është një fenomen i pranishëm kudo në botë, është edhe sfidë e vazhdueshme si për shtetin dhe të drejtën, ashtu edhe për shtetin e së drejtës në veqanti, e deri te ballafaqimi me kufijtë e etikës njerëzore, si për zyrtarët publik ashtu edhe për qytetarët e një vendi. Kjo nuk është një dukuri e pranishme e re dhe siç do të shihet gjatë shtjellimit të këtij studimi, është e dëshmuar prania e saj në kohëra të ndryshme, pavarësisht stadi të zhvillimit të qytetërimit dhe jo vetëm thjeshtë e përcaktuar nën ndikimin e aspekteve politike dhe ekonomike që kanë mbretëruar.

Nisur nga fakti se keqpërdorimi i detyrës zyrtare është një kategori veprash penale të kryer me dashje, do të trajtohen megjithatë edhe disa segmente të caktuara në kuadër të asaj që quhen vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ku zyrtari mund të bie viktimë e rrethanave, por kjo në asnjë mënyrë nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia penale para organeve kompetente për këtë, si dhe nga përgjegjësia profesionale dhe deontologjia e profesionit të tij në kuadër të institucionit ku punon.

Në thelb, të kryesh një vepër penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, do të thotë të paracaktosh privilegje dhe benifite për veten dhe për palën bashkëpunuese, relacion ky ku të dy të involvuarit janë njëjtë fajtorë, respektivisht janë njëjtë bashkëfajtorë. Por, situata është shpesh më e komplikuar se kaq, mund të ketë më shumë të implikuar për shkak se shpesh kërkohen organizime kriminale më të mëdha për të kryer një vepër të caktuar, kurse pikërisht lidhur me këtë, një kohë të gjatë janë shpërfillur modalitetet që gati e kanë bërë legale atë që përgjithësisht e njohim si ndërmjetësim, e në emër të kësaj janë paguar shuma materiale për ndërmjetësime apo komisionime.

Pra, spektri i veprave penale që ngërthen brenda tij keqpërdorimet e detyrës zyrtare, nuk është bardh e zi, nganjëherë nuk është lehtë i identifikueshëm, kurse duhet pranuar që krahas me evaluimin dhe plotësimin e aspekteve legislative që e luftojnë këtë dukuri, njëkohësisht, janë zhvilluar një sërë modalitetesh, të ngjashme me atë që u përmend më lartë, të ndërmjetësimit, të cilat kanë krijuar dhe vazhdojnë të krijojnë hapësirë që keqpërdorimi i detyrës zyrtare të bëhet në kuadër të kufijve të respektimit të ligjeve në fuqi.

Tregu ekonomik ka tendencën e uniformimit gjithnjë e më të madh, si dhe gjithashtu ekzistojnë tendencat e zhbërjes së tregjeve nacionale, respektivisht atyre kornizave që funksionojnë brenda një shteti, si në rastin e një tregu ekonomik por edhe në raste si sistemi politik e juridik supranacional si ai i Unionit Evropian, kurse më tutje kjo pashmangshëm krijon situata të reja por edhe hap shtigje të reja për keqpërdoruesit.

Fokusi këtu qëndron mbi veprat e tilla penale në Kosovë, kurse këtu imponohet që të përmenden përveç disa specifika karakteristike për Kosovën edhe ato përtej, ndryshe nuk do të mund të kuptohej ambienti, e as statistikën e prezantuar në kuadër të periudhës kohore që përfshihet këtu.

Republika e Kosovës është një vend i cili po kalon në tranzicionin e gjatë të pasluftës, kështu po përjeton gjithsesi përvoja që më parë i përjetuan edhe vendet e tjera të dala nga lufta, si dhe pavarësisht se kishte përpjekje që të mos përsëriten gabimet e vendeve të tjera që në këtë drejtim mund të shërbenin si mostra të gatshme se si nuk duhet bërë disa gabime, duket se pikërisht paslufta si fakt dhe realitet, ndikoi dhe prezantoi në mënyrën e saj edhe dukurinë e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, në formë të tilla që nganjëherë për individë të caktuar është me arbitrarizëm e pranueshme brenda konditave të tyre morale.

1.2. Qëllimi i studimit

Me punimin e këtij disertacioni synohet ndriqimi , pasqyrimi real i gjendjes lidhur me egzistimin , identifikimin dhe luftimin e llojit të veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Kosovë në një periudhë të caktuar kohore , si dhe avancimin e qasjes lidhur me vetëdijësimin e qytetarëve , bartës të funksioneve e detyrave zyrtare dhe qytetarëve si opinion publik në kritikim dhe denoncim të veprave penale të kategorisë së keqpërdorimit me detyrën zyrtare , kështu duke kontribuar në forcimin e shtetit ligjor , dhe sundimin e ligjit , objektiva këto të demokracisë së mirëfillt. Si qëllim dytësor apo sekondar është hulumtimi i aspektit fenomenologjik dhe kriminologjik të veprave penale të keqpërdorimit me detyrë zyrtare , identifikimi i profilit të kryesit si profil i caktuar i këtyre veprave si dhe motivet kryesore si faktor nxitës për kryesit e këtij lloji të veprave penale .

1.3. Rëndësia e studimit

Studimet e bazuara në hulumtime cilësore empirike e teorike janë sfond i volitshëm për zhvillimin dhe avansimin e shkencës dhe begatimin e opusit gnoseologjiko epistemologjik në një shoqëri. Në Republikën e Kosovës, ka mungesë të literaturës dhe mungesë të hulumtimeve e studimeve lidhur me veprat penale të keqpërdorimit me detyrë zyrtare , andaj hulumtimi , studimi i plotë dhe i thellë i pretenduar do të ketë një rëndësi të konsiderueshme teorike e pragmatike . Rëndësia teorike konsiston në begatimin e literaturës në fushen penale me të dhëna të reja si gjetje kërkimore në segmentin e keqpërdorimit me detyrën zyrtare si kategori e veçantë e veprave penale në Kosovë. Rëndësia praktike e këtijë studimi konsiston në ndihmesën në identifikim dhe pasqyrim të realitetit egzistues në këtë segment të jetës shoqërore , si pikënisje dhe nxitje në aktivitetin hetimor e kërkues të organeve të ndjekjes penale për të parandaluar dhe luftuar këtë kategori të veprave penale e cila për nga pesha dhe refleksioni determinues është me ndikim të madhë në funksionimin e shtetit të së drejtës dhe garantimin e një mirëqenje të qëndrueshme dhe kultivimin e vlerave demokratike siq janë liria , barazia , siguria , respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut. Në aspektin kërkimor hulumtues ky studim ka rëndësi të madhe sepse do të shërben si referim relevant kërkimor për studime e hulumtime tjera të kategorisë së njëjtë të veprave penale në periudha tjera kohore në Kosovë , si dhe si pikë referimi në aspektin krahasimor në ndonjë hulumtim tjetër që do të realizohet në shtetet në fqinjësi e sidomos në Shqipëri e Maqedoni .

1.4. Hipotezat e punimit dhe pyetjet kërkimore

Me qëllim të studimit sa më përmbajtësor dhe të analizimit të veprave penale të ndërlidhura me keqpërdorimin e detyrës zyrtare në Kosovë, kam parashtruar dy hipoteza:

- *Hipoteza e parë:* Në Republikën e Kosovës supozohet arsyeshëm se është për diskutim vullneti i mjaftuar politik për luftimin dhe parandalimin e kësajë kategorije të veprave penale.
- *Hipoteza e dytë:* Në Kosovë, në aspektin formal ekziston infrastruktura ligjore e mjaftuar por kërkohet zbatimi konsekuent i këtijë legjislacioni .

Me hulumtimin e kësajë dukurie në kuadër të këtij punimi doktoral do të arrihet në ofrimin e përgjigjeve për pyetjet kërkimore vijuese:

- Cilët janë faktorët të cilët ndikojnë në keqpërdorimin e detyrës zyrtare ?
- Cilat janë format e kryerjes së veprave penale të ndërlidhura me keqpërdorimin e detyrës zyrtare?
- Cilat janë motivet kryesore të kryesëve të këtyre llojeve të veprave penale ?
- Cilat janë karakteristikat e legjislacionit penal, i cili rregullon veprat penale të ndërlidhura me keqpërdorimin e detyrës zyrtare në Kosovë? A implementohet në praktikë ky legjislacion?

1.5. Metodatat dhe metodologjia e kërkimit

Metodologjia e cila do të aplikohet gjatë shtjellimit e studimit të kësajë problematike përmban në vehte të gjitha metodatat e teknikat relavente kërkimore hulumtuese ku përmes tyre do të realizohet pjesa hulumtuese teorike , si hulumtimi e shfrytëzimi i literaturës përkatëse bashkëkohore studimore, si: librat universitar, revistat shkencore apo edhe shtypi ditor. Këto burime komplementohen me publikimet relevante akademike shkencore, si dhe legjislacionet e shteteve të ndryshme që aplikohen në lëmin e kategorisë së veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Me metodologjinë dhe metodatat e kërkimit kemi realizuar përzgjedhjen e metodave të përgjithshme të kërkimit, përkufizimin e variablave operacionale, zgjedhjen e teknikës

për mbledhjen e të dhënave, mostrave, planit për përpunimin e të dhënave dhe planin e realizimit të hulumtimit.

Po ashtu, janë shfrytëzuar edhe burimet e hapura siç janë ueb-faqet e ndryshme në internet dhe analizimi i raporteve vjetore të institucioneve të ndryshme.

Bazuar në karakterin e ndërlikuar të veprave penale të keqpërdorimit të detyres zyrtare , në kuadër të këtij disertacioni janë aplikuar metoda të ndryshme shkencore për ta shtjelluar këtë temë. Metodatat të cilat janë aplikuar me qëllim të studimit të kësaj teme janë: metoda historike, analiza juridike, metoda e analizës së përmbajtjes, metoda statistikore, metoda krahasimore, metoda kriminologjike. Aplikimi i këtyre metodave dotë mundësoj elaborimin shumë dimenzional të dukurisë së keqpërdorimit të detyrës zyrtare .

Analiza juridike ; analiza është zbatuar për të evidentuar aspektin juridik të veprave penale keqpërdorimi i detyres zyrtare . Përmes kësaj metode janë paraqitur: definimi i veprave penale të kësajë kategorie , karakteristikat, pasojat dhe segmente tjera.

Metoda historike mundëson që veprat penale të studiohen si dukuri shoqërore dinamike që nuk kanë lindur rastësisht, por që janë pasojë e shkaqeve dhe e kushteve shoqërore–ekonomike, politike, etj., në një hapësirë të caktuar dhe në një kohë të caktuar.

Metoda statistikore. Përmes metodës statistikore janë evidentuar vëllimi, struktura dhe dinamika e veprave penale të keqpërdorimit të detyres zyrtare . Duke marrë për bazë të gjitha statistikatat e mbledhura nga institucione të ndryshme përmes metodës statistikore kemi realizuar zbërthimin e këtyre të dhënave dhe krahasimin e këtyre të dhënave ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit në Kosovë. Përmes kësaj metode janë analizuar të dhënat e grumbulluara nga institucione të ndryshme për veprat penale të keqpërdorimit të detyres zyrtare, janë nxjerrë karakteristika për të dyshuarit, të dënuarit dhe viktimat e këtyre veprave penale.

Metoda e analizës së përmbajtjes. Për ta njohur sa më mirë problematikën në lidhje me kategorinë e veprave penale të keqpërdorimit të detyres zyrtare , është përdorur analiza e përmbajtjes ku janë analizuar përmbajtje të ndryshme si raporte , literaturë e të dhëna tjera të ndryshme , duke nxjerrë përfundime të përgjithshme teorike mbi natyrën, përmasat dhe tiparet e veprave penale të ndërlidhura me keqpërdorimin e detyres zyrtare

Metoda krahasimore. Kjo metodë është aplikuar për të hulumtuar në aspektin e krahasimit të legjislacionit që rregullon qështjen e kategorisë së veprave penale të

keqpërdorimit të detyres zyrtare. Me aplikimin e kësaj metode janë nxjerrë përfundime të sakta, të dhënat e grumbulluara janë krahasuar sipas rasteve të veprave penale të të ndërlidhura me keqpërdorimin e detyres zyrtare në Kosovë të evidentuara dhe të trajtuara në Polici , Prokurori dhe në Gjykata.

Metoda kriminologjike në vete ngërthen një numër më të madh të metodave individuale, të cilat aplikohen në shkencën e kriminologjisë. Përmes kësaj metode kemi pasqyruar ecurinë, dinamikën, mënyrat, format dhe vendin e kryerjes së veprave penale të ndërlidhura me keqpërdorimin e detyres zyrtare, veçoritë individuale të kryesve si dhe faktorët e veprave penale.

1.6. Mundësitë dhe kufizimet

Bazuar në delikatësinë e kategorisë së veprave penale të keqpërdorimit me detyrë zyrtare mund të konstatojmë se kufizimet dhe vështirësitë kanë qenë evidente si në segmentin e sigurimit të dhënave ashtu edhe në numrin e nevojshëm të burimit të informacioneve, përkatësisht institucioneve . Në një gjykatë themelore përkundrejt premtimit , pritjes së ngrohtë nga menagjmenti , nuk më janë ofruar të dhëna e aktëgjykime për studim , pas insistimit tim të dytë për qasje studimore, e duke u shërbyer me lidhje personale , më dërgohen dy aktëgjykime liruese jo cilësore në aspektin e hartimit dhe pregaditjes së tyre për mua , të cilat edhe nuk janë analizuar fare në këtë studim. Pra siq u tha këto vështirësi dhe kufizime kanë të bëjnë me qasjen e kufizuar dhe paksa të vështirë në të dhënat dhe informacionet lidhur me disa lëndë në procesim e sipër procedural dhe lëndët për të cilat duhej të vendosej në shkallën e dytë. Sa i përket mundësive mund të konstatojm se shkrimi i këtijë punimi dhe shtjellimi i kësajë problematike ishte dhe është një mundësi e mirë për të pasqyruar saktë e objektivisht gjendjen në Kosovë në raport me parandalimin dhe luftimin e dukurisë së keqpërdorimit me detyrën zyrtare si një kategori e veçant e veprave penale.

1.7. Përmbajtja e punimit doktoral sipas kapitujve

Punimi doktoral i cili për objekt të hulumtimit e ka dukurinë e keqpërdorimit me detyrën zyrtare si kategori e veprave penale në Republikën e Kosovës , brenda një kuantumi kohor prej një decenije , përkatësisht prej vitit 2004 deri në fund të vitit 2014 , përbëhet prej shtatë kapitujve . Në kapitullin e parë shtjellohet aspekti hyrës , akceptimi , përshkrimi dhe konteksti social dhe juridik i kategorisë së veprave penale të keqpërdorimit me detyrë zyrtare.

Në kapitullin e dytë shtjellohet aspekti teorik dhe konteksti historik , përkatësisht keqpërdorimi me detyrë zyrtare në të kaluarën dhe sfidimi global nga kjo dukuri.

Në kapitullin e tretë shtjellohet e drejta ndërkombëtare dhe legjislacioni penal në Kosovë.

Në kapitullin e katërt shtjellohet aspekti juridiko-penal i veprave penale të ndërlidhura me keqpërdorimin e detyres zyrtare në katër shtete , si në Shqipëri , Slloveni , Gjermani e Britani e Madhe ku analizohet qështja nga aspekti krahasimor në mes të Kosovës dhe këtyre shteteve të lartëcekura sa i përket parandalimit dhe luftimit të kësajë kategorie të veprave penale . Në kapitullin e pestë paraqitet llojllojshmëria e veprave penale nga kategoria e keqpërdorimit të detyrës zyrtare duke specifikuar secilën vepër veq e veq , duke përshkruar e analizuar secilën nga aspekti i përkufizimit ligjor , përkatësisht përkufizimi sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në kapitullin e gjashtë shtjellohet analiza empirike e të dhënave statistikore për veprat penale të keqpërdorimit me detyrën zyrtare në Kosovë në periudhën kohore nga koha e hyrjes në fuqi të kodit të përkohshëm Penal dhe kodit të përkohshëm të procedures Penale të Kosovës . Në pjesën e parë të këtij kapitulli shtjellohet analiza e të dhënave të Policisë së Kosovës, ndërsa në pjesën e dytë shtjellohet analiza e të dhënave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në kapitullin e gjashtë shtjellohet analiza empirike e të dhënave të fituara edhe nga Prokuroria , pastaj nga Agjencioni anti korupsion lidhur me evidentimin , procesuimin e kategorisë së tillë të veprave penale.

Në kapitullin e shtatë është paraqitur praktika gjyqësore e regjistruar dhe e analizuar në dy Gjykata themelore të Republikës së Kosovës ,në total njëmbëdhjetë aktgjykime të cilat janë marrë në Gjykatën e kryeqytetit si më e madhja dhe në Gjykatën e Ferizait.

Në kapitullin e tetë janë evidentuar përfundimet dhe rekomandimet, të rezultuara nga hulumtimi dhe analiza e bërë materialit të studiuar për këtë temë

KAPITULLI II

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare në të kaluarën dhe sot

2.1. Trajtimi i keqpërdorimit me pushtetin në të kaluarën

Viteve të fundit dhe posaçërisht në një periudhë që përafërsisht fillon në dekadën e fundit të mileniumit të kaluar, një fenomen më përgjithësisht i njohur si keqpërdorimi i detyrave zyrtare në kuptimin edhe të vendeve të punës, fillon të tërheq vëmendjen e qarqeve shkencore. Në kuadër të kësaj përfshihet edhe ajo që quajmë korrupsion në një kontekst më të gjerë, kurse në mënyrë më të specifikuar edhe si “keqpërdorim i detyrës zyrtarë” apo edhe siç e parasheh legjislacioni i Kosovës si “vepra penale kundër detyrës zyrtare”. Në vendet e zhvilluara por edhe ato në zhvillim, janë një sërë akuzash për keqpërdorime që kanë ditur të shkaktojnë, madje edhe probleme në shkallë vendi, me përmasa të mëdha, të tilla që shpijnë deri tek rrëzimi i qeverive. Këtu përfshiheshin si të akuzuar madje edhe president apo kryeministra e në disa raste edhe elita të tëra politike.

Kjo ka ndodhur pothuajse në secilin kontinent, sidomos në vendet politikisht të paqëndrueshme dhe me mangësi serioze në sistemin e drejtësisë duke i dhënë fund edhe regjimeve mjaft të fuqishme diktatoriale, si në rastin e regjimit të Sesesekos në Zairenë e dikurshme (Johnston, 2005, f. 82) (Mbaku, 2010, fv. 151-152). Jo rrallë, edhe lëkundja e diktaturave fillon me pretekstin e keqpërdorimeve.

Kurse autori Rotberg gjen edhe një nga shkaqet e veprimeve korruptive në masë të shkaktuar në vende të pasluftës, faktin që elitat të cilat vijnë në pushtet përmes luftës, e përligjin moralisht veprimin e tyre duke u nisur nga fakti se ata e konsiderojnë vetën të lirë për ta bërë këtë, të udhëhequr nga motoja “ne jemi fitimtarët”. (Rotberg, 2009, f. 7)

Sigurisht që pavarësisht me këtë që u tha më lartë, keqpërdorimet e posteve zyrtare dhe autoritetit nuk cilësohen si fenomen i ri, për këtë ka edhe fakte historike që shkenca e sotme i ka në dispozicion, madje shumë shekuj më parë si në rastin e ministrit të parë të mbretit të Indisë për çka ka dëshmi në librin “Arthashastra” (Kaṭālya, 1987, fv. 265-266). “Arthashastra” është tregues se keqpërdorimi i autoritetit të dhënë, ka qenë qysh në kohëra të lashta, një shqetësim për shtetin.

Vetë nocioni “korrupsion” ka rrënjë nga gjuha latine. “Corruptire” ka kuptimin, të thyesh, të dëmtosh, të shkatërrosh, duke menduar këtu si objekt ndërgjegjen e një personi i cili kryen një post apo detyrë publike (Shah, 2007, f. 308). Megjithatë në formën e kuptimit që ka, nocioni i korrupsionit ka pësuar ndryshime përgjatë shekujve, ai ndërkohë kishte kuptime të ndryshme por jo shumë të dallueshme ndërmjet tyre.

Nikola Makiaveli, korrupsionin e përcaktonte si një të keqe për shtetin, në qendër të së cilës qëndron shfrytëzimi i kapaciteteve publike për nevoja të interesave individuale. Ky përcaktim në fakt, përbën thelbin e pjesës më të madhe të përkufizimeve rreth këtij fenomeni, si i tillë është mjaft domethënës ndonëse i shkurtër. Ai përshkruante se si në një shoqëritë të korruptuar, qytetarët që nuk janë pjesë e elitave klienteliste kanë frikë të bëjnë ndryshimin. (Capussela, 2015, f. 27)

Gjithashtu, në një vepër të madh letrare të shkruar shtatë shekuj më parë nga poeti italian Dante Alighieri të quajtur “Komedia hyjnore”, flitej për shprehitë korruptive të sundimtarëve politik dhe jo vetëm atyre (Alighieri, 2003, f. 275). Kurse Shekspiri shkrimtari i madh anglez, korrupsionin si dukuri e kishte një nga pikat ku godiste më së shumti në veprat e tij (Johnson, 2010, fv. 43-51).

Mbështetur në praktikë e këtyre autorëve, rezulton se keqpërdorimi në kuptimin e shpërdorimit të vendit të punës dhe të keqpërdorimit të autoritetit të besuar për çështje kriminale, është diçka që kishte prezencë gjatë gjithë kohës, andaj si shqetësim i tillë edhe preokuponte autorë të ndryshëm.

Këtu, raporti ndërmjet drejtësisë dhe moralit paraqet një nga pyetjet më thelbësore drejt kuptueshmërisë të marrëdhënieve shoqërore. Kuptueshmëria mbi këtë raport, provokon edhe një dilemë tjetër, rreth asaj se nëse është më e vjetër drejtësia apo morali. Lidhur me këtë ekzistojnë qëndrime të ndryshme, kurse më shumë mbizotëron mendimi se morali është një kategori më e vjetër se drejtësia, dhe se gjatë zhvillimit të shoqërisë njerëzore kishte kohëra kur marrëdhëniet shoqërore përcaktoheshin me anë të moralit edhe kur nuk kishte sistem të drejtësisë.

Është me rëndësi që kur bëhet fjalë për moralin si kategori më e vjetër se sistemi i drejtësisë, kjo lidhet me faktin se disa marrëdhënie shoqërore jo gjithmonë mund të jenë

objekt i sistemit të drejtësisë. Ndonëse drejtësia është një sistem normativ i pavarur, ajo sërisht nuk mund të ushtrojë funksionin e saj në mënyrë të izoluar, por në njëfarë mënyre imponohet që këtë ta bëjë duke bashkëvepruar shpeshherë me forma të tjera të kontrollit shoqërorë. Kjo çështje në radhë të parë vjen në shprehje kur bëhet fjalë për veprën penale, më saktësisht kur bëhet fjalë për një vepër të ndaluar me kod penal e që njëkohësisht është edhe shkelje morale. Pikërisht këtu dallojmë se ndërmjet të drejtës penale dhe moralit ka disa ndryshime që vijnë në shprehje kur bëhet fjalë për zbatimin.

Është e qartë se te e drejta penale, zbatimi është i detyrueshëm, kurse zbatimi në aspektin moral funksionon në bazë vullnetare apo edhe sipas perceptimeve individuale e shoqërore. Pra, rrjedhimisht, normat e përcaktuara nga sistemi i drejtësisë, dallojnë nga normat morale, sidomos në faktin se e drejta si sistem është normë racionale, të cilën nuk e synon morali.

Te relacioni ndërmjet sistemit të drejtësisë dhe moralit, si dhe ndërmjet këtyre, mbase duhet kërkuar edhe përkufizimin lidhur me korrupsionin. Nga këndvështrimi teorik ka qasje të ndryshme rreth përkufizimit të korrupsionit dhe nuk ka një qasje apo edhe teori të definuar qartë. Sigurisht që një definicion i saktë nuk mund të vjen vetëm bazuar në kriteret që prodhon sistemi i drejtësisë dhe e drejta penale, por këtu duhet konsideruar edhe kategoritë morale të shoqërisë. Studiuesi Vito Tanzi, e definon korrupsionin si diçka ku qëllimshëm vjen deri te shkelja e parimit të paanshmërisë. (Tanzi, 1998)

Shikuar të kaluarën, dallohet qartë se edhe në shtetet më të zhvilluara të botës kishte korrupsion dhe elemente të veprave që sot i quajmë vepra penale kundër detyrës zyrtare. Në Perandorinë Romake, pikërisht për këtë arsye, zyrtarët kishin obligim që të japin llogari jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare por edhe në rast se detyra zyrtare përfundonte, sërisht ata ishin të obliguar që të paraqisnin çdo parregullsi të cilën mund ta kishin bërë derisa ishin në funksion të detyrës. Ekzistonte edhe një proces gjyqësorë i posaçëm i quajtur “ Questionis” i cili kishte për detyrë që madje edhe të parandalojë keqpërdorimet e detyrës zyrtare. Ky proces merrej me raste të ndryshme politike, me raste të mitos, kurse ishte aq i avancuar sa merrej edhe me mashtrimet gjatë proceseve zgjedhore kur zgjidheshin magjistratët.

Më vonë në Perandorinë Romake formohet edhe një këshill i veçantë në kuadër të senatit, të cilit mund t'i parashtroheshin ankesa lidhur me veprat e natyrës së korrupsionit. E drejta romake, veç të tjerash, ka krijuar një teknikë të mirë legislative dhe një terminologji të përsosur, me anë të të cilave ka arritur të zgjidhë problemet që paraqiteshin në çdo sistem juridik. (Sadikaj, 2010)

Shembullin e Perandorisë Romake do ta përcjellin shtete të ndryshme më vonë, si dhe përgjatë gjithë kohës kishte mekanizma të ndryshëm më anë të të cilëve shtetet përpiqeshin të parandalonin dhe të dënonin keqpërdorimet e zyrtarëve të ndryshëm. Në fillim të Shek. XIX, në Francë vjen në fuqi një ligj i veçantë, i cili hapte rrugë që shteti të ballafaqohej me shkeljet e administratës publike, kurse më vonë hyn në fuqi edhe Kodi Penal në formën që kanë sot kodet penale. Gjithashtu në Francë më 1870, largohet çdo mundësi për amnistinë e shkelësve të detyrës zyrtare.

Në Gjermani, Kodi Penal i vitit 1871, për herë të parë në mënyrë të ashpër dënon çfarëdo shkelje të bërë nga personat zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare. Me anë të këtij Kodi Penal, në Gjermani brenda çdo viti, do të dënohen rreth një mijë persona, gati gjatë tridhjetë viteve me radhë. (Strafgesetzbuch, 1871)

Kur u hartua Kushtetuta e SHBA-ve, për të cilin koha dëshmoi se ka qëndrueshmëri morale dhe politike, çështja e keqpërdorimit të vendit të punës ishte një nga dy krimet eksplicite të përmendura për të cilat mund të shkarkohet një president amerikan. (Noonan, 1987, f. 397)

Hartuesit e Kushtetutës së SHBA-ve, kishin parasysh që njeriu në rrethana të ndryshme mund të bie edhe vetë viktimë e keqpërdorimit, në kuptimin që ndoshta nuk do të mund t'i rezistoj atij në mjegullën e krijuar nga rrethana të ndryshme të dobësisë etike eventuale. Pikërisht, kur lexohet Kushtetuta amerikane, ndonëse keqpërdorimi i autoritetit shpie deri te shkarkimi qoftë edhe i presidentit, ka një qasje të natyrshme dhe parashikuese, madje edhe filozofikisht të arsyetuar, se keqpërdorimi i vendit të punës nuk përbën diçka që duhet marr si të jashtëzakonshme dhe e cila nuk mund të ndodh, gjithsesi pasojat dihen.

2. 2. Vështrim historik i dukurisë së keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Jugosllavi

Kosova siç dihet në të kaluarën nga aspekti juridik e politik ishte pjesë përbërëse e Jugosllavisë fillimisht e deklaruar “ si shprehje e vullnetit popullor “ për të qenë nën administrim të R. së Jugosllavisë, më vonë me Kushtetutë të vitit 1974 fiton cilësinë e Krahinës autonome, apo thënë ndryshe u bë element konstitutiv i Federatës Jugosllave. Republika e Jugosllavisë nga viti 1946 ishte Republikë Popullore Federative ku Kosova trajtohet si pjesë e Serbisë dhe me Serbinë si pjesë e Jugosllavisë, ku nga mbledhja e dytë e KQKJ -s me 1943 nuk përmendej Kosova fare, kështu që rendi juridik e kushtetues i Jugosllavisë vlente edhe për qytetarët e Kosovës. Sa i përket legjislacionit penal të kohës për të cilën po flasim, e që ka të bëjë me dukurinë të cilën po e trajtojmë në këtë punim ne i referohemi fillimisht ligjit të vitit 1946, ligjit mbi mbrojtjen e të mirave materiale, pastaj radhazi, ligjit të vitit 1948 i njohur si ligji mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare, i publikuar në Gazetën zyrtare në muajin Tetor të vitit 1948, pastaj Ligjit Penal të Krahinës Autonome të Kosovës të vitit 1977, i botuar në “Gazeta e delegatëve “ e Kuvendit të KSA të Kosovës, ligjit penal të Serbisë të viti 1977.

2.2.1. Ligji mbi mbrojtjen e të mirave materiale i vitit 1946

Ky ligj rregullonte marrëdhëniet shoqërore e ato pronësore në fazën e parë pas çlirimit të Jugosllavisë dhe vendosjes së pushtetit popullor të udhëhequr nga Partia Komuniste ku Jugosllavia ishte një Republikë Popullore Federative e përbërë nga gjashtë Republika, me shumë probleme të trashëguara nga lufta dhe me një gjendje të rëndë socio ekonomike si dhe me probleme të pazgjidhura të pronës së kulakëve dhe feudalëve të vegjël dhe fillimit të një rendi krejtësisht të ri shoqëro politik e juridik. Është interesant fakti se në këtë ligj specifikohen saktë disa vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, natyrisht fillimisht specifikohet saktë personi zyrtar në nenin 5 të këtij ligji, përkatësisht personat që kanë kompetencë dhe autorizim për ruajtjen dhe mbrojtjen e të mirave materiale të përgjithshme popullore, apo pronën e vënë nën kontrollin e shtetit. Në nenin 6 thuhet: personat zyrtar të cilëve u është besuar udhëheqja, kontrolli i të mirave materiale popullore, duhet të jenë të përgjegjshëm që në mënyrë të ndërgjegjshme e të përgjegjshme të respektojnë rregullat,

udhëzimet të cilat i nxjerrin organet kompetente të pushtetit si dhe për çdo veprim e sjellje të keqe të qëllimshme apo mos kujdes të duhur do të ndëshkohen sipas këtij ligji. (Ligji mbi mbrojtjen e pasurisë së përgjithshme popullore, Gazeta zyrtare e RPF të Jugosllavisë, 25.0.1946) Neni 10 i këtij ligji specifikon edhe më konkretisht përgjegjësitë e personit zyrtar si dhe saktëson sanksionin për veprën penale të kryer nga kategoria e keqpërdorimit të detyrës zyrtare “personat zyrtar qoftë në shërbimin civil apo atë ushtarak, të cilët në qoftë se me vullnetin e tyre dhe në mënyrë të pa autorizuar, përvetësojnë ndonjë të mirë materiale popullore apo ndonjë trofe nga lufta, apo të mirë materiale e cila tek duhet të kalojë në pronësi shtetërore apo në administrim të shtetit, do të dënohet me burgim të rëndë prej 1 – deri në 10 vjet (neni 10) “ (Ligji mbi mbrojtjen e pasurisë së përgjithshme popullore, Gazeta zyrtare e RPF të Jugosllavisë, 25.0.1946). Edhe marrja e mitos si dukuri negative, në këtë ligj trajtohet si vepër penale dhe specifikohet saktë si vepër penale e dënuar me heqje lirie, sipas nenit 12, “ zyrtari i cili pranon mitën në mënyrë që ndonjë pronë shtetërore, banesë, apo mobile i jep në shfrytëzim personit nga i cili ka pranuar mitën, do të dënohet me burg të rëndë prej 2 – deri 6 vjet. Me dënim të njëjtë do të dënohet edhe personi i cili ofron mitën. (i njëjti ligj i lartcekur). Vepër penale sipas këtij ligji është edhe mos regjistrimi i përgjegjshëm i pasurisë dhe inventarit dhe lëshimet që mund të ndodhin nga zyrtarët shtetëror gjatë këtyre procedurave në këtë fazë, duke e ditur faktin se bëhet fjalë për një periudhë të ndjeshme për shtetin ku të mirat materiale, pasuria, prona ishin vlera jashtëzakonisht strategjike për fazën e parë të krijimit dhe ndërtimit të një rendi shoqëror e juridik të ri.

2.2.2. Ligji mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare i vitit 1948

Plotësim ligji i vitit 1948 i Republikës Popullore e Federative të Jugosllavisë specifikon saktë kategorinë e veprave penale kundër detyrës zyrtare ku për herë të parë trajtohet penalisht kjo dukuri, përkatësisht bëhet inkriminimi i kësaj dukurie si vepër penale. Filllohet me përshkrimin ligjor të personit zyrtar, saktësisht në nenin 2 të këtij ligji bëhet ky përshkrim “si persona zyrtarë nga kuptimi i këtij ligji konsiderohen zyrtarët shtetëror, anëtarët e trupave përfaqësues, personat që kryejnë detyra zyrtare administrative, profesionale... etj”(Ligji mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare i vitit

1948, Gazeta zyrtare e RPF të Jugosllavisë, Tetor 1948) kurse në neni 3 dhe 4 specifikohet saktë përgjegjësia e personit zyrtar dhe saktësohet edhe sanksionimi me heqje lirie, “ neni 4, personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, me qëllime të kundërta me shërbimin apo i udhëhequr nga dobia dhe interesi dobiprurës, kryen veprime të cilat tejkalojnë kompetencat apo autorizimin zyrtar, të përcaktuar me ligj, kësisoj duke shkaktuar pasoja të dëmshme të ndërlidhura me nenin 3 të këtij ligji do të dënohet me privim nga liria më së paku prej 3 muajve dhe me punë të dobishme shoqër deri në 5 vjet. “ (Ligji mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare i vitit 1948, Gazeta zyrtare e RPF të Jugosllavisë, Tetor 1948)

2. 2. 3. Ligji Penal i Krahinës Autonome të Kosovës, viti 1977

(Kreu i njëzetë, veprat penale kundër detyrës zyrtare)

Siç dihet Kosova që nga miratimi i Kushtetutës së vitit 1974 e fitoi Autonominë dhe u bë element i barabartë konstituiv i Federatës Jugosllave, e drejtë kjo juridike e politike veç të tjerash për të nxjerrë, miratuar ligje vetjake të cilat duhet të ishin në harmoni me ligjin e Serbisë dhe legjislacionin e Jugosllavisë. Njëri ndër ligjet e miratuar pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1974 ishte ligji Penal i KSA të Kosovës i miratuar në vitin 1977 nga Kuvendi i Krahinës autonome të Kosovës përmes të cilit ligj rregullohej materia penale ku në mes të shumë çështjeve për të cilat ofronte zgjidhje juridike ky ligj u trajtua dhe çështja e keqpërdorimit të detyrës zyrtare në kreun e njëzetë të këtij ligji. Neni 210 specifikon saktë rrethanat ku personi zyrtar mundë kryej vepër penale të kësaj kategorie pika 1 e nenit 210 “ personi zyrtar i cili me qëllim që ti sjellë vetes ose tjetrit ndonjë përfitim, ose që ti shkaktojë tjetrit ndonjë dëm, shfrytëzon pozitën ose autoritetin e vet zyrtar, kapërcen kufijtë e autorizimit të vet zyrtar, ose nuk kryen detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre muajsh deri në tri vjet” (Ligji Penal i Krahinës Autonome të Kosovës, viti 1977, Gazeta e delegatëve e Kuvendit të KSA të Kosovës). Vepër tjetër e rëndësishme në këtë ligj është mashtrimi në detyrë, saktë e specifikuar me nenin 215 ku në pikën 1 thuhet; “personi zyrtar që në kryerjen e detyrës me qëllim që vetes ose tjetrit t’i sjell përfitim pasuror pa të drejtë duke paraqitur llogari të rreme ose në ndonjë mënyrë tjetër vë në lajthitje personin e autorizuar që të bëjë pagesën e paligjshme dënohet me burgim prej 6 muajsh deri në 5 vjet. Në Ligjin Penal të Kosovës 1977 po ashtu janë të specifikuara saktë veprat penale, si; shpërdorimi i

detyrës zyrtare në nenin 219, pastaj marrja e ryshfetit e cila specifikohet në nenin 222 ku dënimi për këtë vepër është i paraparë prej 1 deri në 10 vjet burg. Po ashtu edhe dhënia e ryshfetit është paraparë si vepër penale në nenin 223, dhe dënimi pason prej 6 muajsh deri në 5 vjet. Vepra tjetër e radhës e keqpërdorimit të detyrës zyrtare është e paraparë në nenin 221, ndërmjetësimi i kundërligjshëm për të cilën vepër ligjvënësi përmes këtij ligji ka paraparë dënimin prej 3 muajve deri në 3 vjet burgim.

2.3. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare si sfidë globale

Jo vetëm qarqet shkencore, por edhe një sërë autorësh dhe gazetarësh kanë bërë bumin e publikimeve gjatë viteve të '90-ta, duke alarmuar mbi keqpërdorimin e detyrës zyrtare. Gazeta prestigjioze “Financial Times”, në një artikull, të botuar natën e vitit të ri 1996, e karakterizoi vitin 1995, si vit të korrupsionit. Shkrimet e mëtutjeshme të publikuara në këtë gazetë, do të përshkruajnë një atribut të tillë edhe për vitin 1996, 1997 dhe vitin 1998 (Abed & Gupta, 2002, f. 20).

Vëmendja e rritur për keqpërdorimet e detyrës zyrtare, në spektrin e gjerë të llojllojshmërisë së vetë mundësive për keqpërdorim, s’do mend se duhet të shpije tek pyetja që ndërlidhet me natyrën e njeriut dhe me një “Pse” të madhe në këtë drejtim. Gjithashtu, një dilemë e së sotmes është nëse ka ardhur deri tek preokupimi i shkencës së sotme me keqpërdorimin e detyrës zyrtare, për shkak se kjo dukuri është më e shpeshtuar sot se që ishte në të kaluarën?

Apo ndoshta edhe për faktin se përgjithësisht shoqëritë, jo vetëm në kuadër të një shteti por edhe në shkallë globale, po bëhen më të hapura, e si të tilla njëkohësisht po bëhen edhe më të guximshme në raport me elitat politike apo edhe ato ekonomike, si dhe po i shpalosin këto tema duke i de-tabuizuar plotësisht. S’do mend se keqpërdorimi i vendit të punës, është pabarazi dhe vetvetiu tradhti ndaj besimit të dhënë (Rotberg, 2009, f. 32). Megjithatë vetë mundësia për keqpërdorime rritet pikërisht kur shteti në përpjekje për të forcuar administratën, e zgjeron atë. (Jovasevic, 2012, f. 41)

Nëse përpiqemi këtyre pikëpyetjeve t’i përgjigjemi në mënyrë statistikore, vështirë se mund të bëhet ndonjë krahasim i saktë, për faktin se nëse sot ekzistojnë statistikat që flasin qartë, të njëjtat nuk ekzistojnë për të kaluarën. Siç edhe përshkruam më herët,

keqpërdorimi i detyrës zyrtare, ishte preokupim i mendimtarëve të mëdhenj të cilët merreshin me problemin, por edhe e trajtonin atë si një dukuri e keqe dhe problematikë shumë e pranishme njerëzore, por që vështirë të mendohet se kishin në dispozicion statistika, ngase statistika të mirëfillta, qoftë edhe minimale, ishte e pakapshme të menaxhohen në atë kohë.

Fakti që sot vëmendja ndaj keqpërdorimit të detyrës zyrtare është e pranishme më shumë se kurdoherë, veç të tjerash ka të bëjë edhe me avancimin teknologjik i cili e bënë më të lehtë rrugën deri tek informimi dhe gjenerimi i mëtutjeshëm në vlera statistikore, i cili avancim bashkë me shumë faktor tjerë ka ndikuar në ngritjen e vetëdijes kolektive dhe vetëdijesimit qytetar për të rezistuar dhe denoncuar veprimet e dëmshme për shtetin dhe qytetarët.

Diktaturat ekzistojnë edhe sot, të pranishme gati në të gjitha kontinentet me ndonjë përjashtim aty këtu, por shikuar nga këndvështrimi historiko-politik, mund të kuptohet që përfundimi i Luftës së Ftohtë, i dha fund hipokrizive politike në masë të madhe, si dhe çliroi shumë prej vendeve nga monopoli politik, i cili si i tillë i mundësonte elitave të qëndrueshme dhe të paqëndrueshme, që të keqpërdornin autoritetin pa fund.

Kjo nuk do të thotë se ky monopol nuk do të vazhdon në disa shtete. Në ato që i njohim përgjithësisht si vende të treta, kudo nëpër Azi, Afrikë, Amerikën Latine dhe jo vetëm atje, vazhdon të ketë një qasje selektive kur bëhet fjalë për luftimin apo parandalimin e keqpërdorimit të autoritetit, pavarësisht faktit se kudo ajo që sot njihen me referimin e përgjithësuar si “shoqëri civile”, vjen duke u forcuar.

Madje, në shumë vende, ndonëse dikush në mënyrë të vazhdueshme po keqpërdorë autoritetin e besuar nga ana e shoqërisë përmes institucioneve të shtetit, vazhdon të ketë mbrojtje përderisa keqpërdoruesi është pjesë e pushtetit. Ky vazhdon të jetë më pas, një instrument i një qeverie të re për të qëruar hesapet me eksponentët e qeverive të mëparshme, gjë që luftimin e keqpërdorimit të autoritetit e bënë përveç anëve pozitive edhe një mjet revanshist politik të pranishëm kudo.

Prandaj, e gjejmë shumë të pranishëm edhe fenomenin e ngritjes së akuzave, të cilat më pas nuk arrijnë të argumentohen para Gjykatave apo edhe arrijnë të argumentohen

vetëm pjesërisht. Globalizimi gjithnjë më i hovshëm i cili jep dimensione të reja në raporte ekonomike, politike e në tërësi të raportet shoqërore, ka hapur dhe vazhdon të hapë shtigje të reja, për mundësitë e keqpërdorimit të autoritetit.

Ky keqpërdorim, gjithnjë e më pak do të jetë pjesë e brendshme e një shteti dhe gjithnjë e më shumë do të merr përmasa ndërshtetërore, pikërisht si rezultat i dinamizmit të marrëdhënieve ndërkombëtare në përgjithësi. Tani do të ketë gjithnjë e më pak ekonomi të kontrolluara nga regjimet apo edhe tregje ekonomike të mbyllura të pa efektuara nga jashtë. (Simis, 1982, f. 129)

Në anën tjetër ekonomitë e kontrolluara drejtpërsëdrejti nga regjimi, nuk do të thotë assesi se ishin immune ndaj fenomenit të keqpërdorimit të autoritetit për qëllime të përfitimeve ekonomike, madje të dhënat e reja të shpalosura tregojnë se pikërisht në ato ekonomi, ky fenomen ishte edhe më i fuqishëm. Siç ishte edhe praktikë e regjimeve posaçërisht atyre komuniste, raportimet lidhur me keqpërdorimet e autoritetit, ishin temë e mbyllur e diskutimit brenda në majat e elitave politike, kurse si të tilla nuk arrinin të depërtonin qoftë edhe për një karakter informativ të qytetari i zakonshëm. Një dimension i cili po arrin suksesshëm të shpaloset, ka të bëjë edhe me lirinë e medie dhe sensibilizimin sidomos të viteve të fundit të masave për të mbrojtur gazetarin dhe burimet e tij.

Pra, nuk arrijmë të konstatojmë se vëmendja e rritur e qarqeve shkencore dhe në përgjithësi opinionit, nuk ka të bëjë me rritjen e keqpërdorimit të autoritetit në raport me të kaluarën, por më shumë ka të bëjë me rritjen e shkallës së transparencës të mundësuar nga konsolidimi i lirive qytetare. Madje edhe në shtetet demokratike ku qeveria dhe institucionet e shtetit janë transparente me qytetarin, ka një shpeshim të organizatave të ndryshme joqeveritare, të cilat po i kontribuojnë rritjes së një ambienti anti-korruptiv. Në shkallë botërore një prej këtyre organizatave mjaftë të suksesshme rezulton të jetë “Transparency International”.

Në vendet demokratike këto organizata nuk cilësohen si antiqeveritare, madje edhe vet autoritetet shtetërore i trajtojnë ato si një mekanizëm ndihmës që i mundëson vetë autoritetet të jenë transparente dhe të kenë në dispozicion kanale të gatshme të komunikimit të kësaj transparence me qytetarët. Në këtë drejtim nuk mund të themi se

gjendja është e njëjtë aty ku qeverisin autoritarizmat, andaj shpesh herë pa arsye organizatat e tilla joqeveritare konsiderohen si antiqeveritare dhe luftohen politikisht. Organizata si “Transparency International”, gjithnjë e më shumë kanë qasje studimore empirike, me çka jo vetëm që i qartësojnë statistikën e keqpërdorimit që i bëjnë zyrtarët e ndryshëm publik, por edhe e matin perceptimin e vetë qytetarëve me keqpërdorimin, duke marrë inpute të rëndësishme.

Disa studime të reja me një qasje retrospektive, janë në gjendje të tregojnë se si gjatë shekullit të kaluar qeveritë kontrollojnë ekonominë shumë më tepër se sa që mendohej atëherë. Ato përpiqeshin që në emër të luftimit të evazioneve fiskale të përdorin autoritetin për të luftuar biznese të caktuara, me të cilin rast pashmangshëm rritet fuqia e individit të pozicionuar në pozita zyrtare, përfshirë edhe pozitën më të rëndësishme institucionale në kuadër të shtetit. Shekulli i kaluar tregoi se si tek individit u përqendrua fuqia të cilën ia mundësonin autorizimet, kompetencat, ndikimi i përgjithshëm që kishte te vendimmarrësit e tjerë brenda në organizatë, apo edhe tek vetë politikë bërësit në nivele përtej organizatës ku vepron.

Në shtetet me traditë politike të cilat kanë qasje të drejtë në raport me funksionimin e ligjit, e që si të tilla u imponojnë edhe burokracive të kenë ndershmëri, pamundësohet ndikimi i politikës në ushtrimin e autoritetit zyrtarë, e për më tepër është gati e pamundur që politika të mbrojë keqpërdoruesit të cilët këtë e bëjnë nga pozicioni zyrtar që kanë.

Qasjet e mirëfillta shtetërore i imponojnë një kulturë të mirësjelljes edhe vetë qytetarit, por kjo mund të jetë edhe anasjelltas. Në kushte të tilla, bartësi i një posti zyrtarë e ka jashtëzakonisht të vështirë të realizoj keqpërdorimin, ngase i mungon bashkëpunëtori. Shtetet me një qasje të drejtë dhe sisteme të qëndrueshëm administrativ dhe ekonomik, i kanë mirë të studiuara politikën dhe ligjet, kurse edhe qasja e tyre në aplikimin e politikave të njëjta, është e barabartë për të gjithë qytetarët.

Aty ku nuk ka barazi ekonomike, situata ndryshon dhe është e ndjeshme. Individët të caktuar do të përpiqen në rrethana të tilla, që të gjejnë mënyra se si të realizojnë qëllimet e tyre, respektivisht mund ta marrim si shembull përpjekjen që të paguajnë më pak tatime dhe për këtë duhet të gjejnë bartës të caktuar të posteve zyrtare. Me gati një

automatizëm do të zhbëhet niveli i ulët i transparencës në përpilimin e politikave, raportimin e zbatimeve fiskale, si dhe në përgjithësi te përgjegjësia institucionale.

Me kohë kjo do të krijoj një mentalitet ku inercioni mes korruptuesit dhe të korruptuarit do të stabilizohet, me ç'rast thyhet ligji, krijohen privilegje të ndryshme nga qeveria, kurse arka e shtetit dëmtohet. I korruptuari do të kërkon kompozime nga korruptuesi, madje i korruptuari mund të ofrohet edhe i pari. Me kohë ajo që dukej e tmerrshme do të bëhet gjithnjë e më shumë normale dhe vetë shoqëria do ta trajtojë si normale si dhe do ta tolerojë. Në disa shoqëri si për shembull ato në shtetet e Sub-Saharasë të cilat autori Anëtar Shah i merr si shembull, janë relacionet shoqërore ato që pamundësojnë pavarësinë dhe e paanshmërinë e personelit të punësuar në administratë, ngase ai mund të jetë i sistemuar aty vetëm në rast të lojalitetit të treguar ndaj klanit nga i cili vjen. (Shah, 2007, f. 355)

Në shumë vende ku kjo anomali do të fillon të jetë normale, zyrtarët e tillë të korruptuar nuk do të dënohen, por sikurse e vërejnë disa studiues, kjo është një nga arsytet më të mëdha përse paga bëhet e parëndësishme, prandaj rëndom edhe nuk mendohet që të ketë rritje të pagave në poste qeveritare dhe ato të ndryshme institucionale. Çuditërisht, përkundër posteve të rëndësishme me përgjegjësi të lartë shtetërore, pagat e këtyre bartësve institucional mbeten të vogla, madje edhe disproporcionale, por qëllimisht lihen kështu, ngase hartuesit e buxhetit të këtyre pagave, apriori nisen nga presupozimi se zyrtarët janë të korruptuar dhe nuk kanë nevojë për paga të mira.

Kur bëhet fjalë për shkëmbimet ndërshtetërore, ku politika ka ndikim në përcaktimin e interesave ekonomike, ka faktorë shtesë që motivojnë korrupsionin. Së pari, janë përmasat në rritje të tregtisë ndërkombëtare, që imponojnë transaksionet ndërkombëtare, së dyti janë, ndryshimet e vazhdueshme ekonomike të cilat kur realizohen në një shtet kanë efekt në shtetin tjetër me të cilin zhvillohen këto shkëmbime.

Rritja e tregtisë ndërkombëtare si dhe prodhimit i cili nuk njihet kufijtë shtetëror, ka krijuar situata të ndryshme e madje ka gjetur mënyra për të legalizuar disa aspekte të korrupsionit që me eufemizëm i hasim me terminologji të ndryshme të përshtatur, si “pagesa e komisionit”, “ndërmjetësimi”, “përqindja e merituar”, etj.

Të gjithë këta mekanizma të cilët akomodojnë forma të caktuara të korrupsionit motivojnë keqpërdorimin e posteve zyrtare, dhe përveç korrupsionit kanë efekte zinxhirore të dëmshme ngase duke e zhbërë barazinë në konkurrencë, ngadalë i imponojnë kompanive të tjera që ato të shohin gjithashtu korrupsionin si një mjet normal për të depërtuar në treg. Kudo në botë ka raportime mbi shkallë të madhe të korrupsionit me qëllim të tërheqjes të kontraktuesve të huaj e deri te krijimi i privilegjeve në treg dhe shmangja e taksave.

Kjo ndodh fatkeqësisht edhe në demokracitë e zhvilluara, kurse terminologjia e përmendur më lartë ka arritur të relativizojë konceptin mbi korrupsionin duke e bërë mjet efikas në menaxhimin e kompanive. Raste të tilla ka edhe në vendet që me traditën e tyre shtetërore në njëfarë mënyre i dhanë jetë Unionit Evropian, si Franca apo edhe Gjermania.

Në shkrimin e përfolur të publikuar me 17 maj 1995, e përditshmja prestigjioze franceze “Le Monde”, i bënë opinionit me dije se kompani të ndryshme franceze, i kanë paguar qeverive të ndryshme të huaja jashtë Francës dhe atë vetëm gjatë vitit 1994, 10 miliardë franga franceze. (Tanzi, 1998, f. 8)

Dy vite më vonë me 4 mars 1996, revista “Uorld Biznes”, raportoi për kompanitë gjermane, të cilat për të depërtuar në tregjet e huaja jashtë Gjermanisë, kishin paguar rreth 3 miliard dollar amerikanë vetëm gjatë një viti, duke korrupsionuar zyrtar qeveritar në vende ku vepronin. Duke iu referuar kësaj dhe në përgjithësi analizave që i bëhen atyre viteve, ka të ngjarë që në përgjithësi, kompanitë evropiane të cilat depërtonin në tregje jashtë vendit të tyre, kanë paguar rreth 15% të mjeteve të investuara jashtë, duke i bërë ato destinomë për komisionime apo pagesat për të ashtuquajturat ndërmjetësime. Efekti zinxhiror sërish imponon sjellje të njëjtë, si dhe vazhdon të ushtrohet presion edhe mbi kompanitë e tjera që të veprojnë ashtu, përndryshe ballafaqohen me ndërprerje kontratash. (Nordio, 1997)

Ndryshimet ekonomike nën petkun e të ashtuquajturave reforma, kanë nxitur fenomene të reja duke u nisur nga procesi i privatizimit të kompanive, e që përgjithësisht është një proces me anë të cilit, kompanitë nacionale po denacionalizoheshin. As që diskutohet se ky ishte një burim jashtëzakonisht joshës i keqpërdorimeve e që mund të ketë edhe

përmasa të korrupsionit politik dhe si një burim i partive politike, për tu vetëfinancuar dhe për të krijuar vende të punës për militantët e tyre partiak dhe grupe të ndryshme të interesit.

Siç edhe thekson Nordio, një ish prokuror i njohur në lutën anti-mafia në, ky ishte një rast jashtëzakonisht prezent në Itali (Tanzi, 1998, fv. 15-16), kurse përmasat e mëdha u vërejtën edhe në shtetet e Amerikës Latine. Megjithëse qëllimi i proceseve të privatizimit, së paku publikisht është largimi i monopoleve. Vetë fakti se ato janë procese politikisht të kontrolluara dhe të menaxhuara, i japin mundësi individëve si bartës të pozitive zyrtare me autoritet në shtet, qoftë në diskrecionin e lejuar bazuar në kompetenca, apo qoftë edhe duke u lënë duart e lira gjatë procesit të vendimmarrjes, të manipulojnë me procesin e privatizimit, respektivisht me këtë, të jetë faktorët përcaktues në kuptimin që të vendosin se kush mund, e madhe edhe kush nuk mund të jenë pronarët e ri.

Me këtë, në vend që të largojnë monopolet, ato i forcojnë edhe më shumë saqë monopolet bëhen agresivisht të fuqishme. Në situata të tilla monopoli merr kuptim më të gjerë, ngase në vend të disa kompanive monopoliste në treg, tani krijohen pronarë që kanë monopolin mbi disa kompani, respektivisht monopolin e tërësishëm mbi degë të caktuara industriale.

As që diskutohet se përmasat e keqpërdorimeve zyrtare përshkallëzohen tepër, kur bëhet fjalë për vendet me paqëndrueshmëri politike dhe ekonomike. Kështu p.sh Afganëve iu duhet që 25% të të ardhurave të tyre vjetore, t'i ndajnë për mitën, të cilën duhet destinuar për zyrtarët e korruptuar, ndryshe nuk mund të realizojnë asnjë të drejtë të tyre sa herë që ballafaqohen me administratën publike. (Jeremy Horder & Alldridge, 2013, f. 2)

Kapitulli III

E Drejta Ndërkombëtare dhe Legjislacioni në Kosovë

3.1. E drejta ndërkombëtare

Përfundimi i luftës së Dytë Botërore, nxiti Organizatën e Kombeve të Bashkuara që kontributin e saj ta drejtojë edhe në zhvillimin e kuadrit ligjor, përfshirë edhe të së drejtës penale ndërkombëtare. S'do mend se një konsolidim i tillë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara paraqitet si produkt apo si rezultat i faktit që lufta e Dytë Botërore solli me vete pasoja shkatërruese dhe të pa riparueshme për mbarë njerëzimin, por që tani po fillonte një rend i ri botërorë.

Kontributi i OKB-së pas Luftës së Dytë Botërore, kryesisht shprehet me aktivitete të ndryshme në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, kryesisht duke aprovuar një numër të madh të konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, dhjetori i vitit 1946 shënoi kthesë të madhe në këtë drejtim. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, nxori rezolutën e cila verifikon parimet e Statutit të Gjykatës Ushtarake të Nurembergut. (UN, 1946; Salihu I., E Drejta Penale Ndërkombëtare, 2011, f. 63)

Si rrjedhojë vetëm dy vite më vonë me 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, aprovoi “Konventën mbi parandalimin dhe ndëshkimin e gjenocidit”. Përtej kësaj në këtë konventë u sugjerua që edhe shtete anëtare të OKB-së, në legjislacionet e tyre penale të parashohin krimin e gjenocidit si vepër penale. (Salihu, E Drejta Penale Ndërkombëtare, 2011, f. 55)

Pastaj edhe iniciativa e Kryqit të Kuq Ndërkombëtarë, vetëm një vit më vonë, me 1949, në Gjenevë, nxori edhe katër konventa mjaftë të rëndësishme që pastaj do të ndikonin në zhvillimin e mëtutjeshëm të së drejtës ndërkombëtare, e të cilat janë: Konventa se si duhet vepruar ndaj të zënëve robër; Konventa mbi mbrojtjen e personave civil gjatë kohës së luftës; Konventa për përmirësimin e gjendjes së të plagosurve, të sëmurëve, dhe të personave anija luftarake e të cilëve është fundosur; si dhe fare në fund edhe Konventa për përmirësimin e gjendjes së të plagosurve dhe të sëmurëve në forcat e armatosura në luftë.

Nëpër literaturat e ndryshme këto konventa janë të njohura si konventa të Gjenevës, dhe si të tilla u ratifikuan nga një numër i madh i shteteve të botës, derisa veprat penale të parapara në to, janë të inkorporuara në kodet penale, për shembull:

- Krimi i gjenocidit,
- Krimet e luftës kundër popullsisë civile,
- Krimet e luftës kundër të plagosurve dhe të sëmurëve,
- Krimet e luftës kundër të zënëve robër, etj.

Si dokumente të tjera të rëndësishme për të drejtën penale ndërkombëtare janë:

- Konventa për mbrojtjen e vlerave kulturore gjatë kohës së konflikteve të armatosura, e cila u aprovua në vitin 1954;
- Konventa mbi mosparashikimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, e aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1968;
- Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së(1968);
- Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, të cilat si pikë referimi kanë ndalimin e përdorimit të disa llojeve të armëve, siç janë ato të viteve 1961, 1972 dhe 1974, me të cilat dënohet përdorimi i armeve nukleare dhe llojet e tjera të armëve për asgjësim masiv, shembull bombat napalm;
- Konventat e Gjenevës për mbrojtjen e viktimave të luftës(1949) dhe
- Protokollet plotësuese të Gjenevës për mbrojtjen e viktimave të luftës 1977.

Konventat tjera janë si vijon:

- Konventa për detin e hapur,
- Konventa e Tokios
- Konventa e Montrealit për sigurinë e trafikut ajror dhe rregullimin e fluturakeve,
- Konventa e Hagës,
- Konventa kundër torturës dhe formave të tjera jo humane dhe sjelljeve degraduese,
- Konventa në fushën e drogave, duke e përfshirë edhe konventën e re të tregtisë me drogë dhe substanca të tjera psikotrope të vitit 1988.

Një numër i madh i këtyre konventave, janë nxjerrë në bashkëpunim me organizatat e tjera ndërkombëtare siç janë:

- Kryqi i Kuq Ndërkombëtar
- Organizata Ndërkombëtare për Aviacionin Civil, etj.

Me këto konventa dhe protokolle janë përcaktuar dispozita me të cilat obligohen shtetet anëtare të OKB-së, që i kanë ratifikuar ato, që në procedurën penale e cila zhvillohet kundër personave të akuzuar, të zbatohen standarde të unifikuara dhe të përcaktuara ndërkombëtare të kësaj procedurë. Andaj, edhe njëherë lirshëm mund të themi se këto konventa, dokumente ndërkombëtare, janë intensifikuar në drejtim të trendit të zhvillimit të drejtës ndërkombëtare vetëm pas Luftës së Dytë Botërore nga ana e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në përgjithësi, përfundimi i Luftës së Dytë Botërore shënon një kthesë intensifikimi të së drejtës ndërkombëtare. (Salihu, E Drejta Penale Ndërkombëtare, 2011, f. 38). Dokumente tjera ndërkombëtare të rëndësisë së veçantë për temën e trajtuar në këtë punim doktore, pa mëdyshje se janë, Konventa e Kombeve të bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa e Kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional.(Hetemi Mehdi & Jashari Nexhat, Konventa e Kombeve të bashkuara kundër Korrupsionit me komentim, faqe 10, Prishtinë, 2013)

Duhet thënë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin e saj 22 (Kushtetuta, 2008, f. 6), ka të inkorporuara shumë nga këto konventa dhe në përgjithësi i është përshtatur frymës së tyre. (Salihu, Zhitija, & Hasani, Komentar, 2014, f. 3)

Krahas këtyre konventave, në veçanti pas tyre roli i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare penale, është shprehur kryesisht me anë të rezolutave, rekomandimeve e parimeve, ku kryesisht këto iniciativa do të shërbejnë në parandalimin e kriminalitetit si dhe unifikimin apo standardizimin e këtyre dokumenteve, të cilat duhet të implementohen në legjislacionet e ndryshme penale nacionale të shteteve përkatëse, të cilat janë pjesë e OKB-së.

Instrumente të tjera të ndryshme të Kombeve të Bashkuara, për të Drejtën Penale Ndërkombëtare, kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm edhe në të ashtuquajturën “model-marrëveshje” me të cilin është rregulluar bashkëpunimi bilateral midis shteteve

në sferën e ekstradimit dhe të formave të tjera të ndihmës juridike në lëndët penale. Këto dokumente kur bëhet fjalë për shembull në rastet e ekstradimit, nuk rregullojnë në formë të detajuar proceset bilaterale mes shteteve për ekstradim të personave të ndryshëm, por janë dokumente që shërbejnë në ndihmesë dhe hapjen e rrugës për marrëveshje ndërshtetërore-bilaterale në këtë fushë, të cilat pastaj në marrëveshje në mes tyre, rregullojnë në mënyrë të specifikuar dhe të detajuar kushtet dhe mënyrat e ekstradimit të personave.

Kur me 1977 SHBA-të, aprovuan ligjin mbi “praktikat e korrupsionit të jashtëm”, ky vend u bë shteti i parë i cili i ndaloi shtetasve të vet të korrumpojnë zyrtarë të shteteve të tjera (Mbaku, 2010, f. 124). Deri atëherë nuk ekzistonte asnjë shtet që në çfarëdo mënyre i qasej problemit kur ndërmarrjet e mëdha të cilat po investonin në shtetet e tjera, ofronin mito në forma të ndryshme, zyrtarëve të jashtëm, për të depërtuar më lehtë në treg apo për ndonjë arsye tjetër që ndërlidhej me përfitime të drejtpërdrejta. Sot, është i madh numri i shteteve që kanë përcjellë shembullin e vitit 1977, ky numër po rritet vazhdimisht. (Jeremy Horder & Alldridge, 2013, f. 208)

Kur SHBA-të po shqyrtonin këtë ligj në fillim të viteve ‘70-ta, ato njëherazi tentonin që korporata multinacionale me bazë në SHBA, t’i krijonin kushte të konkurrencës të barabartë, pavarësisht se kishte të bënte me një territor i cili ishte jashtë juridiksionit amerikanë.

Vendimin e SHBA-ve e përcolli edhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, si dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD).

Neni 8.5 i “Konventës së Organizatës të Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”, kërkon nga zyrtarët publikë, ndër të tjerash, çdo punësim tjetër, investime dhe pasuri tjetër si dhe dhurata dhe përfitime substanciale (UNODC, 2004). Udhëzimi Ligjor për zbatimin e Konventës Kundër Korrupsionit, lidh këtë kërkesë me nevojën për të adresuar konfliktet e interesit në raport me funksionet publike. Kjo, megjithatë, është e qartë se nuk paraqet qëllimin e thjeshtë të praktikës, që natyrisht mund të jetë relevante me aspektet e tjera të luftës kundër korrupsionit, përfshirë këtu edhe ndjekjen penale të krimeve të cilat drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejt janë të lidhura me pasurimin e

paligjshëm të zyrtarit publik, e rrjedhimisht me këtë edhe me keqpërdorimin e detyrës zyrtare dhe autoritetit.

Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit e vitit 2003, sërish nuk jep një përkufizim për korrupsionin, bazuar në supozimin se koncepti ndryshon vazhdimisht dhe se, nga natyra e vet, ai përfshin qasje të shumëllojshme. Konventa merr një qasje përshkruese duke mbuluar format e shumëllojshme të korrupsionit që ekzistojnë aktualisht, duke ofruar gjithashtu një kuadër për format e korrupsionit që ende mund të shfaqen në të ardhmen.

Shtetet anëtare të Konventës, penalizojnë veprat penale si vijon: mitdhënien / mitmarrjen, tregtimin e influencës, abuzimin me funksionet, pasurimin e paligjshëm (duke përfshirë sektorin privat), pastrimin e të ardhurave nga krimi, fshehjen dhe pengimin e drejtësisë. Konventa gjithashtu i detyron shtetet që të vendosin përgjegjësinë e personave ligjorë si dhe të kriminalizojnë pjesëmarrjen dhe tentimin.

Në vitet e '90-ta, ligjet e ngjashme në nivel supranacional do të aprovohen edhe nga Këshilli i Evropës, Unioni Afrikan dhe Banka Botërore (Deming, 2014, f. 2).. Kështu ngadalë do të krijohen edhe normat e para ndërkombëtare lidhur me problemet e korrupsionit në relacione ndërshtetërore.

Në vitin 1997, OECD aprovoi konventën për të luftuar korrupsionet ndërshtetërore e që njëherazi i detyroi shtetet anëtare që të hetojnë transaksionet e dyshimta, e njëjta hyri në fuqi me 1999 (Deming, 2014, f. 9). Konventa zyrtarisht quhet “Konventa për luftimin e korrupsionit të zyrtarëve të huaj publik në transaksione ndërkombëtare të biznesit”.

Në një botë gjithnjë e më dinamike, ku korporatat multinacionale dhe jo vetëm ato, po përpiqeshin të krijojnë filialet e tyre në botën e tretë, e që ishin kryesisht vende të pazhvilluara dhe ato në zhvillim. Kështu u tentua të ndalohej fenomeni i transaksioneve korruptive ku për objekt ishin zyrtarët publik që po keqpërdornin detyrat dhe pozicionet, pavarësisht se juridiksionet e shteteve të tyre e toleronin këtë.

Në kapitullin e parë të aktit të OECD-së, korrupsioni qartë quhet si krim, me anë të të cilit qëllimshëm i ofrohet një personi një përfitim apo edhe një premtim për këtë, pavarësisht nëse ai është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes

ndërmjetësuesve. Kusht me konstatime të tilla po zvogëlohej dukshëm hapësira e manipulimit të keqpërdorimit të detyrave nga ana e zyrtarëve publik. (Pieth, Low, & Cullen, 2007, f. 45)

Madje krim nuk do të konsiderohet vetëm dhënia e mitos, por edhe vet tentimi për ta realizuar këtë. Tutje konventa sqaron se çka nënkuptohet me nocionin “zyrtar publik i jashtëm”. Me këtë konventa standardizoj terminologjinë dhe tani me këtë nocion po përfshiheshin të gjithë zyrtarët që po mbanin një post legjislativ, administrativ, gjyqësor, pavarësisht nëse janë të zgjedhur apo të emëruar, çdo person që kryen një funksion publik, përfshirë këtu agjencitë dhe ndërmarrjet publike apo çdo zyrtarë tjetër pjesëtarë i ndonjë organizate ndërkombëtare publike. Tutje konventa sqaron se çka nënkuptohet me nocionin “i jashtëm”. Duke saktësuar që kjo përfshinë të gjitha nivelet në kuadër të një shteti që nga qeveria qendrore e deri tek pushteti total.

Në kapitullin e tretë përmenden edhe sanksionet kundër personave që involvohen në dhënie të mitos dhe në marrjen e mitos. Aty kërkohet nga të gjitha shtetet anëtare që në rastet e konstatimit të marrjes së mitos apo edhe të pasurisë e cila korrespondon me marrjen e mitos, në atë rast mitën e marrë dhe kjo pasuri mund të jenë objekt konfiskimi, apo edhe ndaj personave që kanë keqpërdor detyrën zyrtare, mund të aplikohen dënime që kanë efekt të barabartë me konfiskimin. Gjithashtu, çdo palë nënshkruese e kësaj konvente obligohet që të shqyrtoj marrjen e masave dhe të dënimeve mbi individin i cili ofron mitën.

Konventa e OECD-së, është akti i parë serioz ndërkombëtar që e kishte si qëllim veç tjerash dhe më nuk linte hapësirë të korrupsioneve të pandëshkuara përtej kufijve shtetëror, kurse deri atëherë, përjashtuar ligjin e përmendur të SHBA-ve të vitit 1977, individët që ofronin mitën, e bënë këtë lirshëm pa drojën nga sanksionet ligjore në shtetin ku jetonin.

Konventa e OECD-së, i referohet shumë gjerësisht akteve korruptive, andaj si të tilla i përfshinë edhe fenomenet e shpëlarjes së parasë në situata ndërshtetërore, çështjet e kontabilitetit. Deri atëherë këto dy fenomenet e fundit, nuk konsideroheshin si diçka që binte në kundërshtim me ligjet dhe ishin një praktikë e përhapur kudo.

Në kuptimin e juridiksioneve territoriale - shtetërore, Konventa përmend ekstra-territorialitetin, kurse hapte rrugën për juridiksione në dy drejtime, me ç'rast dënimin mund të aplikonte edhe shteti i korruptuesit edhe i të korruptuarit. Deri me 2014, konventa u nënshkrua nga 34 shtete anëtare, si dhe disa shtete tjera jo-anëtare Argjentina, Brazili, Bulgaria, Kolumbia, Rusia dhe Republika Jug-Afrikane. (Deming, 2014, f. 9)

3. 2. Legjislacioni i Unionit Evropian

Në përgjithësi lufta kundër korrupsionit dhe në veçanti lufta kundër keqpërdorimeve të detyrës zyrtare e që njihet si korrupsioni institucional apo korrupsioni i sektorit publik paraqet një çështje të rëndësishë së jashtëzakonshme për legjislacionin e unionit Evropian, kurse posaçërisht erdhi në shprehje me zgjerimin e Unionit gjatë vitit 2004, e pastaj edhe gjatë vitit 2007, kur anëtarë të Unionit Evropian u bënë Rumania dhe Bulgaria. Në rastin e këtyre dy vendeve strukturat e Unionit e morën më seriozisht krijimin e institucioneve dhe mekanizmave ku qytetarët mundnin të adresonin keqpërdorimet e detyrës zyrtare, në mënyrë që tutje ky fenomen të luftohet. Sikurse edhe më parë, vetë ekzistimi i një sistemi të unifikuar të të drejtës penale evropiane, ka përfshirë dispozita të shteteve anëtare. (Salihu, E Drejta Penale Ndërkombëtare, 2011, f. 45)

Të gjitha elementet që përbëjnë sot themelet e të drejtës evropiane, pavarësisht se për cilin shtet bëhet fjalë, i janë nënshtruar qoftë referendumeve, qoftë votimit konfirmues në Parlamentet përkatëse (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 38), por nuk duhet harruar se disa tendenca për krijimin e bashkëpunimit në domenin e të drejtës penale, zënë vend shumë më para, para se të lindte ideja mbi Unionin Evropian, e këtui në radhë të parë mendohet në Konventën Frenko-Belge të vitit 1843, apo edhe pak më vonë me Konventën e Majnhajmit me 1868. (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 18)

Gjithsesi, vetë përpjekjet moderne për unifikim dhe krijim të një hapsire të përbashkët evropiane sa i përket sistemit juridik në përgjithësi, mund të thuhet se fillojnë me 1996, me iniciativën e përbashkët të një grupi të gjykatësve nga vende të ndryshme të Unionit Evropian. (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 51).

Gjithshtu, edhe para vetë kësaj iniciative, qysh me 1971 kishte përpjekje për krijimin e një Kodi Penal të përbashkët evropian. (Salihu, E Drejta Penale Ndërkombëtare, 2011, f. 49)

Standardet në pjesën e tretë të parimet e Unionit Evropian, neni 20 i Konventës së Drejtës Penale për Korrupsion (Këshilli i Evropës) kërkon që të funksionojë së paku një organ kundër korrupsionit, i specializuar për parandalimin e korrupsionit dhe për luftimin e tij, të cilit dokumenti i Unionit Evropian i kushton kujdes të veçantë. Ky organ i specializuar duhet të gëzojë një shkallë të lartë të pavarësisë dhe mund të veprojë si një forcë e fuqishme koordinuese. Fakti që kompetencat e tij prekin të gjitha elementet e sistemit dhe shpesh plotësojnë ato të institucioneve “të përgjithshme” e vë atë në pozitën më të mirë që të stimulojë kontributin e tyre dhe nganjëherë të merr iniciativë të drejtpërdrejt nëse ato dështojnë të bëjnë një gjë të tillë.

Por, shumë vite para se shtetet e reja të Evropës Juglindore ti bashkëngjiteshin Unionit Evropian, filluan të krijohen konturat e para të luftimit të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, prandaj qysh me 1995, Parlamenti Evropian aprovoi rezolutën për luftimin e korrupsionit në Evropë e ku veç tjerash thuhet “Shprehia e individëve qoftë brenda përgjegjësive zyrtare apo private të cilët dështojnë të përmbushin detyrat e tyre për shkak të përfitimeve financiare apo edhe të tjera”.

Në vitin 1997, Komisioni Evropian qartësoi më tutje konceptin duke plotësuar me referime lidhur me keqpërdorimin e detyrës zyrtare e ku thuhet “ çdo abuzim me pushtetin apo përvetësim në një proces të vendimmarrjes i bërë me qëllim drejt një përfitimi.” Ky është veç tjerash një koncept i cili do të jetë udhërrëfyes për veprimtarinë e auditorëve të KE. (Szarek-Mason, 2010, f. 7)

Në vitin 2003, në kuadër të legjislacionit të tij unioni Evropian do ti shtojë këtij koncepti edhe një plotësim “abuzim me pushtetin për përfitime private”. Në njëfarë mënyre këto konceptime të cilat edhe do të inkorporohen në legjislacionet përkatëse të Unionit, ndonëse nuk janë shumë larg me konceptimet e tjera si ato të Bankës Botërore apo edhe të Organizatave Joqeveritare, megjithatë po përdoren si koncepte origjinale të Unionit Evropian.

Me politikat e tij Unioni Evropian ka bërë një dallim në trajtimin e ligjeve që luftojnë krimin me konceptet mbi korrupsionin, gjë që i ka ndihmuar të krijoj më lehtë instrumente të mbikëqyrjes madje edhe të parandalimit. Siç edhe thamë më herët, Kombet e Bashkuara, por edhe Këshilli i Evropës gjithashtu kishin një qasje më të gjerë të përkufizimit të akteve korruptive në kryerjen e detyrave zyrtare që në përgjithësi mund të cilësohet si një tendencë për të kriminalizuar më gjerësisht aktet korruptive të bartësve institucional.

Megjithatë duhet pranuar se përkufizimi i adaptuar nga Unioni Evropian “mbi abuzimet të pushtetit për përfitime private” është i mjaftueshëm për të përfshirë gati të gjitha format e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, pavarësisht faktit që ai nuk bënë një rrumbullakim të qartë se cilat forma i përfshinë në tërësi. Kjo me veti bartë paqartësi dhe ngrit dilema se çfarë mund të bisedohet saktësisht për përfitim privat dhe nëse diçka konsiderohet si përfitim privat, atëherë a ngritet pyetja mbi sasinë e përfitimit. Ndoshta kjo është edhe një arsye, përse në disa vende gjë që në kuadër të Unionit Evropian është e uniformuar, vendoset vija e kuqe e cila e ndanë të konsideruarit të përfitimit privat me shpërblime që nuk konsiderohen përfitime e ku faktorë determinues është sasia.

Bie në sy që mekanizma të Unionit për të luftuar keqpërdorimin e detyrës zyrtare në një kontekst më të gjerë, janë siguruar disa mekanizma ligjor si:

- Ligjet përkatëse
- Imuniteti i kufizuar i zyrtarëve publik dhe përfaqësuesve të zgjedhur
- Implementimi i rregullave të transparencës në gjithë administratën publike
- Rregullimi i sistemit për rekrutimin e shërbyesve civil
- Krijimi i trupave që luftojnë korrupsionin
- Rregulla të qarta se si mund të financohen partitë politike
- Të siguruarit e lirisë së medieve
- Garantimi i pavarësisë së gjyqësorit.

Ky nuk ishte një proces i lehtë, ngase kishte qeveri kombëtare që hezitonin që të gjitha këto kompetenca të përmendura më lartë ti transferonin tek Unioni Evropian. Në këtë drejtim, siç edhe përshkruan autori Varner, duhet pranuar se disa nga shtetet anëtare toleronin keqpërdorimet madje edhe ato në sektorin doganorë, nëse për këtë shihnin se

ka interes shteti dhe se kjo joshte kompani të huaja, përkatësisht investitorët potencial nga jashtë.

Konstatimi i Varnerit në njëfarë mënyre e qartëson tensionin i cili ekzistonte në mes Unionit dhe shteteve anëtare, më saktësisht ndërmjet shteteve që dëshironin të vazhdojnë me sovranitetin tradicional kur bëhet fjalë me luftimin e keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe të atyre shteteve që njëmend kishin për qëllim të çrrënjoshnin këtë dukuri duke mos toleruar asnjë nivel të abuzimit të pushtetit.

Një nga sferat ku u aplikuan standardet e para të anti-korrupsionit nga ana e Unionit Evropian, ishte Prokurimi Publik. Në këtë drejtim legjislacioni u kujdes që të ketë transparencë të mjaftueshme në procedurat e përzgjedhjes së fituesit si dhe qasje të barabartë për ofertat e operatorëve ekonomik. Kjo është edhe e arsyeshme nëse kemi në konsideratë se Prokurimi Publik është i ndjeshëm në praktikat kolektive dhe në favorizimet që mund të bëjnë zyrtarët kompetent.

Kur bëhet fjalë për larminë e cila ende mbretëron në Evropë, në njëfarë mënyrë ka elemente të një bipolariteti praktik sa i përket sistemit të drejtësisë dhe të drejtës penale. Kjo vjen si pasojë e traktateve të shumta të nënshkruara, që jo rrallë krijojnë ambiente të paralelizmave. Në anën bazuar edhe në atë që u nënkuptua duke u thënë më lartë, shtetet kanë edhe një spektër të marrëdhënieve kontraktuese të veçanta.

Derisa ekziston një konglomerat i organizatave të shumta evropiane kundër korrupsionit, janë dy në të cilat fokusohet ky dokument: Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), i themeluar në vitin 1999 nga Këshilli i Evropës, dhe Partneriteti i Qeverive të Hapura, i themeluar me 20 shtator 2011.

Qëllimi i GRECO-s është që të monitorojë përmbushjen e standardeve kundër korrupsionit nga shtetet anëtare të organizatës. Standardet e GRECO-s kundër korrupsionit organizohen rreth njëzet parimesh udhëzuese të vëna nga Komisioni i Ministrave të Këshillit të Evropës me 1997. Këto parime përfshijnë: kriminalizimin e korrupsionit, kufizimin e imunitetit nga akuzat hetuese të korrupsionit për zyrtarët e lartë publik, nxitjen e hetimeve të korrupsionit, miratimi dhe zbatimi i kodeve të sjelljes për shërbyesit dhe zyrtarët civil.

Kosova nuk është anëtare e GRECO-s, edhe pse anëtarësimi në të nuk kufizohet me shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. GRECO i ka 49 shtete anëtare, të gjitha vende evropiane përveç Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pak a shumë, hapësira e madhe evropiane e trefishtë, ku një komponentë mbeten vendet potenciale për tu anëtarësuar siç është edhe rasti i Republikës së Kosovës, dy komponentët tjerë të dallueshme në sistemin e drejtësisë padyshim e gjen në hapësirën e krijuar nga Këshilli i Evropës, si dhe atë të krijuar nga Unioni Evropian. Kur bëhet fjalë për vetë Këshillin e Evropës, duhet potencuar se ky institucion është një nga kontribuuesit më të madhë sa i përket të së drejtës penale, dhe në përgjithësi fushës juridiko-penale. (Salihu, E Drejta Penale Ndërkombëtare, 2011, f. 214)

Gjithsesi këto nënsisteme janë unifikuar me kohë dhe gjithnjë e më shumë kanë tipare dhe përmbajtje të një sistemi të unifikuar të drejtësisë, i cili pashmangshëm reflekton edhe mënyrat e zbatimit të të drejtës penale. Pra gjithnjë e më shumë, mund të thuhet se ka një tërësi që quhet E Drejta Penale Evropiane. Tërësia e tillë, së bashku me përvojën e deritanishme, e sidomos me përvojën me disa prej shteteve të reja anëtare të kyçura në Union Evropian, mund të përdoret gjatë sinkronizimit të legjislacionit për luftimin e korrupsionit zyrtar, për shtete që janë kandidat potencial për të qenë anëtar të Unionit. (Szarek-Mason, 2010, f. 239)

Në anën tjetër vetë trajtimi i deritanishëm nga ana e Unioni Evropian, më shtete anëtarë gjatë procesit të anëtarësimit, ku lufta kundër korrupsionit ishte një nga elementet më të pranishme gjatë bisedimeve, flet vetvetiu se deri në çfarë mase proceset e luftës kundër korrupsionit ndërlidhen me botëkuptimet rreth krijimit të një ambienti demokratik. (Szarek-Mason, 2010, f. 244)

Natyrisht baza themeltare e ekzistimit të të Drejtës Penale Evropiane, është bashkëpunimi ndërmjet shteteve dhe ndihma e ndërsjellë. Vetë E Drejta Penale Evropiane në këtë rast, jep elemente shtesë për frymën e përbashkët të “evropianizimit” në përgjithësi sa i përket kuadrit ligjor, por gjithashtu edhe përtej tij. (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, fq. 46-47)

3. 3. Korniza kushtetuese e Kosovës

Me 15 Maj të vitit 2001 gjatë kohës së pranisë të administratës ndërkombëtare civile në Kosovë, nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Kombeve të Kombeve të Bashkuara, u nënshkrua rregullorja e UNMIK-ut, me anë të së cilës hunë në fuqi Korniza Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, e cila përshkruan institucionet të cilat do të jenë në duar të Kosovarëve. (Korniza Kushtetuese, 2002)

Kreu i IV-të i këtij dokumenti, përcakton institucionet në Kosovë në përgjithësi, kurse pjesa e katërt e këtij kreu specifikon sistemin gjyqësorë. Aty thuhet se gjykatat janë përgjegjëse për administrimin e drejtësisë në përputhje me ligjin. Përcaktohet që Kosova të ketë Gjykatë Supreme, gjykata të qarqeve, gjykata komunale, gjykata për kundërvajtje.

Sipas Kornizës Kushtetuese, parashihej që Kosova të ketë një zyrë për prokurorinë publikë të Kosovës si dhe zyrat për prokurori publike të organizuara nëpër qarqe (distrikte rajonale) dhe komuna si njësi të pushtetit lokal. Zyrat e Prokurorisë Publike duhet të ushtrojnë funksionet në përputhje me ligjin.

Korniza kushtetuese parasheh edhe ekzistimin e një institucioni të quajtur “Kolegji i të i gjykatës supreme mbi çështjen e kornizës kushtetuese”. Sikurse edhe e diktonin rrethanat politike të kohës, edhe korniza kushtetuese thekson marrjen parasysh të instrumenteve juridike ndërkombëtare, gjithashtu të specifikuara në këtë dokument. Korniza kushtetuese parasheh që zyra e prokurorisë publike mund ti drejtohej kolegjit të veçantë të Gjykatës Supreme për çështje të caktuara

Korniza Kushtetuese përfundoi të jetë në fuqi pas deklaratës së pavarësisë të Republikës së Kosovës, të shpallur nga ana e Kuvendit të Kosovës, respektivisht pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në qershor të vitit 2008, kushtetutë kjo e cila hyri në fuqi si kushtetutë e parë e Kosovës së pavarur, e cila nuk cenohet duke e përcaktuar Kosovën si shtet të pavarur.

3. 4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Kosovës e cila ka hy në fuqi në vitin 2008, në nenin 102, parasheh që pushtetin e gjyqësorit në Kosovë e ushtrojnë Gjykatat. Në këtë nen veç tjerash thuhet se pushteti gjyqësor në Kosovë është unik, i pavarur, i drejtë, jo politik, i pa anshëm si dhe siguron qasje të barabartë në gjykata, të cilat sërish theksohet se veprojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit. (Kushtetuta, 2008, f. 40)

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, është qartë e përcaktuar për një sistem të pavarur të drejtësisë, me ç’ rast mendohet se ky sistem të jetë i pavarur në raport me shtyllat e tjera të pushtetit në Kosovë, në raport me të cilat kompetencat janë saktë të ndara, sikurse edhe në praktikën e demokracive me të avancuara.

Qytetarëve u garantohet e drejta për tu ankuar ndaj një vendimi gjyqësor, por në Kushtetutë specifikohet që kjo mund të bëjë një përjashtim nëse me ligj përcaktohet ndryshe. Sikurse edhe në praktikën e përgjithshme edhe në vendet e tjera përfshirë edhe demokracitë në zhvillim, qytetarëve ju lejohet që të referojnë një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, por pas vendimit të Gjykatës Supreme lidhur me rastin, nuk ka më të drejtë ankese.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe mbështetur në nenin 108 të saj, funksionon Këshilli Gjyqësorë i Kosovës, i paraparë si një institucion që siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësorë. Ky është mekanizmi i cili shërben edhe si inspektorat i gjyqësisë dhe në përgjithësi për hartimin dhe administrimin e këtij sistemi.

Neni 109 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, parasheh institucionin të quajtur Prokurori i Shtetit. Është një institucion i pavarur, i ngarkuar me përgjegjësinë e ndjekjes penale të të akuzuarve për vepra penale të përcaktuara me ligj, respektivisht sipas Kodit Penal të Kosovës. (Kushtetuta e R, së Kosovës, 2008, f. 43)

Kryeprokurori i shtetit, e që është njëkohësisht kreu institucional i prokurorisë, emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, mandati i tij është shtatë(7) vjeçar, dhe nuk mund të ketë mandat të dytë për të njëjtin individ, pra një kryeprokuror i shtetit, mund të ushtrojë këtë detyrë vetëm gjatë një mandati.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, parasheh funksionimin e institucionit të quajtur Këshill Prokurorial i Kosovës, dhe kjo parashihet mbështetur në nenin 110 të Kushtetutës. Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucioni i cili i propozon Presidentit kandidatin për Kryeprokuror, duke siguruar që Kryeprokurori të jetë person i pavarur politikisht dhe të jetë veç tjerash profesionist. Këshilli Prokuroria i Kosovës, gjithashtu është i ngarkuar që të rekrutoj dhe të mbikëqyr punën e Prokurorëve. (Kushtetuta, 2008, f. 44)

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, thuhet që propozimet për emërimin e Prokurorëve, të jenë konform një procesi të hapur duke pasur parasysh meritat e kandidatëve. Përndryshe, emërimi i Prokurorëve dhe në radhë të parë i Prokurorit të shtetit, është një proces jo pak i përfolur politikisht, ngase në fund emërimin e tij, e që në fakt është një emërim dhe akt pjesërisht edhe i karakterit formal, ngase bëhet fjalë për një propozim të gatshëm nga Këshilli Gjyqësor, e kryen Presidenti i Republikës së Kosovës.

Mirëpo, kjo është plotësisht në frymën që imponon Kushtetuta, sipas të cilës vetë pozita institucionale e Presidentit të Republikës, është aty për të garantuar unitetin, barazinë si dhe për të shërbyer si një garant i funksionimit normal të shtetit. Prandaj edhe emërimet shumë të rëndësishme, si në rastin e emërimit të Kryeprokurorit të shtetit, janë kompetencë e Presidentit të vendit, dhe pavarësisht faktit që kandidati propozohet nga KPK, sërish Presidenti mund të kthej prapa një propozim të tillë nëse nuk pajtohet me të.

Sigurisht që Presidenti duhet të ketë argument të qëndrueshëm për këtë, megjithëse ligjërisht nuk ka nevojë që të arsyetoj një refuzim eventual të Këshillit Prokurorial lidhur me kandidatin për Kryeprokuror të shtetit, në parim kjo mbetet një çështje në diskrecion të Presidentit.

3. 5. Legjislacioni Penal në Kosovë

E drejta penale e secilit vend është një shprehje e marrëdhënieve shoqërore që ekzistojnë. Mirëpo përkundër dallimeve që ekzistojnë midis të drejtave penale të shteteve të caktuara, ekzistojnë edhe ngjashmëritë e konsiderueshme, sidomos lidhur me mbrojtjen e të mirave që i përkasin individit. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, dhe instalimit të administratës ndërkombëtare civile, kurse në anën tjetër të Institucioneve të përkohshme Vetëqeverisëse, u shfaq nevoja për Kodin Penal i cili do të rregullonte dhe të përcaktonte veprat penale.

Përndryshe qysh në vitin 1948 në Kosovë ishin në fuqi ligje të rëndësishme me anë të cilëve përcaktoheshin si dhe luftoheshin veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare (Salihu, Zhitija, & Hasani, Komentar, 2014, f. XXXII). Këto ligje ishin:

- Ligji mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare;
- Ligji mbi veprat penale ushtarake dhe
- Ligji mbi veprat penale kundër pasurisë së përgjithshme popullore dhe pasurisë së kooperativave dhe organizatave tjera shoqërore.

Kjo do të thotë se pavarësisht regjimit, së paku deklarativisht ka pasur luftim të veprimeve korruptive që mund të ndodhnin gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe autoritetit. (Sluzbeni List, 1948)

Sidoqoftë pas luftës Kosova mbet në një vakum, andaj pikërisht për këtë qëllim, u aprovua dhe hyri në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i cili sikurse tregon edhe emri i tij, ishte i destinuar që të jetë i përkohshëm deri në një Kod të ri Penal.

Në nenin 1, të Kodit të përkohshëm Penal të Kosovës, i cili fletë për parimin e ligjshmërisë, thuhet që një vepër penale përcaktohet vetëm me ligj. Kurse nëse dikush kryen një vepër, e në anën tjetër ligji nuk e konsideron atë si vepër penale, ky nuk konsiderohet shkelje e ligjit edhe pasi që ligji të përcaktoj më vonë një vepër penale të tillë.

Është shumë me rëndësi të ceket që sipas Kodit Penal, nuk lejohet asnjë interpretim i analogjisë së një vepre penale, dhe kërkohet që një vepër penale të përcaktohet saktë. Sikurse u tha edhe më herët, ndaj kryerësit të një vepre penale, mund të zbatohet vetëm ligji i cili ka qenë në fuqi, gjatë kryerjes së veprës penale.

Në praktikë, sipas Kodit Penal edhe nëse ligji i ri eventualisht, nuk inkriminon një vepër, kurse kryerësi i veprës penale është dënuar me aktgjykim përfundimtar në pajtim me ligjin që ishte në fuqi, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet apo të ndërpritet në rast se ka filluar.

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i kushton një kapitull të veçantë, respektivisht kapitullin XXIX veprave penale kundër detyrës zyrtare. Veprat penale të cilësuara si të tilla, janë të përfshira nga neni 339 e deri në nenin 351 (UNMIK/Rreg/2003/25, 2003). Sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, veprat penale kundër detyrës zyrtare, ishin të sistemuara sipas neneve, si vijon:

- Neni 339 - Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit
- Neni 340 - Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës
- Neni 341 - Mashtrimi në detyrë
- Neni 342 - Përdorimi i paautorizuar i pasurisë
- Neni 343 - Marrja e ryshfetet
- Neni 344 - Dhënia e ryshfetit
- Neni 345 - Ushtrimi i ndikimit
- Neni 346 - Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore
- Neni 347 - Zbulimi i fshehtësive zyrtare
- Neni 348 - Falsifikimi i dokumenteve zyrtare
- Neni 349 - Arkëtimi dhe pagesa e paligjshme
- Neni 350 - Lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria
- Neni 351 - Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësorë

Në prill të vitit 2004, Kodi i përkohshëm Penal i Kosovës, do të pësoj disa ndryshime, por ato nuk përfshijnë kapitullin XXIX, i cili përfshinë veprat penale kundër detyrës

zyrtare. Rrjedhimisht me këtë, nenet 339 deri në 351, nuk pësuan ndryshim në kuadër të Kodit të përkohshëm të Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në vitin 2012, bazuar në nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratoi Kodin e ri Penal të Republikës së Kosovës, të regjistruar si Kodi nr. 04/L-082 (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2013). Kodi Penal i Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh parimin e ligjshmërisë, te neni i 8-të i tij, parasheh që mënyra e kryerjes së veprës penale mund të jetë me veprim ose me mosveprim. Tek kjo e dyta, nënkuptohet që kryerësi ka shkaktuar veprën penale duke mos vepruar.

Kodi përmban risi në fushën e përfshirjes së veprave të reja penale të cilat janë konsideruar të rrezikshme për shoqërinë dhe të nevojshme për mbrojtjen e rendit kushtetues në Republikën e Kosovës. Vepra të reja penale të paraparë në kapitujt e këtij kodit janë veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër të drejtave të votimit, veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës, veprat penale kundër integritetit seksual, veprat penale të narkotikëve, veprat penale kundër ekonomisë, veprat penale kundër shërbimeve komunale, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.

Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës, në kapitullin XXIV, të quajtur “Korrupsioni Zyrtar dhe Veprat Penale kundër Detyrës Zyrtare” (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, fv. 204-211), përfshinë nenet me anë të së cilave përcaktohen veprat penale në kuadër të kësaj natyre (Salihu, E Drejta Penale, 2014, f. 28). Këto nene sipas Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës, janë si vijon:

- Neni 422 - Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtarë
- Neni 423 - Keqpërdorimi i informatës zyrtare
- Neni 424 - Konflikti i interesit
- Neni 425 - Përvetësimi në detyrë
- Neni 426 - Mashtrimi në detyrë
- Neni 427 - Përdorimi i paautorizuar i pasurisë

- Neni 428 - Marrja e ryshfetit
- Neni 429 - Dhënia e ryshfetit
- Neni 430 - Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj
- Neni 431 - Ushtrimi i ndikimit
- Neni 432 - Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore
- Neni 433 - Zbulimi i fshehtësisë zyrtare
- Neni 434 - Falsifikimi i dokumenteve zyrtare
- Neni 435 - Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme
- Neni 436 - Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor
- Neni 437 - Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare

Miratimi i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale si dhe i Pakos së ligjeve të gjyqësorit ka qenë, hapi më i rëndësishëm për plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë penale si dhe eliminimit të zbrazëtive dhe mangësive ligjore në këtë fushë.

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës janë përfshirë institute të reja të së drejtës penale, janë inkorporuar dhe sanksionuar vepra të reja penale si dhe janë bërë të gjitha ndryshimet e nevojshme në vazhdimësi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore në Republikën e Kosovës. Republika e Kosovës, tani ka një Kod Penal të saj, mbështetur edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Protokollet e saj.

Kapitulli IV

Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në katër shtete Evropiane, Republika e Sllovenisë, Republika e Gjermanisë, Britania e Madhe, Republika e Shqipërisë, aspekti krahasimtar

4. 1. Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Republikën e Sllovenisë

Republika e Sllovenisë ishte shteti i parë i cili nga shpërbërja e Jugosllavisë iu bashkua Evropës, u integrua në Unionin Evropian, fillimisht duke përmbushur kriteret e parapara për integrim, ndër të cilat kushte, pa mëdyshje harmonizimi i legjislacionit ishte ndër kontributet kryesore në këtë drejtim dhe ndryshimet e bëra në legjislacionin penal u kurorëzuan me ndryshimet ligjore dhe miratimin e Kodit të Ri penal të Republikës së Sllovenisë në vitin 2005. Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare e sidomos veprat penale të korrupsionit të zyrtarëve publik zënë vend të rëndësishëm në ligjin penal të R. të Sllovenisë. Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare janë të specifikuara e të trajtuara në kapitullin e njëzetë e gjashtë ; neni 261 fillon me specifikimin e veprës penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare ku në pikën 3 të këtij neni thuhet “Një zyrtar i cili, me synimin për të siguruar një përfitim të pronës për vete apo për një tjetër, abuzon me detyrën e tij apo i tejkalon kufijtë e detyrave të tij zyrtare apo nuk i kryen detyrat e tij zyrtare,... do të dënohet me burgim jo më pak se tre muaj dhe jo më shumë se pesë vjet.”, gjersa në pikën 4 të po këtij neni thuhet “ Në qoftë se, me kryerjen e veprës penale, kryesi ka fituar një përfitim të madh të pronës e cila korrespondon me qëllimin e tij të parë, ai do të dënohet me burgim jo më pak se një dhe deri në tetë vjet.” Vepra tjetër penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare e trajtës së përvetësimit në detyrë është e specifikuar në nenin 263 ku në pikën 1 thuhet “ Një zyrtar i cili në mënyrë të paligjshme përvetëson para, letra me vlerë ose ndonjë pronë tjetër të luajtshme që i është besuar atij sipas detyrës zyrtare, do të dënohet me burgim jo më shumë se pesë vjet.”(Kodi penal i Republikës së Sllovenisë, 2005).

E veçanta e legjislacionit Slloven sa i përket trajtimit juridiko penal të kategorisë së veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare konsiston në faktin se edhe me një akt tjetër juridik, ligji mbi integritetin dhe parandalimin e korrupsionit i cili shtjellon dhe e rregullon çështjen e keqpërdorimit të detyrës zyrtare si vepër penale, e sidomos

veprën penale konflikti i interesit. Në këtë ligj në nenin 1 thuhet “ Me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit, ky akt përcakton masat dhe metodat që synojnë forcimin e integritetit dhe transparencës, si dhe parandalimin e korrupsionit dhe shmangien e konfliktit të interesit “.(ligji mbi integritetin dhe parandalimin e korrupsionit, R. E Sllovenisë 2010). Shikuar nga këndvështrimi analitik-krahasimtar rezulton se ekziston një analogji në mes të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Sllovenisë sa i përket rregullimit ligjor penalo juridik të kjo kategori i veprave penale.

Megjithatë ka edhe ndryshime në Kodin Penal të Kosovës me atë të Sllovenisë sa i përket llojit të dënimit dhe niveli të tij. Edhe zbulimi i sekretit zyrtar apo keqpërdorimi i informatës zyrtare si vepër penale e kategorisë së veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare është i rregulluar gati në mënyrë identike por dallimet konsistojnë pikërisht në llojin e sanksionit dhe nivelin e tij. Neni 266 i Kodit Penal Slloven e rregullon këtë vepër penale, (dukshëm më e shpeshtë në praktikë dhjetë vitet e fundit F.Q.) duke e specifikuar në pesë pika, ku në pikën 3 qartë thuhet se kushdo që nga personat zyrtar në mënyrë të paautorizuar jep informacione për interes personal apo lakmi të ngjashme kësisoj duke i sjellë dëm institucionit të tij apo interesit publik mund të dënohet me burgim deri në pesë vjet. Në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2013 vepra penale e keqpërdorimit të informatës zyrtare si vepër penale është risi në raport me Kodin paraprak Penal. Kjo vepër penale në Kodin Penal të Kosovës është e rregulluar me nenin 423 specifikuar në pesë paragrafë dhe dallimet me dispozitat e Kodit Penal të Sllovenisë të kjo vepër janë në llojin e dënimeve dhe nivelin e tyre. Pika 3 dhe 4 e nenit 423 parasheh edhe dënim me gjobë prej 5000 euro (pika 3) dhe 50 000 euro (pika 4) për atë që keqpërdorimi i informatës zyrtare rezulton me dobi pasurore apo humbje të cilat tejkalojnë shumat e lartcekura. Vepra penale e marrjes së ryshfetit, mitos, si vepër klasike penale e kategorisë së veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Kodin Penal të Republikës së Sllovenisë është e rregulluar me nenin 267 e specifikuar në katër pika, po ashtu edhe dhënia e ryshfetit, mitos është vepër penale klasike e specifikuar në katër pika në nenin 268. Kur jemi te ky llojë i veprës penale të Kodi Penal i Republikës së Sllovenisë duhet shtuar se si specifike të mitmarrja është trajta e mitosjes së mëvonshme, “mitosja e mëvonshme ekziston kur personi zyrtar ose përgjegjës kërkon apo e pranon dhuratën ose ndonjë dobi pas kryerjes së veprimit

zyrtar të cilin nuk do guxonte ta kryente, respektivisht të cilin ka qenë i obliguar ta kryente ose pas moskryerjes së veprimit i cili do të duhej ta kryente, respektivisht i cili nuk do të guxonte ta kryente... për trajtën e parë të kësaj veprë është paraparë dënimi me heqje lirie prej 1 deri në 5 vjet, për trajtën e dytë është paraparë dënimi me heqje lirie deri në 3 vjet kurse për trajtën e tretë të veprës penale të pranimi të mitos (mitosja e mëvonshme) është paraparë dënimi në të holla ose dënimi me heqje lirie deri në një vjet. Dhurata e pranuar dhe dobia materiale detyrimisht merren me masën e sigurisë për marrjen e objektit “ (Hetemi M. & Jashari N., Konventa e KB kundër korrupsionit me komentim, Prishtinë, 20013)

4. 2. Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Republikën e Gjermanisë

Republika e Gjermanisë jo vetëm që është shtet i madh dhe fuqi ekonomike e politike në Evropë por ajo dhe populli gjerman perceptohen si shtet ligjor dhe qytetarët e këtij shteti si të kujdesshëm ndaj rendit dhe ligjit dhe me një traditë të demokracisë dhe përkushtimit ndaj detyrave zyrtare. Siç edhe është thënë më lartë në këtë punim, Gjermania çështjen e keqpërdorimit të detyrës zyrtare e sanksionon dhe trajton që me kodin penal të vitit 1871 ku dënon q’do shkelje të bërë nga personat zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Në legjislacionin Penal të Republikës së Gjermanisë pa mëdyshje kodi penal zenë vendin kryesor në infrastrukturën ligjore, në të cilin kod në kapitullin e tridhjetë është shtjelluar e rregulluar në aspektin juridik penal çështja e keqpërdorimit të detyrës zyrtare si kategori e veçantë e veprave penale. “ Kodi penal gjerman nën emërtimin “ veprat penale të shkaktuara në detyrë – shërbim, njeh shumë vepra penale të korrupsionit të cilat paraqesin realisht trajta të ndryshme dhe forma të keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimeve “ (Hetemi M, & Jashari N., Konventa e KB kundër korrupsionit me komentim, faqe 324, Prishtinë 2013). Veprat penale të theksuara më lartë paraqiten si trajta të veprës emblematike të keqpërdorimit të detyrës zyrtare siç është korrupsioni dhe janë të specifikuara në nenet 331 si pranim i dobisë, 332 pranim i mitos, dhënia e dobisë neni 333, dhënia e mitos, neni 334. Edhe tentimi i mitdhënies dhe mitmarrjes sipas kodit penal gjerman është vepër e dënueshme. Në kodin penal gjerman sanksionohet përfitimi i paligjshëm, gjegjësisht në nenin 338 është e thënë qartë se konfiskohet pasuria, vlera e arritur me veprim sipas nenit 332 në lidhje me nenin 336, 337 “ do të zbatohen nëse kryerësi vepron në baza komerciale, ose

si anëtar i një bande qëllimi i të cilit është kryerja e vazhdueshme e veprave të tilla“(Kodi penal i Republikës së Gjermanisë).

Me kodin penal gjerman mbrohen edhe shumë vlera tjera shoqërore e publike dhe sanksionohen ato vepra penale të cilat shkelin detyrën zyrtare dhe pengojnë drejtësinë gjermane me ç’ rast cenojnë rrjedhat dhe procesin e vënies së drejtësi në vend.

Neni 339 e specifikon qartë pengimin e rrjedhës së proceseve gjyqësore si vepër penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare në zbatim të drejtësisë ku thuhet “ një gjyqtar, një tjetër zyrtar publik ose një arbitër të cilët në kryerjen ose vendosjen e një çështje ligjore cenon rrjedhën e drejtësisë për të mirën e një pale apo në dëm të një pale do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet” (Kodi penal i Gjermanisë, neni 339).

4. 3. Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Britaninë e Madhe

Britania e Madhe ashtu sikur më lartë që u tha për Gjermaninë, perceptohet si shtet i madh, fuqi ekonomike politike por edhe si shtet me traditë demokratike e sundim të ligjit. Kur jemi te ligji duhet thënë që në fillim se bëhet fjalë për një sistem tjetër juridik në raport me sistemin juridik tek ne, në Slloveni, Gjermani, e Shqipëri, pra dallimi është në sistem, siç dihet në Britaninë e Madhe dominon sistemi Anglosakson prej atij Kontinental që dominon tek ne dhe në vendet e cekura më lartë. Sa i përket keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe luftës kundër korrupsionit në legjislacionin penal anglez akti juridik më relevant konsiderohet Akti kundër ryshfetit apo mitos i miratuar në muajin Prill të vitit 2010. Gjatë elaborimit të dukurisë së keqpërdorimit të detyrës zyrtare si vepër penale, nga aspekti krahasimtar, rasti i Britanisë së Madhe, ne do ti referohemi kryesisht këtij akti juridik i cili e ka fuqinë juridike të ligjit. Edhe në Britaninë e Madhe mitmarrja dhe mitdhënia konsiderohen vepra penale dhe dënohen edhe me burgim, risi e këtij akti juridik është përgjegjësia penale edhe e zyrtarëve të huaj në organizata ndërkombëtare, kompani e korporata. Akti i ryshfetit apo i mitos i Britanisë së vitit 2010 përcakton detyrimin e kompanisë për aktet e korrupsionit të kryera nga personat që veprojnë në emër të kompanisë. Akti ndalon ryshfetin e zyrtarëve publikë dhe ryshfetin ndërmjet bizneseve. Me juridiksion të përgjithshëm,

kompanitë mund të mbahen përgjegjës në Britani të Madhe për aktet e korrupsionit të kryera nga punonjësit, agjentët apo filiale nëpër botë.

Ndryshe nga Ligji për Praktikën e Jashtme Korruptive (FCPA), akti i ryshfeti nuk bën dallim në mes të pagesave për ryshfete të mëdha dhe të vogla, që do të thotë pagesat e lehtësimit si mitdhënie janë të ndaluara.

Gjashtë Parimet e “Aktit Ryshfet” sigurojnë një plan për një sistem të pajtueshmërisë kundër korrupsionit, krijon 'procedura të përshtatshme për të parandaluar ryshfetin nga persona në emër të kompanisë si dhe procedurat e duhura për të siguruar mbrojtje të plotë ligjore. Kjo do të thotë se një kompani ka zbatuar procedurat adekuate para kryerjes së veprës penale të korrupsionit dhe mund të mbrojnë veten nga përgjegjësia e korporatës - përgjegjësinë e kompanive për vepra penale të personave që veprojnë në emër të saj. Kompanitë duhet të krijojnë një përshtatshmëri të mirëfilltë nga rreziku i veprave penale dhe përgjegjësi civile, duke përfshirë edhe gjobat e pakufizuar deri në 10 vjet burg.

4.4. Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Republikën e Shqipërisë

Edhe Republika e Shqipërisë çështjen e keqpërdorimit të detyrës zyrtare e ka të rregulluar në kodin penal të vitit 1995 dhe plotësim ndryshimet ligjore të bëra me 2011, duke ofruar zgjidhje optimale për parandalimin e disa formave më të theksuara të keqpërdorimit të detyrës zyrtare si një dukuri negative e pengimit të sundimit të ligjit dhe zhvillimit të demokracisë. Ndër dispozitat themelore në këtë kontekst pa mëdyshje është neni 248 i cili e rregullon çështjen e shpërdorimit të detyrës zyrtare (ndryshuar me Ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, neni 21; ndryshuar me Ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007, neni 21) ku thuhet shprehimisht se “ kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jo materiale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk

përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë.”

Neni 257, Përfitimi i paligjshëm i interesave mbajtja, ruajtja ose marrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, nga persona me funksione shtetërore apo shërbim publik, i një interesi të çfarëdoshëm në një ndërmarrje ose operacion, në të cilat në momentin e kryerjes së veprimit ka pasur detyrën e mbikëqyrjes, administrimit ose likuidimit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet.

Edhe çështja e korrupsionit dhe luftimi i tij si njëra ndër sfidat themelore e shtetit shqiptar është e trajtuar dhe e rregulluar juridikisht mirë duke e specifikuar në atë aktiv dhe pasiv. Neni 259 e shtjellon korrupsionin pasiv ku thuhet , kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në tre milionë lekë. Edhe qështjen e koruptimit të zyrtarëve të huaj kodi penal i Republikës së Shqipërisë e sqaron dhe e shtjellon mir duke e specifikuar në neni 259/a qështje kjo e rregulluar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës me nenin 430 i cili e sanksionon qështjen e koruptimit të zyrtarëve të huaj.

Neni 259/a kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga nëpunësi i huaj publik, nëpunësi i një organizate publike ndërkombëtare, anëtar i një asambleje të huaj publike apo anëtar i një asambleje ndërkombëtare parlamentare, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy gjer në tetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë gjer në tre milionë lekë. Neni 260 Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë (Ndryshuar me Ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, neni 23) Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një

veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë. Edhe deklarimi i rremë ose mos deklarimi i pasurisë është i kualifikuar si vepër penale në kodin penal të Shqipërisë dhe është e rregulluar me nenin 257/a ku thuhet : Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim (Shtuar me Ligjin nr. 9030, datë 13.3.2003, neni 1; ndryshuar paragrafi i dytë me Ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007, neni 22) (Ndryshuar me Ligjin nr. 23/2012) Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.

Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Në Republikën e Kosovës çështja e deklarimit të rremë apo mos deklarimi i pasurisë është e rregulluar me ligj të posaçëm dhe me këtë çështje merret Agjencia i posaçëm siç është Agjencia anti-korrupsion. Çështja e tenderimeve dhe keqpërdorimit e shumta në këtë segment janë të specifikua në nenin 258 të Kodit penal të Shqipërisë ku thuhet: “kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tenderë dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, dënohet me burgim gjer në tre vjet. Neni 259 Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike “ (Ndryshuar me Ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, neni 22)

Neni 259, Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (Ndryshuar me Ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, neni 22) Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në tre milionë lekë. Neni 259/a Korrupsioni pasiv i

nëpunësve të huaj publikë (Shtuar me Ligjin nr. 23/2012) Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga nëpunësi i huaj publik, nëpunësi i një organizate publike ndërkombëtare, anëtar i një asambleje të huaj publike apo anëtar i një asambleje ndërkombëtare parlamentare, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy gjer në tetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë gjer në tre milionë lekë. Neni 260 Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë (Ndryshuar me Ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, neni 23) Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë.

Kapitulli V

Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare

5.1. Përkufizimi i veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare

Fenomeni i keqpërdorimit të autorizimeve zyrtare dhe pozitës pastaj, veprimi i kundërligjshëm i personave zyrtarë, në veçanti korrupsionit, kanë historikun e tyre në mënyrë kronologjike në të drejtën penale. Mirëpo, sistematizimi i të ashtuquajturave veprave penale zyrtare dhe renditja e tyre në grupe të posaçme, ka ndodhur pothuajse vonë, më saktë në legjislacionin penal të shekullit XIX. Prej atëherë ka filluar edhe përpunimi i rëndësishëm teorik i këtyre veprave penale.

Veprat penale kundër detyrës zyrtare paraqesin sjelljen e kundërligjshme dhe janë instrument i fuqishëm, degradues dhe çrregullojnë funksionimin e rregullt të shërbimeve publike, të cilat i kryejnë personat e autorizuar apo personat zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare ose lidhur me kryerjen e detyrës zyrtare. Andaj, kjo formë e kryerjes së veprës penale në shoqëritë me ekonomi të zhvilluara bien në kategorinë e kriminalitetit në shkallë të lartë rreziku për komunitetin dhe shoqërinë në përgjithësi.

Segmenti i drejtësisë, respektivisht të së drejtës penale që përmban kategoritë e veçanta të veprave penale kundër detyrës zyrtare, vepër që mund të bëhet nga ana personave zyrtar, tentojnë të sigurojnë mbrojtje efikase dhe kualitative të ekonomisë në tërësi në segmentet e saj, si dhe funksionimin e mbrojtur të administratës dhe institucioneve publike në përgjithësi, nga format e ndryshme të keqpërdorimit.

“ Në mënyrë indirekte, individët e inkriminuar me këto lloje të veprave penale, jo vetëm që paraqesin rrezik dhe pasojat janë materiale për shoqërinë por, veprat e tilla paraqesin çrregullimin e rrjedhave normale të një shoqërie normale duke atakuar vlerat morale të kësaj shoqërie, paraqet një degradim i cili njëherazi është sfidë edhe për vetë mekanizmat e shtetit që e luftojnë këtë dukuri, e që shpesh herë njihet edhe si kanceri i shoqërisë, apo edhe si kancer i moralit.” (Rotberg, 2009, f. 37)

Kur bëhet fjalë për vepra penale të keqpërdorimit të pushtetit përmes shfrytëzimit të paluajtshëm të pozitës dhe të autorizimeve zyrtare që këta persona i gëzojnë këto

privilegje në kryerjen e detyrës zyrtare, cenimi i detyrës zyrtare nga ana e këtyre personave zyrtarë, jo vetëm që ka të bëjë me kodin moral dhe shkeljen drastike të tij, por këto veprime të tyre sanksionohen edhe me ligj. Tani dukuri të tilla përbëjnë një të keqe të madhe për çdo shoqëri dhe në përgjithësi jo vetëm për shoqëritë bashkëkohor, e ku ka edhe tregues të saktë që e karakterizojnë këtë fenomen, por të dhënat megjithatë tregojnë se kjo është karakteristike për shoqëritë e vjetra.

Rreziku qëndron në faktin se këto vepra penale i kryejnë personat që janë bartës të autorizimeve zyrtare dhe kjo nënkupton dhe përbënë sulm mbi integritetin e detyrës nga brenda. Kryerja e pandershme, e parregullt, shmangja, dhe ikja e procedurave dhe rregulloreve, shmangja e detyrave autorizuese favorizon edhe zhvillimin e burokracisë dhe çon në korrupsion të administratës. Në këtë relacion shpesh shohim se zhvillimi i burokracisë në disa vende, qofshin ato në zhvillim apo edhe ato tanimë të zhvilluara, ka krijuar administratë të ngadalshme apo të ngathët, në pritje, e kur kemi të bëjmë me rastet nëpër Gjykata, ato presin edhe me vite të tëra e që kjo qon edhe deri te një fenomen tjetër. Që në disa vende njihet edhe si “parashkrim i lëndës”.

Sjelljet e tilla jo vetëm që cenojnë autoritetin e pushtetit, por, edhe dobësojnë besimin e qytetarëve ndaj nëpunësve të aparatit të shtetit të tyre, pastaj shikuar edhe më larg, kjo thellon pakënaqësitë të shoqëria, pakënaqësi e cila mund të rezultojë edhe me forma të tjera të shprehjes së pakënaqësisë, siç janë edhe vetë protestat.

Andaj të gjitha shtetet duhet të ndërmarrin masa adekuate për pengimin dhe eliminimin e të gjitha formave të keqpërdorimit gjatë ushtrimit të detyrës dhe autorizimeve të tjera publike. “kanceri i shoqërisë” korrupsioni, pa dyshim se është i paraqitur dhe i shprehur në të gjitha format e zhvillimit shoqërorë. Se deri në cilin stad institucional mund të arrij ai, varet nga shumë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, mirëpo, ai zakonisht mundohet të mbërrij në majat e niveleve institucionale.

Në këtë kontekst, kur korrupsioni zë vend dhe krijon hapësirë komode, ai vazhdon “zhvillimin” duke ngulitur rrënjët e që kjo do të nënkuptonte degradim të brendshëm shoqëror. Ky degradim i brendshëm shoqëror që është një e keqe për vetë shoqërinë e një shteti, pastaj lehtë do të mund të krijonte vrima të cilat do të mund të shërbenin edhe nga faktor të ndryshëm nga jashtë, që ky degradim të çojë jo vetëm në thellimin e

degradimit moral të shoqërisë, por edhe rritjen vlerave anti-morale të atij vendi përballë bashkësisë ndërkombëtare.

Veprat e tilla penale, paraqesin cenim të vlerave të ndryshme, si janë liritë e individit, cenimi i pasurisë, pastaj kjo ngërthen në vete në mos siguri personale, familjare etj. Edhe pse me vepra të llojit të tillë, rrezikohen vlera të ndryshme individuale, nga natyra dhe kuptimi i tyre rezulton se objekt i tyre primar i mbrojtur është ushtrimi i ligjshëm, i drejtë dhe me ndërgjegje, i detyrës dhe i autorizimeve zyrtare, pra, kur bëhet fjalë për interesin e përgjithshëm të shoqërisë, mbrojtjen e vlerave morale dhe etike të shoqërisë, këtu nuk nënkuptojnë vetëm mbrojtjen e vlerave të përgjithshme, duke anashkaluar vlerat individuale të çdo qytetari. Por, vlerat e përgjithshme morale të një shoqërie, mbrohen atëherë kur shoqëria është e organizuar në atë formë, që është e gatshme të reagojë me forma të ndryshme të reagimit kolektiv, atëherë kur vlerat e individit dhe qytetarit cenohen nga llojet e veprave të kësaj natyre.

Andaj, interesi i përgjithshëm dhe ai individual konsiston në shërbime shtetërore dhe shërbime të tjera me interes publik të barabartë, të ligjshëm dhe të drejtë, ngase vetëm kështu zyrtarët përmbushin funksionin e tyre shoqëror, karshi obligimit qytetar në shërbime. Me fjalë të tjera, vetëm funksionimi i drejtë, i pastër, i ndershëm pa burokraci e këtu do të nënkuptonte pa vonesa, i organeve shtetërore dhe organeve të tjera publike, paraqesin parakusht të domosdoshëm për funksionimin e tyre efikas dhe me autoritet.

Kjo nuk nënkupton se veprat e tilla penale, kufizohen vetëm në veprimin e ligjshëm të administratës klasike shtetërore, por kjo përfshinë gjithë llojet e shërbimeve publike e që synim të vetëm e kanë qytetarin. Këtu kemi të bëjmë me shërbime sociale, kulturore, administrative, shëndetësore, arsimore, pastaj shërbim të mallrave dhe përtej kësaj, edhe rregullim të mirë, të marrëdhënieve bilaterale, ndërshtetërore, marrëdhënie që do të shërbenin dhe do të ishin në shërbim të qytetarit.

Cenimi i integritetit të shërbimit nga vetë bartësi i autorizimeve zyrtare, për shembull për sulm mbi shërbimin nga brenda nga vetë personi zyrtar, përbënë vepër të rrezikshme shoqërore, me të cilat atakohen të mirat juridike të shoqërisë në përgjithësi dhe individit në veçanti.

Sot, shtetet dhe shoqëritë e avancuara, rëndësi të veçantë i kushtojnë zhvillimit dhe evoluimit të kohëpaskohshëm si dhe reformave në administratë. Një administratë e dobët, nënkupton shërbime të dobëta, pastaj një administratë me elemente korruptive dhe e korruptuar, nënkupton vështirësi në realizimin e të drejtave administrative dhe publike të qytetarit. Me këtë vijmë në përfundim se administrata e dobët dhe e korruptuar, përbënë një të keqe të madhe për shoqërinë.

Përveç asaj që u cek në tekstin e më lart shënuar, jo vetëm që një administratë e korruptuar, shkakton revoltë të përgjithshme dhe kontribuon në humbjen e besimit të qytetarëve, por kulmi i paligjshmërisë arrihet kur administrata, për shkak të korrupsionit, është tolerante ndaj delinkuentëve dhe nëse është e lidhur me kryesit e veprave të ndryshme penale. Atëherë, hapet një kanal (rrugë) së cilës nuk i shihet fundi për mos ndëshkim të gjerë të paligjshmërisë. Një shoqëri e tillë e futur në këtë amulli, shpesh herë lë të nënkuptohet se ajo ka pranuar një fakt të tillë dhe po thuajse është e dorëzuar përballë dukurive të tilla kanceroze.

Tani në kuadër të një analize shumë të thukët, lufta kundër një delikuece të tillë, është pjesë e përpjekjeve për luftimin e burokracisë, për respektimin e të drejtave qytetare, dhe për raporte të ndershme e korrekte të të gjitha organeve të pushtetit dhe të të gjithë titullarëve të autorizimeve publike ndaj qytetarëve. Në këtë fushë burokracia manifestohet si arbitraritet i organeve, si pasivitet duke shkaktuar vonesa të panevojshme, pandershmëri në kryerjen e detyrave, mos kujdes në respektimin e të drejtave të qytetarëve, raporte jo korrekte ndaj njerëzve dhe të gjitha këto krijohen si tendencë e cila shpie drejtpërsëdrejti në korrupsion.

Mjeti më i përshtatshëm në luftën kundër dukurive të tilla duhet të jetë zhvillimi i formave të ndryshme të kontrollit nga organet shtetërore, por edhe nga vetë iniciativat qytetare. Më e keqja e kësaj është se, kur një shoqëri është jo aktive, nuk merr iniciativa qytetare ndaj këtyre dukurive që janë shkatërruese për vetë ata, nënkupton pranim të këtij realiteti të hidhur dhe jo vetëm individ, por edhe kolektivi, pajtohet me situatën e krijuar, duke gjetur forma të tjera, korruptive për të depërtuar në realizimin e qëllimeve të tij/saj. Kur një shoqëri e tillë nuk gjen elemente për të luftuar këto fenomene dhe dukuri amorale, atëherë në këtë vlerësoj se, kjo shoqëri është në stadin më të ulët të zhvillimit të saj, kulturor, social, politik etj.

Kur fenomenet e tilla kanë kapluar një shoqëri, atëherë edhe pse duket se lufta kundër një delikvence të tillë është e vështirë megjithatë, duhet të gjinden mekanizma për ta luftuar një situatë të tillë, të krijuar me vite të tëra. Nuk do mend se në një shoqëri të tillë ne nuk po flasim për forma parandaluese të krimit dhe korrupsionit, ngase një shoqëri e tillë ka pranuar një sistem të tillë jo formal brenda vetë formalitetit të saj, konsideroj se kjo është forma e parë, kur fillohet nga zeroja për të luftuar apo për të gjetur instrumente nismëtare për të luftuar këto forma të korrupsionit.

Forma e dytë konsiderohet forma më e përshtatshme për luftimin e këtyre veprave penale, një shoqëri mirë e konsoliduar, në një shoqëri gjallëruese dhe me iniciativa dhe organizim të fuqishëm, e të gjitha këto nënkuptojnë se një komunitet i tillë ka zgjedhur format e parandalimit për luftimin e këtyre veprave penale. Vlen të theksohet se vepra penale kundër detyrës zyrtare, që janë vepra të personave zyrtarë, paraqiten edhe tek veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të qytetarëve, veprat penale kundër martesës dhe familjes, veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe të pasurisë, etj.

Siç u specifikua më lartë se veprat penale zyrtare në thelb, janë vepra penale të keqpërdorimit të pozitës dhe autorizimeve zyrtare, në ushtrimin e detyrës zyrtare, duke i cenuar ato; duhet thënë këtu se pikërisht cenimi i detyrave zyrtare është karakteristikë e këtyre veprave. Lidhur me çështjen se cilat vepra penale duhen përfshirë në këtë grup të veprave penale, ekzistojnë dy koncepte themelore; sipas njërit, ato janë vepra në ushtrimin e detyrës, kurse sipas të dytë ato janë edhe veprat e ndërlidhura me ushtrimin e detyrës.

Sipas mendimit të parë të ngushtë, këtu përfshihen vetëm ato vepra penale që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e detyrës dhe autorizimit zyrtarë, kur personi zyrtarë ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme me rastin e ndërmarrjes së veprimeve zyrtare për të cilat edhe është i autorizuar.

Sipas mendimit të dytë të gjerë, për pos këtyre veprave, këtu përfshihen edhe veprat që kryen personi zyrtarë, duke i shfrytëzuar mundësitë reale dhe juridike lidhur me pozitën e tij me mundësinë që ai ka, duke pasur parasysh pozitën e tij zyrtare, prandaj këtu hyjnë edhe veprat penale siç janë:

- Shpërdorimi i pozitës zyrtare,
- Përdorimi i paaautorizuar i pasurisë,
- Mashtrimi në detyrë,
- Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e ekzekutimit të vendimit gjyqësorë

Një prej elementeve kryesore të përbashkëta të veprave penale të këtij lloji, është edhe ai që kryerësi i saj në numrin më të madh të rasteve, mund të jetë vetëm personi zyrtarë. Mirëpo, personi zyrtarë, si subjekt kryesorë i këtyre veprave, nuk përcakton vetvetiu, karakterin e tyre për tu radhitur në grupin e veprave penale kundër detyrës zyrtare. Pra, siç edhe thamë edhe më herët, se esenca e veprave penale kundër detyrës zyrtare, është cenimi i detyrave dhe funksioneve të shërbimeve gjë që implikon konceptin e gjerë të veprave të këtilla, në të cilat hyjnë përpos veprave që ndërmerren në ushtrimin e detyrës zyrtare, edhe veprat lidhur me kryerjen e tyre.

Bëhet fjalë për vepra penale specifike që nuk janë ekskluzivisht vepra penale zyrtare, por ato, për pos personave zyrtar mund ti kryejnë edhe personat e tjerë në detyrë apo përgjithësisht që punojnë në organet shtetërore a në ndonjë shërbim publik; kryerës i këtyre mund të jetë edhe çdo person (përmes ushtrimit të ndikimit, dhënies së mitos, etj).

Kryerësit e veprave penale të korrupsionit, zakonisht nuk janë nga radhët e kriminalitetit klasik, por ata i hasim zakonisht tek shtresat më të larta shtetërore, janë kryesisht persona në pozita dhe me autoritet të fuqishëm, bartës të funksioneve të larta shtetërore dhe ekonomike me autorizime të caktuara, persona kyç me pozita të caktuara dhe me përgjegjësi në afarizëm komercial, ekonomik dhe doganorë, në qarkullim të mallrave-agjent tregtarë etj. Zakonisht këta persona kryerës të këtyre veprave penale, më së shpeshti i hasim duke ushtruar një funksion të caktuar në organet shtetërore, në shërbimet publike, në institucionet dhe entet e tjera publike, të cilat vendosin për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve dhe të personave juridik siç janë:

- Dhënia e lejeve a pëlqimeve të caktuara,
- Dhënia e certifikatave,
- Aktvendimeve,

- Diplomave,
- Detyrimet e ndryshme tatimore,
- Doganore dhe detyrimet e tjera financiare ndaj shtetit, etj.

Persona të tillë duke e keqpërdorur detyrën zyrtare dhe duke krijuar burokraci në vonesa anashkalojnë prioritetin në shërbim të qytetarit të rëndomtë dhe kështu në mënyrë direkte apo indirekte krijojnë dhe mundësojnë linja të natyrës së tillë korruptive, drejt marrjes së mitos dhe mitdhënies.

Nuk do mend se duke pasur parasysh rrugën e Kosovës drejtë Bashkimit Evropian, jo vetëm neni 343 i Kodit Penal të Kosovës, por i tërë legjislacioni kosovarë do të duhej të ishte në përputhshmëri me legjislacionin e Unionit Evropian. Andaj kur jemi tek neni 343 i Kodit Penal të Kosovës, shprehja person zyrtarë, përfshinë si personin zyrtar evropian, ashtu edhe atë nacional. Në kuadër të kësaj, mund të përfundojmë se person zyrtarë evropian është:

- Çdo person me cilësi të zyrtarit, i punësuar me bazë të kontratës së lidhur në përputhje me statutin e zyrtarëve evropian;
- Çdo person të cilin i a vë në dispozicion Unioni Evropian një shteti anëtarë apo institucioni publik, të cilët në territorin e Unionit ushtrojnë të njëjtat detyra si dhe çdo epror dhe zyrtar tjetër i Unionit Evropian.

Ndërsa sa i përket shprehjes *person nacional zyrtarë*, duhet interpretuar në përputhje me përkufizimin e funksionarit a të zyrtarit publik, në shtetin anëtarë, në të cilin personi në fjalë e ka atë cilësi, me qëllim të realizimit të qëllimeve të së drejtës penale të atij shteti. Andaj, të gjitha veprat penale kundër detyrës zyrtare, në kuadër të këtij kapitulli, pavarësisht se agjendën në këtë grup apo në ndonjë grup tjetër, në teorinë e së drejtës penale, ndahen në vepra penale të drejta dhe jo të drejta dhe në vepra të përgjithshme e të posaçme. (Salihu, E Drejta Penale, 2014, f. 652)

Veprat penale zyrtare të drejta, janë vepra penale, kryes i të cilave mund të jetë vetëm personi zyrtarë, cilësia e personit zyrtarë të të cilit është element konstitutiv-qenësor i veprave të tilla. Nga kjo rezulton se këto vepra penale mund të konsumohen vetëm gjatë

kryerjes së detyrës zyrtare, dhe këto vepra penale jashtë kësaj nuk ekzistojnë. Si vepra të tilla mund të numërojmë:

- Shpërdorimi i pozitës ose i autorizimit zyrtarë,
- Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës,
- Zbulimi i sekreteve zyrtare, etj.

Veprat penale zyrtare jo të drejta, janë veprat kryerës i të cilave përpos personit zyrtarë mundët ë jetë edhe ndonjë person tjetër, i cili veprën e kryen jashtë detyrës zyrtare, apo lidhur me kryerjen e detyrës zyrtare, këtu mund të përmendim disa të tilla siç janë:

- Dhënia e mitos,
- Ushtrimi i ndikimit,
- Përdorimi i paautorizuar i pasurisë (shpërdorimi në detyrë).

Në grupin e veprave penale jo të drejta, hyjnë edhe veprat e përgjithshme penale, të cilat marrin formë të cilësuar, nëse ato i kryejnë personat zyrtarë. Kur jemi tek veprat penale zyrtare jo të drejta, u specifikua se përpos personit zyrtarë, mund të jetë edhe ndonjë person tjetër, i cili veprën e kryen jashtë detyrës zyrtare. Pas luftës në Kosovë, ushtrimi i ndikimit dhe dhënia e ryshfetit kanë qenë karakteristike si forma të këtyre veprave penale.

Kur jemi tek ushtrimi i ndikimit, personat e ndryshëm me ndikim edhe pse nuk kanë qenë persona zyrtar, ndikimi i tyre ka qenë i fuqishëm për shkak të prestigjit që kanë gëzuar në shoqëri, apo nga e kaluara e tyre në ndonjë organizatë tjetër apo institucion dhe duke përdorur këto përkatësi, kanë ushtruar ndikimin e tyre në institucione publike duke detyruar shpërdorimin zyrtarë në detyrë të një personi tjetër të autorizuar, kjo është edhe një argument tjetër, kur një shoqëri funksionon edhe me raporte të tilla, të ndërsjella.

Deri sa te grupi i dytë i veprave penale zyrtare, jo të drejta të cilësuar si vepra të përgjithshme penale, me llojin e këtyre veprave merren edhe institucione të ndryshme dhe organizata të tjera jo qeveritare në nivel globi, kur është në pyetje trafikimi i qenieve njerëzore, pabarazia e banorëve të një vendi.

Veprat penale të përgjithshme zyrtare, janë vepra penale që mund të kryhen gjatë kryerjes së çdo detyrë, dhe kryerësi i tyre mund të jetë çdo person zyrtarë, për shembull: shpërdorimi i pozitës ose i autorizimit zyrtarë, marrja e mitos. (Salihu, E Drejta Penale, 2014, f. 652)

Veprat penale të posaçme zyrtare, janë vepra penale që mund të kryhen vetëm në shërbime të caktuara, dhe kryerës të tyre mund të jenë vetëm personat e caktuar zyrtarë, shembull: lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria, apo edhe përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë që mund të vjen si keqpërdorim i ndonjë zyrtari e në rastin më konkret të ndonjë zyrtari policor gjatë bastisjes apo të ndonjë lloj tjetër ekzekutimi të një vendimi të caktuar gjyqësorë. Pastaj vepra të rasteve kur nxjerrën vendime gjyqësore që janë kundër ligjit e në këtë rast është e qartë se kjo nuk mund të bëhet nga zyrtarë të thjeshtë, por ekskluzivisht është punë e një zyrtari.

Një ndarje që mund ti bëhet veprave penale, e ku përcaktuese është statusi i një zyrtari i cili e realizon keqpërdorimin, është ndarja në vepra penale speciale dhe ato të përgjithshme. Duhet theksuar se shumica e veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, përveç personave zyrtarë, mund të janë edhe persona përgjegjës, që vijnë në shprehje gjatë rasteve të mitos apo edhe të ushtrimit të ndikimit.

Ndarja e veprave sipas kategorive vjen për një arsye praktike, në këtë rast te veprat penale personat që nuk kanë cilësinë e personit zyrtar, edhe pse nuk mund të jenë bashkë kryes, por mund të jenë bashkëpjesëmarrës, pra në këtë rast bëhet fjalë për vepra penale të drejta zyrtare. Kurse, një kategori tjetër janë veprat penale jo të drejta zyrtare, e kur zyrtari mund të jete edhe bashkëpjesëmarrës edhe bashkë kryes.

Vepra penale mund të kryhet me dashje por përjashtim thelbësorë bën këtu vepra penale e zbulimit të fshehtësive zyrtare kur përgjegjësia mund të bëjë edhe me vet pakujdesinë. Në këtë rast, inkriminimi i cili vjen si rezultat i pakujdesisë në trajtimin e një fshehtësie zyrtare, e bën zyrtarin objekt të përgjegjësisë penale.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në një kapitull të veçantë përshkruan çështjet por dhe masat për mbrojtjen e ushtrimit normal në përputhje me ligjin, të detyrës zyrtare të

zyrtarëve të ndryshëm publik të cilëve u janë besuar kompetenca, përkatësisht autorizime shtetërorë dhe publike.

Në frymën e kësaj, këta zyrtarë duhet të shtrojnë detyrën bazuar në ligj dhe në interes të qytetarëve. Sigurisht nëse kjo nuk ndodh atëherë duhet pritur që do të ketë administratë joprofesionale, gjë që hap derën mungesës së ndërgjegjes, korrupsionit dhe është në interes të qytetarëve të vendit. Në rrethanat e tilla nuk mund të ketë funksion normal të institucioneve, e kjo afekton jetësimin e elementeve që e bëjnë një shtet joligjorë.

Është interesante të ceket se sipas të drejtës penale të Kosovës, në raste të përdorimit të paautorizuar të pasurisë, dhënies së mitos, zbulimit të fshehtësisë të dokumenteve zyrtare, nuk do të thotë se mund të jenë vetëm zyrtarët publik apo ata shtetëror, por mund të jetë çdo person, kurse kjo precizohet në nenet 427, 430 dhe 433. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2013)

Kur bëhet fjalë për kuptimin e nocionit të personit zyrtarë dhe përgjegjës, kjo përcaktohet në nenin 120 në paragrafin e parë, përndryshe kryerja e veprës së keqpërdorimit të detyrës zyrtare, rezulton me pasoja të ndryshme për shoqërinë, respektivisht me përfitime personale për kryerësin e një veprë. Kjo mund të jetë përfitimi në pasuri fizike, pasuri në para, kurse si të tilla ato jo vetëm që shkelin ligjin por, edhe cenojnë të drejtën e dikujt tjetër. Në paragrafin 2 të nenit 120, tutje precizohet:

2.1. personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror;

2.2. personi i autorizuar në një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligj ushtron detyra të posaçme;

2.3. personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2013, f. 38)

Veprat kundër detyrës zyrtare nuk kryhen rastsisht, ngase ato janë me qëllim, kurse në planifikimin e tyre mund të marrin pjesë disa persona. Një përjashtim këtu mund të jetë vepra penale e zbulimit të fshehtësisë zyrtare, e cila mbase edhe mund të kryhet nga pakujdesia, por kjo nuk përjashton përgjegjësinë penale (Salihu, E Drejta Penale, 2014,

f. 675). Veprat e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, apo siç quhen në Kodin Penal të Kosovës, vepra penale kundër detyrës zyrtare, klasifikohen në katër kategori:

- Vepra penale të drejta- që janë vepra të cilat mund të kryhen vetëm nga personat zyrtarë, e ku përfshihen si shembull marrja e mitos, keqpërdorimi i autorizimit, kurse në sferën e gjyqësorit apo të policisë, mund të jetë si vepër penale, lirimi i kundërligjshëm i të privuarit nga liria.
- Vepra penale jo të drejta –të cilat mund të kryhen jo vetëm nga personat zyrtar, por edhe të tjerët, si privimi i kundërligjshëm i lirisë, cenimi i pronës etj.
- Veprat penale të përgjithshme- e që janë në parim vepra që mund të kryej çdo person zyrtar ku përfshihet keqpërdorimi i detyrës zyrtare, autorizimet apo marrja e mitos.

Veprat penale të posaçme- janë jashtëzakonisht vepra që mund të kryhen vetëm gjatë ushtrimit të detyrave të caktuara e si shembull mund të jetë lirimi i kundërligjshëm.

Siç shihet pra edhe nga tabela e paraqitur në vijim, mbështetur me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, ka disa dënime të sanksionuar konform me veprën penale të kryer, prandaj ka minimume të dënimit apo edhe maksimume, qoftë të përgjithshme apo të posaçme. (Salihu, E Drejta Penale, 2014, f. 30)

Neni	Dënim me gjobë	Më i lehtë		I lehtë		I rëndë	
		Minimal	Maksimal	Minimal	Maksimal	Minimal	Maksimal
422	JO					0,5	5
423	PO	2	8	1	8	3	12
424	PO					1	5
425	PO	0,5	5	1	8	3	12
426	PO	0,5	5	1	8	3	12
427	PO						3
428	PO	0,5	5	1	8	3	12
429	PO		3	1	8	0,25	3
430	PO		5	1	5	1	8
431	JO	1	5			1	8
432	JO					0,5	1
433	JO	0,5	3	1	10	5	(pa specifikuar)
434	JO					0,5	5
435	PO		1				3
436	JO					0,5	5
437	PO		3			0,5	5

Tabela 1: Dënimet e parapara me Kodin Penal për veprat penale kundër detyrës zyrtare

Përndryshe në shkencën e të drejtës penale, një kohë të gjatë janë ngritur dilemat, e kufirit mes veprës penale dhe shkeljes disiplinore të zyrtarit. Në parim këto dy vepra nuk përjashtojnë njëra tjetrën, andaj mund të thuhet se vepra penale, nuk e zhbënë faktin e shkeljes disiplinore, në kuptimin praktik kjo do të thotë që, një zyrtar i cili ka kryer edhe një vepër penale dhe në të njëjtën kohë ka bërë shkelje disiplinore, përgjigjet për të dyja. Kjo e fundit sigurisht është objekt i procedurës disiplinore.

Veprat penale kundër detyrës zyrtare mund të konsiderohen veç tjerash edhe si tregues i dobësisë së administratës publike në një kontekst më të gjerë të kuptimit, kurse si të tilla ato vejnë në pikëpyetje segmentin funksional të shtetit. Andaj, nuk është fare i tepërt konstatimi se keqpërdorimi i detyrës zyrtare, më konkretisht shkalla e përhapjes së tij janë edhe pasqyrë e vlerave morale të vetë shoqërisë.

Detyrë e shtetit është gjithësi ngritja e mekanizmave institucional, të cilët nuk lypset të jenë të shumtë në numër, po është me rëndësi të jenë funksional. Veprat penale të prodhuara nga inkriminimet gjatë kryerjes së detyrave zyrtare janë mbase edhe më të rëndat në tërësinë e përgjithshme të veprave penale, ngase ato dëmtojnë rëndë funksionimin e shtetit, si dhe humbin besim e qytetarit ndaj shtetit.

Shteti për të luftuar duhet të krijojë një sistem efikas të kontrollit dhe identifikimit, struktura këto krejtësisht profesionale të pavarura nga politika. Republika e Kosovës, është në një fazë të rëndësishme të stabilizimit institucional në këtë drejtim.

5.1.1. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare, është një nocion i përgjithshëm për një sërë veprash penale, andaj keqpërdorimi mund të ketë disa forma, e krahas me këtë edhe disa vepra penale njëkohësisht. Sipas nocionit, keqpërdorimi i detyrës zyrtare nënkupton një sjellje në kundërshtim me ligjin, të realizuar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo edhe të autorizimit, siç u tha më lartë me qëllim të përvetësimit të pasurisë, por edhe të shkaktimit të dëmit të dikujt tjetër. Duhet pas parasysh se se kjo vepër penale sikurse edhe veprat tjera penale të kësaj kategorie, nënkuptojnë që personi ka shkelur ligjin nga pozita e detyrës. (Salihu, Zhitija, & Hasani, Komentar, 2014, f. 1209)

Forma themelore të kryerjes së kësaj veprë mund të cilësohen jo vetëm keqpërdorimi i detyrës zyrtare, por edhe mos kryerja e detyrave zyrtare, gjë që i bënë këto dy veprime plotësisht ekuivalente si vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Këto vepra penale konsiderohen krime të rënda sipas nenit 22 të kodit të procedurës penale, në pajtim me nenin 15 të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199. (Kodi i Procedurës Penale, 2012, f. 8)

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare, pra përgjithësisht është një vepër e ndërmarr gjatë ushtrimit të detyrës por, jo në interes së detyrës por, në interes individual të kundërligjshëm. Kjo mund të ndodh edhe tek autorizimet e zyrtarit, posaçërisht tek të ashtuquajturat autorizimet diskrecionale, ngase për arsye praktike dhe varësisht nga natyra e detyrës së zyrtarit, atij mund ti lihen në diskrecion që të bëjë zgjidhje kur mendon se diçka është në interes të shërbimit apo shtetit. Por, pikërisht këtu konsiderohet se keqpërdoret ky autorizim, në rast se konstatohet që zyrtari i autorizuar

gjatë marrjes së vendimit nuk e ka konsideruar interesat e detyrës pavarësisht se ka vepruar brenda kornizave të përcaktuara nga autorizimi.

Kur bëhet fjalë për autorizimet që kanë zyrtarët, vepër penale konsiderohet edhe marrja e një vendimi përtej kornizave të autorizimit, apo edhe përgjithësisht tejkalimi i kompetencave. Në këtë rast këto kompetenca dhe autorizime mund të jenë të ndonjë zyrtari tjetër e madje edhe të një shërbimi krejtësisht tjetër.

Ngjashëm cilësohet si vepër penale nëse personi i autorizuar, vepron në përputhje me autorizimet e veta, por për të cilat paraprakisht është i nevojshëm pëlqimi i eprorit të tij apo edhe ndonjë personi tjetër zyrtarë. Sipas Kodit të Procedurës Penale në nenet 88, 89, 90, për vepra penale kundër përdorimit të detyrës zyrtare, organet përgjegjëse gjatë hetimeve për dyshime lidhur me veprën, në rast se kanë dyshim se janë përdorur gjatë tentativës për të kryer veprat penale mund të përgjojnë, numrin e telefonit, adresën elektronike, si dhe llogarinë financiare. (Kodi i Procedurës Penale, 2012, fv. 34, 37, 38)

Siç u cek më lart një vepër penale e me theks të veçantë tek keqpërdorimi i detyrës zyrtare, mund të cilësohet si e tillë edhe me mosveprimin e zyrtarit apo më saktësisht me mos kryerjen e detyrës zyrtare. Këto janë raste kur zyrtari përkundër obligimit për të marrë një vendim, nuk e merr atë, apo e merr në mënyrë anakronike pasi që e ka stërvonuar mjaftueshëm ashtu që vendimi të mos ketë efekte të duhura. Edhe mos veprimi, mund të bëhet për të përfituar kundërligjshëm dhe për shkaktimin e dëmit të tjetërkujt.

Tek veprat penale të moskryerjes zyrtare, sikurse edhe na sugjeron edhe vetë emri, kryerësi i veprës penale mund të jetë vetëm zyrtarë apo disa prej tyre. Kjo është e qartë se kjo vepër mund të kryhet vetëm me dashje, kurse dispozita paraprake dy, saktëson shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit, respektivisht moskryerjen e qëllimshme të punës, e deri te ndalimi apo pengimi i tjetrit në ushtrimin e detyrave të tij apo edhe privimin e një personi fizik që të gëzoj të drejtat e tij të garantuara me ligj.

Zbulimi i fshehtësisë së një dokumenti zyrtari apo siç thuhet në nenin 423, keqpërdorimi i informatës zyrtare, është një vepër penale e re, nëse e bëjmë krahasimin e Kodit Penal aktual me Kodin Penal të mëparshëm. Është interesante se në këtë rast,

Kosova, dallon nga shtetet e rajonit, pasi që keqpërdorimi i informatave zyrtare, nuk përfshihet si vepër penale në tekstet e Kodeve Penale të shteteve për rreth.

Në paragrafin 1, thuhet se vepra konsiderohet e tillë edhe në rast kur e keqpërdor atë për keqpërdorime personale, apo edhe për dobi të tjetrit, kurse vet natyra e kësaj vepre penale na sugjeron që ajo mund të ketë qëllim jo vetëm përfitimin material por edhe një përparësi tjetër. Kjo vepër penale mundësohet në raste kur zyrtari ka qasje në informacione apo përgjithësisht në dokumentacion, i cili mund t'i jetë besuar në kuadër të detyrës, por edhe kur ai përfiton nga pakujdesi i dikujt tjetër dhe i qaset informacionit i cili nuk i është besuar.

Rëndom këto informacione ose janë të përcaktuara që të mos publikohen ose të publikohen më vonë, kurse zyrtari i publikon para kohe, me qëllim që të përfitoj. Një rast konkret është shembull përgatitja dhe publikimi i tenderëve publik, ku zyrtari me qëllim i tregon informacionet relevante një operatori të caktuar ekonomik, në mënyrë që ai të përgatitet apo edhe të dijë çmimin e ofertuesve të tjerë, me çka zhbëhet barazia ndërmjet operatorëve ekonomik, kurse fituesi i tenderit përcaktohet që në fillim, e në anën tjetër vazhdon farsa e procesit të tenderimit.

Paragrafi i dytë, parasheh reforma të tjera, të veprave penale në rast të zbulimit të fshehtësisë. Paragrafi i tretë merret me dobitë e përvetësuara që tejkalojnë shumat 5.000 euro, kurse ai i katërti që i tejkalon shumën 50.000 euro, konform me kategorizimin sipas këtyre paragrafëve parashihen edhe dënimet. Për dënimin konform me paragrafin e dytë, parashihet burgim prej 2 deri 8 vite, për paragrafin e tretë 1 deri 8 vite kurse paragrafi i katërt ku në ato raste ku shuma do të tejkalonte 50 mijë euro të përvetësuara, dënimi mund të jetë deri në kohëzgjatje prej 12 viteve.

Çështja e keqpërdorimit të fshehtësisë zyrtare, është tentuar të lidhet me doemos me cenimin e transparencës, çka në fakt paraqet një qasje tendencioze nga qarqe të caktuara politike dhe ekonomike dhe nuk ka të bëjë aspak me cenimin e transparencës të institucioneve publike. Janë organet kompetente ato të cilat duke qenë në përputhje me autorizimet gjyqësore të cilat i kanë, mund të kenë qasje në dokumentacionin që ka karakter të fshehtësisë zyrtare, por sërish sanksionet janë të aplikueshme si çdo zyrtar

tjetër në rast se kjo fshehtësi zyrtare keqpërdoret për qëllime tjera, të cilat janë në kundërshtim me autorizimet gjyqësore.

Një rast i freskët i çështjes mjaft të debatuar lidhur me keqpërdorimin e fshehtësisë zyrtare, ka të bëjë me bulimin e fshehtësisë zyrtare të gjendjes bankare të dy zyrtarëve, në këtë rast klient të bankës, për të cilat zyrtari i bankës, i cili ka keqpërdor dokumentacionin zyrtar pretendon se ata janë kryerës të një afere korruptive (Prizren Press, 2015). Kjo çështje është ngritur në një shkallë të gjerë të debatit politik, kurse në fund, zyrtari bankar i cili keqpërdori dokumentacionin është sanksionuar ligjërisht. Ndonëse ka tendenca që ky zyrtar të shfajësohet për shkak se ai ka bërë të ditur një aferë korruptive të pretenduar, e cila ka mundur të dëmtoj shoqërinë, sërish janë organet kompetente ato që u takonte të merreshin me çështjen dhe jo zyrtarit në fjalë.

Siç thamë edhe më lartë, Kosova është i vetmi shtet në rajonin e afërt që parasheh një vepër penale të ndërlidhur me zbulimin e fshehtësisë zyrtare, andaj nëse rasti më parë i përmendur i zyrtarit bankar, hipotetakisht të ndodhte në ndonjë shtet tjetër në rajon, praktikisht shikuar ai nuk do të mund të akuzohej për vepër penale, por thjesht mund të ishte subjekt i shkeljes disiplinore dhe subjekt i ndëshkimit të brendshëm nga ana e punëdhënësit të tij.

Edhe pse Nepotizmi si fjalë nuk përdoret askund në Kodin Penal si princip një akt i tillë është i rregulluar në kapitullin kundër korrupsionit zyrtar. Neni 422 i po këtij Kodi Penal sanksionon çdo tejkalim të kompetencave të personit zyrtar me qëllim të përfitimit të tij ose të ndonjërit nga të afërmit.

Ky nen dënon çdo vepër të tillë të kryer me apo pa vetëdije nga kushdo i cili është ngarkuar me pozitë zyrtare. Neni në fjalë gjithashtu dënon çdo lloj veprimi me dashje nga një person tjetër, veprim ky për të cilin personi zyrtar është i vetëdijshëm që është i kundërligjshëm. Çdo individ i cili ngarkohet më një vepër penale të paraparë me nenin 422 dënohet me gjashtë (6) muaj, deri në pesë (5) vite burgim. (Salihu, E Drejta Penale, 2014, fq. 653-655)

5.1.2. Konflikti i interesit

Sikurse në rastin e veprës penale të zbulimit të fshehtësisë zyrtare, edhe vepra penale e konfliktit të interesit, e paraparë në përputhje me nenin 424, paraqitet si vepër penale e re e Kodit Penal aktual, e cila nuk ishte pjesë e Kodit Penal të mëparshëm, kurse nuk parashihet as në Kodet Penale të shteteve rreth Kosovës.

Konflikti i interesit si vepër penale, mund të vije në shprehje në punë të ndryshme zyrtare, bie gjithashtu ndesh me parimet etike, kurse për këtë Kuvendi i Kosovës, ka nxjerr edhe një ligj të veçantë i cili quhet “Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit”. Në paragrafin 1 saktësohet se vepër penale e tillë konsiderohet çdo veprim ku zyrtari merr pjesë në çfarëdo relacioni zyrtarë, e ku ka interes financiar, pjesë e të cilit është ndonjë anëtar i familjes së tij apo edhe person juridik, anëtarë i familjes.

Sipas paragrafit të cekur më lart, konflikti i interesit është një vepër penale e cila ekskluzivisht mund të kryhet vetëm nga personi zyrtar, kurse paragrafi i dytë parasheh edhe formën më të rëndë të kësaj veprë penale, në rast se bëhet fjalë për veprime të ndryshme të prokurimit publik apo ankandeve publike. “ Meqë kjo vepër penale është e re dhe shumë vështirë është të konstatohet nëse është fjala për konflikt interesi dhe njëherazi mungon praktika gjyqësore lidhur me këtë në tri paragrafet vijuese janë dhënë shpjegimet për fjalët dhe shprehjet të cilat përdoren në mënyrë që Gjykatave tu ndihmohet në zbatimin e këtij neni “ (Salihu I. E drejta Penale, Prishtinë 2014, faqe 657) Dënimi maksimal i cili mund të shqiptohet për këtë vepër penale, sikurse është paraparë në paragrafin 2, mund të jetë 5 vite burgim me burg.

Nëse i referohemi inkriminimit e që është i ri në Kodin Penal, pra po flasim për dhënien e mitos zyrtarit publik të huaj, e që në Kodi Penal i referohet nenit 430, i cili thotë se mita i jepet zyrtarit publik të huaj, ndërsa dënimet janë paksa më të rënda. Pra, ky nen është po thuajse tërësisht i ngjashëm me nenin 429, i cili thotë se mita i jepet çdo personi përderisa sipas nenit 430, e specifikon se mita i jepet zyrtarit publik të huaj. Andaj, neni 430, ka mundur të inkorporohet brenda përbrenda nenit 429 me ndonjë paragraf të veçantë apo kualifikim të kësaj veprë penale.

Megjithatë duket që Kosova ka tentuar të përcjell shembullin e disa demokracive të zhvilluara të cilat kanë korporata të shumta që investojnë jashtë vendit dhe pikërisht për

këtë e ka paraparë këtë inkriminim në mënyrë eksplicite në kuadër të Kodit Penal, si vepër penale në vete. Më herët përmendëm rastin e SHBA-ve, të cilat qysh në vitin 1977, sollën një ligj të tillë, e më pas kjo reflektoj edhe në vendimet e qeverive të tjera si dhe në organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe në mesin e të cilave gjendet OECD.

5.1.3. Përvetësimi në detyrë

Përvetësimi në detyrë është një vepër penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare e përcaktuar me Kodin Penal në nenin 425. Përvetësimi në detyrë apo në gjuhën më praktike – shpërdorimi nënkupton në spektër të gjerë të përvetësimit të kundërligjshëm si të parave, letrave në vlerë, apo edhe gjërave tjera të luajtshme me që rast nënkuptohej se përvetësimi i kundërligjshëm realizohet nga zyrtarët, të cilët objekti i përvetësuar i është besuar konform detyrave dhe autorizimeve të tij.

Në këtë rast nuk ka dallim sa i përket përgjegjësisë penale edhe në rast se zyrtari ka përvetësuar në dobi të një personi tjetër. Objekti i kësaj vepre penale në njëfarë mënyre të përgjithësuar mund të konsiderohet pasuria. Prandaj, në disa kode penale të shteteve tjera e në rastin konkret të Sllovenisë, kjo vepër hynë në grupin e veprave penale kundër pasurisë. Kodi Penal i Kosovës, i referohet drejt kësaj vepre penale duke e kategorizuar në veprat e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ngase në thelb personi i cili përvetëson kundërligjshëm e keqpërdor detyrën zyrtare.

Kryerësi i kësaj vepre mund të jetë cilido zyrtarë i cili përvetëson kundërligjshëm kudo në institucione publike, kurse varësisht nga organizmi i brendshëm i punës, varësisht nga institucioni, ai që përvetëson kundërligjshëm, mund të identifikohet vetëm pas veprimeve të rregullta periodike që i ndërmerr institucioni, si p.sh. në rastin e evidentimit të aseteve (inventarit) të institucionit, kurse nëse bëhet fjalë për natyrë të punës të ndërlidhur në aspekte financiare, identifikimi i inkriminimit, zakonisht realizohet më shpejtë.

Vet nocioni përvetësim na lë të kuptojmë që zyrtari është sjellë ndaj objektit të përvetësuar sikur të ishte pronë e tij private. “ Vepërimi i kryerjes së kësaj vepre penale është përvetësimi i parasë, letrave me vlerë ose pasurisë tjetër të luajtshme. Paratë dhe gjësendet tjera të vlefshme konsiderohen se janë përvetësuar në rastet kur kryesi ndaj

tyre sillet sikur të kishin qenë ato pronë e tij. “(Salihu I. E drejta Penale, Prishtinë 2014, faqe 658) Këtu duhet bërë një sqarim, të përvetësosh nuk nënkuptohet vetëm të marrësh, por edhe ta shitesh apo edhe të ia falësh dikujt, kurse në rastin e përvetësimit të parave vjen në shprehje edhe shpenzimi i paautorizuar. Këto vepra janë mjaft të pranishme në institucione ku zyrtari ka një lloj pavarësie për të menaxhuar me mjetet, gjë që i imponohet për arsye praktike të punës dhe varësisht nga detyrat.

Këtu mund të dallojmë dy lloje të zyrtarëve që kryejnë përvetësime. Konkretisht ata që janë të ngarkuar drejtpërsëdrejti me aset apo edhe ata që nuk janë të ngarkuar me të. Në rastin e dytë, nuk bëhet fjalë për persona zyrtarë të autorizuar të cilët janë dhënë në besim objektet, por bëhet fjalë për zyrtarë të cilët i është ofruar kjo mundësi si rrjedhojë e pozicionit të një raporti fizik ku ai ka mundur të vijë në kontakt me objektin e përvetësuar, por pikërisht këtu ka burimin dallimi i madh pastaj që i bëhet kësaj veprë penale në raport me përvetësimin, ngase këtu ka edhe elemente të veprës penale të vjedhjes.

Vepra është kryer me përvetësimin e objektit të caktuar edhe në rastin kur bëhet fjalë për shmangie të sendit të caktuar i cili merret nga institucioni. Me këtë akt mund të thuhet se është realizuar apo është kryer vepra penale me përvetësimin e sendeve të caktuara. Vepra penale ekziston në formën e përfunduar edhe kur dobia në formën e pasurisë nuk është realizuar si rezultat i faktit që dikush mund të ketë penguar kryerësin. Edhe nëse objekti i përvetësuar kthehet kjo nuk do të thotë se nuk ka vepër penale, megjithatë me rastin e matjes së dënimit kjo gjithsesi mund të merret parasysht, pra në njëfarë mënyre aplikohet një lehtësim i mundshëm.

Kryerësi i veprës penale me përvetësimin e objekteve të caktuara mund të jetë vetëm personi zyrtar i autorizuar që në raste të caktuara me ligj, kryen veprime të caktuara zyrtare. Edhe këtu si në rastet e shumë veprave tjera, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje. Me këtë nënkuptohet se ky lloj i veprës penale në situata dhe rrethana tjera nuk plotëson elementet, pra dashjen – vullnetin. Personi zyrtar duhet të jetë i vetëdijshëm se me marrjen e një objekti (sendi) të huaj po e bën me rastin e ndërmarrjes së ndonjërit nga veprimet e caktuara zyrtare. Këtu kërkohet edhe qëllimi i përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore.

Sikurse edhe vepra penale e shpërdorimit të detyrës zyrtare, edhe kjo vepër ka dy forma të rënda: a) kur përfitimi kalon 5 mijë euro dhe b) 50 mijë euro. Kontestuese paraqitet situata të vepra e vazhduar e përvetësimit në detyrë (shpërdorimit), ku forma e kësaj veprë mund të cilësohet si e rëndë, nga se në këtë rast shumat e përvetësimit mund të mbledhen së bashku, varësisht nëse mund të cilësohen të gjitha veprat si të tilla. Mund të thuhet se kjo mund të vjen në kundërshtim me parimin themelor të konstruktit të veprës së vazhduar penale, ku cilësimi bëhet në bazë të veprës më të rëndë e jo në bazë të mbledhjes së tyre.

Gjithashtu mund të bëhet vërejtje në këtë kontekst ngase bie ndesh me faktin që kryesi të mos trajtohet rëndë por më lehtë. Edhe në rast se kryerësi është kapur pas një serie veprash dhe ka vazhduar të jetë në cilësinë e një recidivisti, kurse vepra të tilla ka kryer kohë pas kohe, megjithatë mbledhja e këtyre veprave si tërësi e cila eventualisht mund të konsistojë në shuma parash vihet në pikëpyetje sa i përket konstituimit si formë e rëndë e veprës penale të përvetësimit në detyrë.

Ashtu siç u cek më lartë, rezulton se parimi i specificitetit përjashton bashkimin ndërmjet kësaj veprë penale dhe veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, por sërish nuk do të përjashtohet bashkimi me vepra të tjera të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, e të cilat mund të ketë si qëllim fshehjen e veprës penale. Para së gjithash këtu bëhet fjalë për veprën e falsifikimit të dokumentit zyrtar që mund të kryhet si para ashtu edhe pas përvetësimit të një objekti.

Në praktikë është problematik dhe kontestues raporti ndërmjet përvetësimit dhe shpërdorimit, me veprën penale të përdorimit të paautorizuar të pasurisë. Këtu diferencimi mund të bëhet nëse kemi parasysh kriterin subjektiv ku kryerësi kishte për qëllim përvetësimin, apo ndoshta vetëm përdorimin e objekteve (sendeve).

Këtu është i domosdoshëm vlerësim objektiv nëse kryerësi ka mund të ketë parashikime reale se do të kthej objektet e përdorura. Duhet të theksohet se vepra penale e përvetësimit ekziston nëse kryerësi përvetëson objekte (sende) me vlerë të tilla ku e ka të pamundur të realizoj kthimin apo edhe kompensimit.

Shembull ilustrues mund të jetë një arkëtar që ka marrë kundërligjshëm para, për të cilat ka iluzion se mund t'i kthejë. Shembull tjetër mund të jetë përgjegjësi i depos furnizuese të një institucioni, posedon informacione se pas disa muajsh çmimet e një X produkti do të ngritën andaj ai gjatë regjistrimit të mallit nuk e paraqet mallin, respektivisht nuk e vendos në regjistër, ngase kalkulon në një vlerë të rritur të produktit.

5.1.4. Mashtrimi në detyrë

Kjo vepër penale konsiston me përfitimin joligjor të një pasurie apo përfitimi duke mashtruar me persona të tjerë, qoftë zyrtarë apo edhe qytetarë, të cilët në të shumtën e rasteve pa vetëdije, bëjnë forma joligjore të pagesës. Mashtrimi në detyrë është një formë e veçantë e mashtrimit ku personi i inkriminuar mashtron një person tjetër, apo edhe disa prej tyre. “ Vepër penale e mashtrimit në detyrë paraqet një formë të posaçme të mashtrimit që e kryen personi zyrtar apo personi përgjegjës, me qëllim që vetes apo një tjetri t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, duke prezantuar llogari të rreme apo duke sjellë, në ndonjë mënyrë tjetër, në lajthitje personin e autorizuar që të kryejë një pagesë të kundërligjshme.” (Hasani F. Komentar, botimi 1, Kodi penal i R. së Kosovës). Ky lloj i veprës penale është i dëmshëm si në aspektin juridik edhe atë moral Si vepër penale sjell menjëherë dëmtim të etikës në shërbim, por pasojat afatgjatë janë shumë të mëdha ngase në cilëndo formë të realizimit, mashtrimi në detyrë sjell te varfërimi i taksapaguesve.

Llojllojshmëria e detyrave dhe autorizimeve që kanë zyrtarët është mjaft e gjerë, andaj zyrtar me nivel të ulët etikë, kanë në dispozicion një spektër të gjerë të mundësive për të mashtruar palën apo edhe vetë shërbimin në kuadër të të cilit zhvillojnë detyrën publike. Mashtrimi në detyrë, varësisht nga situatat, mund të vjen veç tjerash si rezultat i besimit të tepruar ndërkolegjal, apo autorizimeve të mëdha të cilat në anën tjetër nuk shoqërohen me mekanizma të mjaftueshëm të kontrollit, përfshirë edhe ato brenda shërbimit ku zhvillohet mashtrimi.

5. 1.5. Përdorimi i paautorizuar i pasurisë

Kushdo që ka autorizim përdor paratë, letrat me vlerë apo pasurin tjetër të paluajtshme e cila i është besuar atij në detyrë ose në përgjithësi në vendin e punës, apo në të cilat ka qasje për shkak të shërbimit apo punës së tij, ose kushdo që i jep pasurinë e tillë një personi tjetër për shfrytëzim të paautorizuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vite.

Nuk ka dyshim se bazuar në këtë që u tha më lartë, ka shumë elemente të ngjashme me veprën penale të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës (neni 425); dallohet nga kjo vepër penale për faktin se tek vepra e parashikuar sipas nenit në fjalë, dashja e kryesit është e orientuar në drejtim të përvetësimit, deri sa tek vepra penale e përdorimit të paautorizuar të pasurisë, dashja e kryesit është e orientuar në drejtim të përdorimit.

Karakteristikë e veprës së përdorimit të paautorizuar të pasurisë, është marrja e përkohshme e sendit të huaj të luajtshëm, me qëllim që të kthehet përsëri, për dallim nga vepra penale e parashikuar nga neni 425, tek e cila sendi përvetësohet, merren autorizimet pronësore, pronarit të mëparshëm tentohet ti pamundësohet përgjithmonë pronësia, mbi sendin e përvetësuar. Te kjo vepër penale, përdorimi i paautorizuar i pasurisë neni, rastet dhe praktikat kanë treguar shumëllojshmëri të ngjarjeve. Në situata kur sendi i luajtshëm përvetësohet përkohësisht, me qëllim që të rikthehet më pastaj, e që ky përvetësim i përkohshëm po supozojmë se ka qenë marrja e një veture dhe si rezultat është shpëtuar një jetë njeriu, shtrohet pyetja se a kemi me të vërtetë këto elemente të kësaj vepre penale, pra të përdorimit të paautorizuar të pasurisë. Në esencë mjeti është përdorur pa autorizimin e pronarit, por që është imponuar nga rrethana të jashtëzakonshme.

Për të tërheq paralele në mes këtyre veprave penale, paraprakisht është e nevojshme të vërtetohet në mënyrë të sigurt se me cilin lloj qëllimi ka vepruar kryerësi. Nëse, nga të gjitha faktet e vërtetuara, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, rezulton se kryerësi nuk kishte qëllim që në një afat të arsyeshëm, ti kthente përsëri sendet e tjera të luajtshme dhe objektivisht nuk kanë ekzistuar kushte për kthimin e tyre brenda atij afati, atëherë do të ishte fjala për përvetësimin gjatë ushtrimit të detyrës dhe jo për vepër penale të përdorimit të paautorizuar.

Veprimi i kryerjes te kjo vepër penale qëndron në përdorimin e paautorizuar të parasë, letrës me vlerë apo sendeve të tjera të luajtshme të cilat janë besuar kryerësit të veprës penale në shërbim apo përgjithësisht në punë ose në dhënien e paautorizuar, hua të këtyre sendeve, pra, këtu kryerësi i merr sendet me qëllim që ti përdor (që vetë ai apo edhe dikush tjetër ti shfrytëzoj përkohësisht) dhe pas kësaj ti kthej ato. Pra kur bëhet fjalë te përvetësimi, kryerësi i kësaj vepre penale i merr sendet për ti përvetësuar, pra, nuk ka qëllim ti kthej ato.

Sidoqoftë, gjatë shqyrtimit të seancës gjyqësore, duhet të merren parasysh rrethanat dhe të gjitha provat e tjera relevante në mënyrë që të bëhet vlerësimi i gjithanshëm i veprës penale. Në vazhdim të kësaj trupi gjykues duhet të marrë parasysh dhe të vlerësoj një mori rrethanash që tregojnë se nga çfarë qëllimesh ishte udhëhequr kryerësi, cilat ishin mundësit reale që kryerësi ti kthejë sendet e luajtshme, cila është vlera e këtyre sendeve, sa kohë ka kaluar nga marrja e tyre, etj. Në fakt për ti sqaruar të gjitha këto, nevojitet një hetim i cili në mënyrë kronologjike do të shpjegonte situatën e krijuar, dhe një shpjegim i tillë pa dyshim se do të duhej të mbështetej jo vetëm në deklarin e personit që e ka kryer veprimin, por edhe në deklaratat e dëshmitarëve, dhe provat e tjera dhe dëshmitë e tjera materiale, etj.

Se shërbimi është kryer pa autorizim, do me thënë, nuk ekziston asnjë bazë juridike e autorizuar për përdorim. Përgjithësisht, personi në detyrë apo në punë, vetëm me lejen apo urdhrin e organit kompetent, mund ta jap për shërbim personit tjetër fizik apo juridik sendet që i janë besuar. “Autorizimet e tjera” që kryesisht mund të jenë verbale, dhe ballafaqimi i mundshëm në seanca gjyqësore, pro dhe kundër në situata të tilla do të ishte i pavlefshëm.

5.2. Marrja dhe dhënia e mitos

Dhënia e mitos, mit marrja, janë një nga format më të shpeshta të rasteve korruptive dhe në veçanti të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Është një nga format më të drejtpërdrejta kur një zyrtarë i një posti publikë, merret vesh me palën, në këtë rast mitëdhënësin që si kompensim për shumën e përvetësuar ta privilegjojë atë duke ushtruar apo mos ushtruar një detyrë zyrtare. Përgjithësisht kë është një fenomen gjatë i pranishëm në shoqërinë njerëzore, pavarësisht stadeve të zhvillimit të një shoqërie, emancipimit, apo edhe

kapaciteteve ekonomike. Përveç përkufizimit penal-juridik dhe përkufizimit ligjor të kësaj dukurie, është e rëndësishme t'i qasemi edhe nga këndvështrimi i praktikës gjyqësore. “ Për ekzistimin e veprës penale të dhënies së ryshfetit, nuk është e nevojshme që personi që jep ryshfet, të shprehet shprehimisht për se e bën këtë. Është e mjaftueshme që, sipas rrethanave të rastit dhe të mënyrës së dhënies së ryshfetit, si dhe raporteve që egzistojnë ndërmjet dhënësit të ryshfetit dhe personit zyrtar, mund të përfundohet se dhënësi i ryshfetit kërkon nga personi zyrtar t'i kryejë ndonjë shërbim në kuadër të autorizimeve të tij dhe personi zyrtar mund ta kuptojë se për çfarë qëllimi jepet dhurata” (Hasani F. Kodi Penal i R. së Kosovës, Komentar, botimi 1)

Siç edhe e kemi përmendur në fillim të këtij studimi, kjo formë e korrupsionit, ka qene objekt i pakënaqësive por edhe i tregimit nga këndvështrime të ndryshme të autorëve të mëdhenj botërorë. Shumë prej tyre janë preokupuar me të dhe këto vepra edhe sot mbesin emblematic, varësisht nga fusha të cilës i përkasin. Ato shërbenin për të goditur rastet korruptive të cilat i shihnin në mesin e sundimtarëve, oborrtarëve të tyre apo edhe të institucioneve fetare të kohës. Sikurse në rastin e Erazmos nga Roterdami dhe veprës së tij “Lavdi marrisë”.

Keqpërdorimi me anë të mitos, mbetet edhe sot një shqetësim i përmasave globale, njëjtë i pranishëm si në vendet dobët të zhvilluara, ashtu edhe në vendet më të përparuara. Por, megjithatë në vendet me zhvillim të ulët ekonomik, si dhe ato që dikur i përkisnin botës komuniste, vërehet që shkalla e keqpërdorimeve me mitën është shumë e lartë, kurse perceptimi në masat shoqërore e pranon gati si normale.

Lidhur me këtë vepër penale vazhdojnë të zhvillohen hulumtime të ndryshme, kurse në shkallë botërore nëse i referohemi dhjetëvjeçarit të fundit, shumica e përgjithshme e mitos se dhënë dhe të pranuar arrinte rreth një mijë miliardë dollarë amerikanë çdo vit. Nga kjo shumë, njëzetepesë deri tridhjetë miliardë, përbejnë shumat e mitës në vendet e UE-së.

Mitën si fenomen dhe vepër penale ka edhe efekte zingjyrore, politike, ekonomike e deri te ato sociale, ngase ajo fillon të jetë një normë dhe kriter me anë të të cilit kryhet një punë, kurse kjo pastaj bartet si një bindje e përgjithshme te qytetarët dhe krijon kondita të caktuara të sjelljes në raport me zyrtarët publikë.

Pavarësisht se është një nga format më të rëndësishme të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, e përhapur dhe lehtë e zbatueshme, mita si fenomen ka arritur të mbijetojë, ngase nuk është trajtuar seriozisht nga shumica e qeverive botërore dhe atë relativisht vonë. Por, kohëve të fundit vërejmë se shume vende, përfshirë edhe republikën e Kosovës, po krijojnë mekanizma institucionale për të detektuar këtë fenomen edhe më pas edhe për ta luftuar.

Në rastin e Kosovës, vepron Agjencia Kundër Korrupsionit, i cili ka autoritet të mjaftueshëm për të kërkuar llogari nga zyrtarët publikë, për ti hetuar ata, si dhe për të kërkuar nga ata deklarin e pasurisë. Kjo Agjenci në mandatin e tij e ka edhe obligimin që të publikojë edhe raportet e hetimeve me statistika të qarta. Gjithashtu nga ana e Presidentes së Kosovës, është formuar këshilli për luftimin e korrupsionit. Pa paragjykuar funksionimin efikas të këtyre mekanizmave institucionale, vet themelimi i tyre flet për shkallën e shqetësimit.

Fenomeni i mitos është i pranishëm në forma të ndryshme në Kosovë, duke përfshirë shumë sektorë publikë dhe nganjëherë është e vështirë të dallohet se çfarë realisht duhet të trajtohet dhuratë e çfarë jo. Në Kosovë, përfshirë këtu edhe sektorin e shëndetësisë, dhënia e të hollave qoftë edhe në shuma të vogla, paraqitet edhe si një normë e sjelljes me të cilën pacienti apo familjari i tij tregon mirësjelljen ndaj personelit mjekësorë, kurse qartë përmban edhe elemente të besëtytnisë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ligji nuk është përcaktues sa duhet, kurse në këtë drejtim ai ka mbështetjen edhe të rregulloreve, udhëzimeve, si dhe të procedurave të brendshme të institucioneve.

Duhet veçuar udhëzimet apo rregulloret e brendshme të policisë së Kosovës që me saktësi precizojnë dhe definojnë fenomenin “dhuratë”. Kosova ka bazë të mjaftueshme ligjore për të luftuar korrupsionin dhe mitën në veçanti, ngase qysh në vitin 2004, Kuvendi i Kosovës kishte miratuar “Ligjin Kundër Korrupsionit”. Gjithashtu janë organizuar organizata të shumta joqeveritare, të cilat kanë marrë përsipër rolin e monitoruesit të institucioneve publike, varësisht nga dinamika, publikojnë edhe raporte të ndryshme. Neni 343 flet edhe për mitëmarrësin dhe saktëson tri forma të kësaj vepre penale:

- a. Kërkimi dhuratës apo përfitimit tjetër

- b. Pranim i dhuratës apo përfitimit tjetër
- c. Pranimi i premtimit për dhuratë apo përfitimit tjetër

Në të gjitha këto raste është e qartë se bëhet fjalë për imponim të një kushti të cilin qytetari duhet realizuar në mënyrë që të vijë deri te e drejta e tij qytetare apo edhe për të krijuar privilegje me që rast mund të cenoje të drejtat e një qytetari tjetër. Përndryshe dhuratë konsiderohet çdo vlerë apo pasuri e cila jepet pa kompensim. Ajo mund të jetë në formë të parasë, pasurisë së paluajtshme apo edhe pasurisë së luajtshme.

Kurse, kur bëhet fjalë për termin “Përfitim” rëndom bëhet fjalë për privilegjet e natyrës së tillë të një përfitimi të jo drejtpërdrejtë në formë shpërblimi me anë të punësimit, lehtësirave me marrjen e subvencioneve të ndryshme nga shteti, lehtësira të ndryshme bankare, kurse në relacionet brenda një institucioni, si në relacionin ndërmjet eprorit dhe anëtarit e tij të stafit apo edhe anasjelltas, krijohen privilegje të tilla që mundëson natyra e punës që mundësohet brenda institucionit, si p.sh. pushimet vjetore jo-formale, caktimi i orëve jashtë-orarit pa i merituar ato, kryerja e punëve të ndryshme private gjatë orarit të punës.

Me veprën penale të dhënies së mitos, rrezikohet ligjshmëria të ushtrimit të detyrave zyrtare nga jashtë, nga persona të cilët nuk janë zyrtarë. Arsyeja që kjo vepër penale është para së gjithash e mbështetur me faktin se është e ndërlidhur me marrjen e mitos, ngase dhënia e mitos më së shpeshti bëhet me kërkesën apo me pranimin e mitos nga ana e personit zyrtarë. Përveç kësaj, mita jepet lidhur me kryerjen apo edhe moskryerjen e detyrës zyrtare. Nga ana tjetër, nëse kjo vepër penale nuk do të sistemohej në vepra penale kundër detyrës zyrtare, vështirë se do të mund të sistemohej në mënyrë më të duhur në ndonjë kapitull tjetër të veprave penale.

Nocioni “Dhuratë” dhe “Ndonjë përfitim tjetër” e kanë të njëjtin kuptim sikurse edhe të vepra penale e marrjes së mitos. Duke iu referuar paragrafit të parë, këtë vepër penale, e kryen kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, i premtton, ofron ose jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtarë, në mënyrë që ai të veprojë apo të mosveprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare. Bazuar në këtë që specifikua më lartë, vijmë në përfundim se mitëmarrësi dhe mitëdhënësi janë të dy njësojë përgjegjës para ligjit.

Pra rezulton nga dispozita e këtij paragrafi, veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është përcaktuar në mënyrë alternative. Andaj, këto mënyra të veprimit kryhen në këto forma:

- Kur ndokush i jep dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtarë, ose
- Kur ndokush i premtot dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtarë

Në kodin penal të mëparshëm, por edhe në kodet penale aktuale, si formë e kryerjes së kësaj vepre penale ka qene edhe ndërmjetësimi, respektivisht si kryerës i kësaj vepre penale është konsideruar edhe personi i cili ka ndërmjetësuar në mes të dhënësit dhe marrësit të mitos. Andaj kjo është e kuptueshme në rastin e amendamentimit të këtij kodi, duhet të inkriminohet edhe ndërmjetësimi.

Ashtu siç u tha edhe më lartë, ndërmjetësim në dhënien e mitos konsiderohet secili veprim me të cilin ndonjë person në një formë apo në një tjetër kontribuon që dhurata apo ndonjë përfitim tjetër ti jepen personit zyrtarë. Ndërmjetësimi mund të bëhet në mënyra të ndryshme, për shembull, duke vënë lidhje midis personit që jep dhe që merr mitën, duke dërguar porosi, duke kumtuar kushtet, duke marrë dhuratën nga personi me qëllim që t'ia dorëzoj personit zyrtarë etj. Shikuar në përgjithësi, në rastet e kësaj vepre penale ndërmjetësuesi në masë të konsiderueshme vepron si shtytës, nxitës apo edhe si ndihmës në dhënien e mitos, mirëpo ligji këtë e inkriminon si veprim të kryerjes, kështu që edhe ky konsiderohet si kryerës i kësaj vepre penale.

Të dy këto forma që i përmendem më lartë, të kësaj vepre penale ndërmerren me të vetmin qëllim, që personi zyrtarë të kryej veprimin zyrtarë, të cilin nuk është dashur ta kryej, ose që të mos e kryej veprimin zyrtar të cilin është dashur ta kryej.

Pra, veprimi apo mos veprimi i personit zyrtar, përbënë vepër penale. Për ekzistimin e veprës penale është e domosdoshme që të jetë fjala për veprimin zyrtarë i cili ndërmerret në suaza të autorizimeve paraprake zyrtare. Ky lloj i veprës penale, konsiderohet se është kryer me vet faktin e premtimit apo edhe të dhënies së dhuratës ose përfitimit tjetër lidhur me kryerjen e veprimit i cili është i kundërligjshëm apo edhe nga ana tjetër e mos kryerjes së veprimit zyrtarë, ose nga aspekti tjetër për ekzistimin e kësaj vepre penale nuk është e domosdoshme që personi zyrtar, për shkak të marrjes së

dhuratës ose premtimit se do ti jepet dhuratë, të ketë kryer apo të mos ketë kryer veprimin zyrtarë. Këtë vepër penale, pra veprën penale të dhënies së mitos mund ta krye ose mund të jetë çdo person.

Karakteristikë e veçantë e kësaj vepre është se vepra mund të kryhet vetëm me dashje. Në lidhje me këtë lloj apo formë të fajësisë, kryerësi duhet të jetë i vetëdijshëm se premtion apo jep dhuratë ose përfitim të llojit tjetër, ose siç u specifikua më lartë ndërmjetëson dhe se tërë këto veprime i bënë me qëllim që personi zyrtarë, të kryejë veprimin e paligjshëm apo të mos e kryejë një veprim të paligjshëm, veprimin që është i obliguar ta kryejë në bazë të ligjit, apo ligjeve përkatëse.

Nëse shohim paragrafin 2, aty hetojmë edhe formën e dytë të kësaj vepre penale, e cila konsiderohet dhe merret si e kryer, kur personi në mënyrë të drejtpërdrejtë apo edhe të tërthortë, i premtion, ofron ose i jep dhuratë apo edhe përfitime të tjera personit zyrtarë në mënyrë që të ai të veproj apo të mos veproj në kundërshtim me detyrën zyrtare. Këtu e vërejmë dallimin e kësaj forme të vepre penale në krahasim me formën e lartcekur e cila konsiston në natyrën e veprimit, të cilën personi zyrtar duhet ta kryejë lidhur me miton.

Me fjalë të tjera, dallimi qëndron se te kjo lloj forme dhurata, apo përfitimi tjetër ose edhe premtimi jepen me të vetmin qëllim që personi zyrtarë të veproj në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare. Ndërsa sikurse edhe në formën e parë edhe kjo formë e veprës penale, duhet kryhet vetëm me dashje.

Shikuar më tutje paragrafin 3, është paraparë forma më e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet vetëm atëherë në qoftë se kryerja e kësaj vepre rezulton drejtpërsëdrejti me përfitim në vlerë, e që tejkalon shumën 15 mijë euro. Duke qenë në dijeni se, ky lloj i veprës penale vështirë zbulohet edhe për kundër mjeteve të sofistikuar të përgjimit, në paragrafin 4, është paraparë një dispozitë e posaçme e karakterit kriminal politik, sipas të cilit ekzekutuesi apo kryerësi i veprës penale të dhënies së mitos, mund të lirohet nga dënimi.

Sipas këtij paragrafi(paragrafit 4) me qëllim që subjekti të lirohet nga dënimi, duhet plotësuar dy kushte në mënyrë kumulative:

- I pari është që kryerësi(subjekti) ta ketë dhënë ose ta ketë premtuar mitën, vetëm me kërkesën e personit zyrtarë(autorizuar), dhe
- Kushti i dytë është që ai që jep mitën, duhet ta ketë paraqitur veprën para se ajo të jetë zbuluar ose para se të ketë marrë vesh, të jetë njoftuar se ajo është zbuluar. Në bazë të këtij kësaj dispozite, lirimi nga dënimi është i mundur për të gjitha llojet apo format e kësaj vepre penale.

Situata të ngjashme dhe forma të tilla të kësaj natyre të veprës penale, janë provuar edhe në praktikë në Kosovën e pasluftës; personi i dëmtuar materialisht i vënë para aktit të kryer është dashur të jap shuma të caktuara parash në mënyrë që ta rikthejë pasurinë e luajtshme, e cila iu ishte vjedhur më herët. Andaj një organizim i mirë nga ana e ndjekësve të krimit dhe hetuesve në njërën anë dhe palës së dëmtuar në anën tjetër krijon parakushte dhe dëshmi të mjaftueshme që “viktima si subjekt” të mos bjerë pre e ndonjë dënimi eventual që parashihet sipas paragrafit 4 të pikës b të Kodit Penal.

Qartë parashihet në paragrafin 4, se dhurata ose ndonjë përfitim i ngjashëm eventual, do të konfiskohen. Ndërsa në rastin e veprës penale, sipas paragrafit 3, kur dhurata ose përfitimi tjetër janë dhënë me kërkesën e personit zyrtarë, parashihet mundësia që ti kthehen dhënësit të mitos.

		Kosova	Sllovenia	Estonia
Mita aktive	Për veprime të paligjshme të zyrtarëve	3 muaj - 3 vite	1 - 5 vite	1 - 10 vite
	Për veprime të ligjshme të zyrtarëve	Deri 1 vit	6 muaj - 3 vite	1 - 5 vite
Mita pasive	Për veprime të paligjshme të zyrtarëve	6 muaj - 5 vite	1 - 8 vite	1 - 10 vite
	Për veprime të ligjshme të zyrtarëve	3 muaj - 3 vite	1 - 5 vite	1 - 5 vite

Tabela 2: Krahasim i dënimeve të parapara për vepra penale kundër detyrës zyrtare të ndërlidhura me çështjen e mitos

Dënimi për veprën penale, nga paragrafi 1, është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 vite, për veprën penale nga paragrafi b është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në 3 vite, deri sa për veprën nga paragrafi 3 prej 3 muaj deri në 3 vite.

5.3 Ushtrimi i ndikimit

“Ushtrimi i ndikimit”- neni 431, e që gjithashtu është vepër penale në legjislacionin penal të Kosovës, e paraparë sipas standardeve të Unionit Evropian dhe njëherazi si vepër penale është e njohur është e njohur edhe në Unionin Evropian.

Si vepër penale, është paraparë me qëllim që të mbrohet nga ndikimet e jashtme ushtrimi i ligjshëm dhe objektiv i detyrës dhe i autorizimeve të personave zyrtarë. Sipas paragrafit 1, këtë vepër penale e kryen kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthorët kërkon apo pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo për personin tjetër ose pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë në mënyrë që të ushtroj ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar apo zyrtarit publik të huaj, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati.

Veprimin e kryerjes së kësaj vepre penale, janë paraparë në mënyrë alternative, kur ndokush kërkon merr ose pranon një ofertë ose premtim me qëllim që të realizoj një përparësi për vete, apo për personin tjetër që do të realizohej duke ushtruar ndikim në vendimmarrjen e personit zyrtar.

Shembuj që përputhen me natyrën e kësaj vepre penale, mund ti hasim edhe në vitet e kaluara në Kosovë, kur persona zyrtarë të, përfaqësues të organizatave të huaja apo edhe në nivel shteti pranojnë ose premtojnë se do të japin përparësi X personit për ta punësuar në organizatën Y. Dallimi i kësaj vepre penale dhe veprës penale të dhënies së mitos, konsiston në faktin se përderisa një përparësi, një përfitim i caktuar, arrihet duke i dhënë mitën personit zyrtar, kjo vepër penale, përparësia përkatësisht përfitimi në mënyrë të kundërligjshme arrihet pa dhënë mitën.

Bazuar në këtë, edhe pse personi zyrtar nuk pranon mitën, ai duhet të jap llogari për shkak se ka prishur konkurrencën e barabartë të garës për punësim.

Pasoja e kësaj veprë penale është e nivelit të njëjtë me marrje apo dhënien e mitos e cila është vepër penale, ngase edhe këtu realizohet një e drejtë e cila nuk do i takonte kryerësit edhe këtu njëjtë, këtë vepër penale mund të kryej çdo person dhe vetëm me dashje. Vepra penale konsiderohet se është kryer pa marrë parasysh nëse arritur qëllimi i kryerësit që ta realizoj një përparësi të padrejtë.

Në paragrafin 2, është paraparë edhe forma e dytë e kësaj veprë penale e cila konsiderohet se kryhet kur dikush në mënyrë të drejtë i premt, ofron ose jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër të ngjashëm personit tjetër në mënyrë që ky person të ushtroj ndikim të papërshtatshëm mbi vendimmarrjen e personit zyrtar apo zyrtarit publik të huaj, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar.

Edhe këtu qëllimi është i njëjtë që të arrihet një përparësi e padrejtë, e që bie ndesh me ligjin apo ligjet për shkak të vendimmarrjes së personit zyrtar, derisa ai ushtron detyrën apo është autorizuar zyrtarisht. Dallimi ekziston se kjo formë e veprës penale kryhet me ndërmjetësim

Vepra penale e ushtrimit të ndikimit e paraparë në nenin 431, është e re, por është në përputhje me standardet e Unionit Evropian. Për dallim nga shumica e veprave penale të cilat kanë të bëjnë me keqpërdorimin e detyrës zyrtare, kur bëhet fjalë për ushtrimin e ndikimit, kjo vepër penale në masë të madhe kryhet nga personat fizik, respektivisht qytetarët, të cilët mund të ushtrojnë çfarëdo lloji të ndikimit tek zyrtarët.

Paragrafi 1, parasheh që këtë vepër penale mund ta kryejë kushdo, i cili ofron, kërkon dhe pranon ndonjë shpërblim, e pastaj me ndikimin e tij, të pengoj vendimmarrjen zyrtare qoftë nëse bëhet fjalë për zyrtarë publik të vendit apo edhe zyrtarë të huaj dhe në këtë rast nuk bëhet fjalë për ndikim të drejtpërdrejtë por edhe llojet e ndikimeve të supozuara e që shpijnë deri tek vendimmarrja, të cilën e dëshiron i inkriminuari.

Shembull të cilin e përmend autori Ismet Salihu në veprën e tij “Mbi të drejtën Penale”, mund të jetë edhe favori i cili mund të kthehet me favor tjetër, më konkretisht nëse

personi A pranon një ofertë, ai pastaj ia jep kundër ofertën e tij personit B, me çka kërkohen favore te dyfishta.

Këtu bëhet fjalë për ushtrim të ndikimit, pa dhënie klasike të shpërblimit në kuptimin e të mirave materiale, por, në kuptimin e veprës penale sanksionohet barabartë. Sikurse na sugjeron natyra e kësaj vepre penale, ajo mund të kryhet vetëm qëllimshëm. Duhet pranuar se, ushtrimi i ndikimit është mjaftë i pranishëm në shoqërinë kosovare, dhe gjatë gjithë viteve të pasluftës, ka krijuar përparësitë e kundërligjshme, gjë që ka shembur barazinë ndërmjet qytetarëve, dhe që është sidomos e pranishme në rastet e punësimit, apo edhe të politizimit të administratës publike.

Karakteristikë e ushtrimit të ndikimit është se, ka forma të ndryshme dhe nuk është krejtësisht e sigurt që e drejta penale mund t'i luftojë të gjitha. Pasi që në disa raste e drejta penale nuk mund të depërtoj kur bëhet fjalë për ushtrimin e ndikimit, ngritën dilemat e përgjegjësisë qytetare, apo edhe çështjeve përkatëse disiplinore brenda institucionit.

Kjo vepër e cila është e pranishme që nga vitit 2004, nuk ka arritur të parandalohet, ushtrimi i ndikimit përgjithësisht karakterizohet si diçka normale në shoqëri, lidhur me të as që tentohet të mbahet sekrete apo edhe vazhdon të jetë një lloj i sekretit “publik”, por treguesi i qartë mbi aplikimin apo mos aplikimin e të drejtës në këtë rast, është fakti që së paku deri këtë vit, askush nuk është dënuar për këtë vepër, më saktësisht nuk ka as edhe një rast të vetëm të aplikimit të nenit 431, sipas të cilit ushtrimi i ndikimit është një vepër penale, veç tjerash edhe në kuadër të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, por siç u tha edhe më lartë, ajo në radhë të parë ushtrohet nga qytetarët si persona fizik apo edhe juridik.

Ushtrimi i ndikimit vjen si fenomen i pranuar në shoqëri edhe si rezultat i disa faktorëve. Kosova është një shtet relativisht i vogël, me rreth dy milion banorë, me disa përjashtime, ka pak qytete që mund të konsiderohen si të mëdha, dhe të gjitha këto ndikojnë në afërsinë e raporteve ndërmjet qytetarit me zyrtarin, gjë që si pasoj shkakton, të kuptuarit e ushtrimit të ndikimit si diçka jo më shumë se favorët e zakonshme ndër personale, që njerëzit i kërkojnë nga njëri-tjetri, në rrethe familjare, shoqërore apo edhe në marrëdhënie ndër fqinjësore në jetën e tyre të përditshme.

Ndërmjetësimi i kundërligjshëm sipas kodit penal të Kosovës lë të kuptohet që është më tepër pjesë e ushtrimit të ndikimit, prandaj nuk ka edhe një nenë të veçantë që i referohet kësaj veprë penale. Ne mund të bëjmë një krahasim me kodin penal të Kroacisë, më saktësisht nenin 243, i cili i referohet ndërmjetësimit të kundërligjshëm si vepër e veçantë penale. (Kazneni Zakon, 2013)

Në rastin e dënimit më të lehtë për këtë vepër penale, në Kroaci është paraparë dënimi me burg prej gjashtë muaj deri tre vjet dhe atë për raste kur një person zyrtarë filloi të ushtrojë ndikim me anë të ndërmjetësimit, kurse për këtë ka pranuar dhuratë apo ndonjë benefiti tjetër, pavarësisht nëse ndërmjetëson që të kryhet apo të mos kryhet ndonjë detyrë zyrtare.

Karakteristikë e ndërmjetësimit është fakti se zyrtari mund të marrë mito apo përfitim tjetër, duke përdorur këtë rast pozitiv të tij zyrtarë për të ndikuar në një pozitë zyrtarë tjetër. Pashmangshëm kjo krijon një “aleancë korruptive” apo edhe një linjë shpesh afatgjatë për përfitime personale. Fenomenologjia e këtij procesi presupozon një segment punues i cili nis nga iniciativa dhe përfundon me realizimin e segmentit, por në të vërtetë ai testohet, kurse tendenca e personave zyrtarë të korruptuar është që të bëjnë gjithnjë e më “perfektë” praktikën e tyre.

5. 4. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore

Gjyqtari i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për ti shkaktuar dëme personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2013, f. 209)

Në një shoqëri mirë të konsoliduar, të organizuar, ku të drejtat dhe liritë e njeriut respektohen skajshmërisht, ku gjyqësori është tërësisht i pavarur, roli i gjyqtarit pa dyshim se është i shenjtë. Për shkak të këtij roli kaq të ndjeshëm dhe për shkak të rëndësisë së veçantë që ka funksioni i gjyqtarit, në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, ligjshmërisë, kushtetutshmërisë, drejtësisë, kjo vepër penale përbënë një formë të veçantë të keqpërdorimi të detyrës dhe autorizimeve zyrtare.

Andaj, kjo vepër penale është sanksionuar, shkelje e qëllimshme e ligjit, nga ana e bartësve të te funksioneve gjyqësore. “ Me kryerjen e kësaj veprë penale ndonjë person më së shpeshti privohet nga ndonjë e drejtë apo i kufizohet ndonjë e drejtë që i takon në bazë të kushtetutës, ligjit apo të ndonjë akti të përgjithshëm, apo ndonjë personi tjetër i njihen të drejtat që nuk i takojnë apo i njihen të drejtat në masë më të madhe” (Salihu I. E drejta Penale, Prishtinë 2014, faqe 673)

Për rëndësinë e ushtrimit të këtij profesioni, janë parashikuar dispozita të ndryshme ndërkombëtare, me të cilat garantohet pavarësia dhe paanësia e gjykimit. Parashikohet që me rastin e përcaktimit të të drejtave dhe detyrimeve të qytetarëve dhe bazueshmërisë së çfarëdo akuze, secili ka të drejtë për një gjykim të drejtë dhe publik, në një afat të arsyeshëm, pranë një gjykate të paanshme dhe të pavarur të themeluar me ligj. E ashtuquajtura deklaratë e Montrealit, për pavarësinë e gjyqësorit, neni 2.02 të deklaratës II Universale e pranuar në seancën plenare të sesionit të parë të konferencës së Parë Botërore për pavarësinë e Gjyqësorit, mbajtur në Montreal të Kanadasë, më 10.06.1983, është parashikuar që gjyqtarët si individ duhet të jenë, të lirë dhe është detyrim i tyre që të marrin vendime të paanshme, bazuar në vlerësimin e lirë të fakteve dhe kuptimin personal të ligjit nga ana e tyre, pa kufizime, ndikime, shtytje, kërcënime, presione dhe ndërhyrje nga jashtë apo nga brenda, nga kushdo qoftë dhe pavarësisht nga shkak. (JIWP, 1983)

Parashkrimi i lëndëve viteve të fundit në Republikën e Kosovës, bazuar në kritikën e shoqërisë civile dhe vetë shqetësimet që shprehë shoqëria kosovare, paraqet në vete një normë ligjore tërësisht inkriminuese. Është vërejtur tendenca e gjyqtarëve që qëllimshëm kanë vonuar seancat gjyqësore, kur bëhet fjalë për veprat e ndryshme penale, ku si persona të dyshimtë është dashur të gjykohen persona zyrtarë ose ish persona zyrtarë, titullarë, persona me ndikim të fuqishëm në institucione etj.

Këto vonesa, të qëllimshme e që arsyetimin e kanë gjetur në grumbullimin e lëndëve nëpër sirtar, mungesë të mjaftueshme të stafit të gjyqtarëve, e që prapaskenë shoqëria e pavarur civile nuk i sheh ndryshme përveç vonimit të qëllimshëm dhe si përfundim ka rezultuar parashkrimi i lëndës. Kjo nuk nënkupton se këtu ka dështuar në aspektin administrativ dhe procedural vetëm gjyqësori, por edhe politikat e tjera shtetërore administrative e veçanërisht ato gjyqësore e që në një formë apo në një formë tjetër nuk

kanë krijuar parakushte dhe infrastrukturë ligjore me kohë, dhe kanë lejuar pa përgjegjshëm grumbullimin e lëndëve me vite të tëra.

Proceset e ndryshme të emërimeve dhe të riemërimeve të gjyqtarëve, nëpër periudha të ndryshme kohore por që nga pas lufta në Kosovë, me mandate të caktuara kohore dhe jo me vendime të përhershme të gjyqtarëve, është edhe një element tjetër shtesë, që ka demotivuar gjyqtarët të jenë profesionist të denjë në detyrën e tyre. Këtu janë disa elemente që jo shpesh herë i hasim edhe nëpër literaturë, përveç elementeve të tjera që ndikojnë negativisht në vendimmarrje të gjyqtarëve, siç është presioni dhe kërcënimi, etj. Në këtë rast veprën penale e kryen gjyqtari i inkriminuar, i cili me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme, për vete apo për ndonjë individ tjetër, ose edhe për t'i shkaktuar tjetrit dëm, merr vendim të kundërligjshëm nga cilësia zyrtare si Gjykatës i rastit.

Politikat ligjore-administrative e parashkrimit të lëndëve paraqet edhe një nxitje tjetër dhe motivim, njëherazi kalon dhe bëhet normë praktike e ikjes nga ligji edhe nga zyrtarë të lartë shtetëror. Ky lloj i veprës penale mund të kryhet me veprim apo me mosveprim duke u marr një vendim, aktvendim, urdhëresë, dhe akt tjetër i kundërligjshëm, apo duke u ndërmarrë veprime të tjera, me të cilat shkelet ligji (futja në procesverbal, fakte jo relevante për ngjarjen apo ndodhinë, pastaj mos marrja parasysh e fakteve relevante për ngjarjen apo ndodhinë). Ndërkaq vepra penale kryhet me mos veprim, në rastet kur ka ekzistuar obligimi i gjyqtarit për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara (për shembull: edhe për kundër njohurive që ka poseduar gjyqtari për ekzistimin e fakteve apo dëshmive në një lokacion të caktuar, qëllimshëm nuk i ka lëshuar urdhëresë për kontroll apo bastisje organit të ndjekjes.

E tëra kjo bëhet qëllimshëm dhe fare në fund plotësohet vepra penale, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore. Njëherazi, veprimet e tilla nga ana e gjyqtarit bëhen qëllimshëm për të ndihmuar apo favorizuar njërën palë, e kjo nënkupton me automatizëm dëmtimin e palës tjetër në gjykim të drejtë, për ti sjellë vetes apo tjetrit përfitim pasuror.

Dallojmë shkelje të ligjit material si dhe të shkelje të ligjit procedural dhe nuk është me rëndësi se në cilën lloj të procedurës bëhet shkelja- në procedurën kontestimore, penale

apo në ndonjë procedurë tjetër. Për ekzistimin e kësaj vepre penale, është e parëndësishme, faza procedurale me të cilën është marrë vendimi i kundërligjshëm. Kjo, mund të jetë bërë në procedurën paraprake, në shqyrtimin kryesorë, në procedurën e shkallës së parë apo në procedurën sipas mjeteve juridike, duke i përfshirë edhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Forma më e rëndë e shkeljes së ligjit nga ana e gjyqtarit për nga pasojat e shkaktuara, mund të paraqiten në procedurën penale, kur gjyqtari merr vendim për privim të kundërligjshëm nga liria dhe gjykimi i personit të pafajshëm.

Marrja e vendimit të kundërligjshëm duhet të kryhet gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit. Përpos kësaj, është e domosdoshme që kryesi i veprës penale të ketë qëllimin, që vetës apo tjetrit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm apo tjetrit t'i shkaktohet dëm.

Kryes të kësaj vepre penale mund të jenë vetëm gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët për kundërvajtje dhe gjyqtarët laik. Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje. Kërkohej shkelja e qëllimshme dhe e vetëdijshme e ligjit. Përndryshe ekspertë të caktuar të kësaj fushë, janë të mendimit se emërtimi zyrtar i veprës penale për të cilën u fol më lartë nuk është krejtësisht kompatibil me funksionin e tij. (Salihu, Zhitija, & Hasani, Komentar, 2014, f. 1239)

5.5. Zbulimi i fshehtësive zyrtare

Zbulimi i fshehtësisë zyrtare, për dallim nga veprat tjera penale, mund të vjen edhe nga kujdesi jo i mjaftueshëm i zyrtarit, së paku kështu flet praktika e deritanishme. Kjo vepër penale, në rast se është kryer pa qëllim, vjen gjithashtu si pasojë e sistemimeve joadekuate të zyrtarëve, në pozita të punës për të cilat mund të mos jenë të kualifikuar, apo edhe për të cilat nuk kanë përgjithësisht njohuri të mjaftueshme.

Gjithsesi të kryesh një keqpërdorim të detyrës, pa dashje paraqet një realitet të shkeljes ligjore, kurse statistikat tregojnë se këto janë raste në disproporcion të thellë me kryerjen e këtyre veprave penale me dashje. Ky disproporcion ka nxitur vazhdimisht autorë të ndryshëm të merren me fenomenin e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ngase

ata qysh atëherë e kishin të qartë se kjo dobëson qëndrueshmërinë e strukturave të shtetit, si dhe ulë kualitetin e jetesës për qytetarët e rëndomtë.

Zyrtari i cili pa autorizim kumton, dërgon ose në ndonjë mënyrë tjetër i vë në dispozicion personit tjetër informatën që përbën fshehtësi zyrtare ose siguron informatën e tillë me qëllim që t’ia përcjellë ndonjë personi të paautorizuar, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet për përfitim personal ose me qëllim të publikimit apo shfrytëzimit të informacionit jashtë Republikës së Kosovës, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet. Në rast se vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2013, f. 209)

Dispozitat e këtij neni zbatohen ndaj personit i cili zbulon fshehtësinë zyrtare edhe pasi që të ketë pushuar statusi i tij zyrtar. Për qëllime të këtij neni, shprehja “fshehtësi zyrtare” nënkupton informatat ose dokumentet të shpallura si fshehtësi zyrtare me ligj, dispozita të tjera ose me vendim të organit kompetent të nxjerrë në bazë të ligjit dhe zbulimi i të cilave ka shkaktuar ose mund të shkaktojë pasoja të dëmshme.

Sidoqoftë, informatat në vijim nuk konsiderohen fshehtësi zyrtare, si informatat apo dokumentet të cilat janë të drejtuara në cenimin e rëndë të të drejtave themelore të njeriut ose mos zbulimi i të cilave do të mund të rrezikonte rendin kushtetues apo sigurinë e Republikës së Kosovës; ose informatat dhe dokumentet të cilat kanë për qëllim fshehjen e kryesit të veprës penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim.

5. 6. Falsifikimi dhe manipulimi me dokumente zyrtare

Falsifikimi i dokumenteve, rrezikon administrimin e drejtë dhe administratën publike të një shteti. Andaj, është paraparë vepra penale me titull falsifikimi i dokumenteve. Funksionimi normal dhe i ligjshëm i detyrës zyrtare, presupozon nxjerrjen dhe përdorimin e dokumenteve të cilat janë të vërteta për nga përmbajtja dhe origjina e tyre. I tërë qarkullimi juridik, realizimi i të drejtave qytetare, pastaj përmbushja e detyrimeve

qytetare dhe organeve të tjera administrative të shtetit, bazohen në besimin e vërtetësisë së dokumenteve, regjistrave të tjerë dhe shkresave të ndryshme zyrtare.

Kjo vije si pasojë nga fakti se nxjerrja apo përdorimi i dokumenteve të falsifikuara është punë e rrezikshme dhe shkakton pasoja të dëmshme, jo vetëm për qytetarin por edhe për shoqërinë në tërësi. Ky është shkaku i vetëm, madje edhe kryesor që falsifikimi i dokumenteve zyrtare parashihet si veprë penale në të gjitha legjislacionet penale, të shteteve me rregullim juridik bashkëkohor.

Dallimi midis veprës penale të paraparë me nenin 398 dhe të veprës penale të paraparë me nenin 434, qëndron në faktin se këtë veprë penale mund ta kryej vetëm personi zyrtar, ndërsa veprën penale të paraparë në nenin 398, mund ta kryej çdo person. Përkundër faktit se me veprën penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar, rrezikohet administrimi normal i drejtësisë dhe administratës, këtu edhe më tepër rrezikohet funksionimi normal dhe i ligjshëm i detyrës zyrtare. Njihen dy lloje të falsifikimit të dokumentit zyrtar, falsifikimi material dhe ai intelektual (Salihu, E Drejta Penale, 2014, fv. 636-637).

Falsifikimi material, ekziston kur dokumenti është i rrejshëm sipas origjinës, përkatësisht në rastet kur në dokument është theksuar personi i cili nuk e ka lëshuar atë dokument, apo ku nuk e ka lëshuar me përmbajtje të tillë. Vepra të tilla penale në Kosovë, me specifika të veçanta pas vitit 1999, duke filluar nga dokumentet e identifikimet e deri tek falsifikimi i dokumenteve zyrtare –materiale ku kemi të bëjmë me pronësi të luajtshme dhe të paluajtshme.

Sa i përket falsifikimit intelektual, ekziston në rastet kur dokumenti nuk është i rrejshëm sipas origjinës, përkatësisht kur dokumentin e ka lëshuar personi i cili e ka lëshuar në dokument, mirëpo në përmbajtje të tij ka shënuar përmbajtje të pavërtetë, apo kur nuk ka shënuar të dhëna të cilat janë relevante për të shërbyer si prova. Andaj, personi zyrtar i cili është i dedikuar të lëshoj forma të tilla të dokumenteve zyrtare, është obligues që të lëshoj një dokument të tillë ndaj palës që ka parashtruar kërkesë, por bie në kundërshtim me ligjin saktësisht, kur mbush kriteret e kësaj vepre penale, atëherë kur ndryshon përmbajtjen e dokumentit zyrtarë, ose kur një dokument i tillë ka përmbajtje të rrejshme.

Dokumenti zyrtar është lloj i dokumentit, për deri sa nocioni i përgjithshëm i dokumentit ose përkufizimin e tij e gjejmë në nenin 120, paragrafi 8, ku me shprehjen dokument nënkuptohet çdo send i përshtatshëm ose i caktuar që shërben si provë e ndonjë fakti përkatës për marrëdhënie juridike. Rastet më të shpeshta janë dokumentet e lëshuara nga personat fizik dhe juridik.

Nuk mund të përjashtohen edhe gjësendet e natyrës materiale të cilat mund të jenë të përshtatshme për të shërbyer si prova për ndonjë rrethanë juridike relevante. Shembuj të tillë mund ti hasim kur si prova mund të konsiderohen numri i fabrikës së ndonjë automjeti specifik si numri i motorit, shasisë, targa e regjistruar në automjet, rrethoja me anë të gurëve që specifikon përkufizim e arës bujqësore.

Këta shembuj janë për të sqaruar se dokumenti mund të shërbejë për të konstatuar ndonjë rrethanë juridike relevante. Klasifikimi i ndryshëm i dokumenteve bëhet në teori, por në fakt klasifikimi apo dallimi më i rëndësishëm është ai me dokumente private dhe zyrtare.

5. 7. Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme

Personi zyrtar i cili arkëton nga tjetri diçka që personi i tillë nuk është i detyruar të paguaj ose arkëton më shumë se që personi i tillë është i detyruar të paguaj, ose argëton më shumë se që personi i tillë është i detyruar të paguaj apo që gjatë pagesës ose dërgesës ose paguan ose dërgon më pak se që i është dashur, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. (Salihu I, E Drejta Penale, 2014, f. 682)

Nëse vlera e pagesës apo e dërgesës nga paragrafi 1 i këtij neni, tejkalon shumën prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me burgim deri në tre(3) vite.

Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni është e dënueshme. Vepra paraqitet si një formë e mashtrimit dhe e keqpërdorimit financiar, kur nuk ekziston asnjë qëllim përfitimi të kundërligjshëm ose ndonjë qëllim tjetër që është element i veprës, megjithatë meqenëse, me këtë vepër penale dëmtohet pasuria e tjetrit, qëllim i këtij inkriminimi është mbrojtja e këtyre të drejtave të njerëzve. Si dhe nevoja që personi zyrtarë, me rastin e kryerjes së veprimeve dhe detyrave të këtyre zyrtare, të ju përmbahet rregullave financiare dhe rregullave të shërbimit të sjelljes, në kufijtë e

asaj që i lejohej të arkëtoj, të paguaj apo të dorëzoj. Pa dashur të interpretoj, në këtë ligj përmendet, mbrojtja e të drejtave të njerëzve, e me këtë pa një përshkrim të ndonjë rasti e që janë të shumtë në Kosovë, të drejtat dhe liritë njerëzore shkelen vetëm nga shteti, përkatësisht nga mekanizmat shtetëror.

Bie në kundërshtim me ligjin dhe kryen veprën penale, personi zyrtarë apo personi përgjegjës i cili me qëllim apo pa qëllim arkëton nga dikush diçka, që ai nuk është i detyruar ti paguaj, ose arkëton më tepër se sa që është i detyruar të paguaj, ose me rastin e dorëzimit të arkëtimit, arkëton më pak ose dorëzon më pak.

Institucionet publike në shoqërinë kosovare të pas luftës, pa ndonjë standard, arkëtojnë fatura në emër të paushallit në shuma parash duke e ngarkuar konsumatorin me mbingarkesë financiare për të cilën nuk ka shpenzuar. Këtu mund të specifikojmë situata të shumta të shërbimeve publike, me produkte dhe shërbime elementare apo jetësore e që janë shumë të nevojshme siç janë rryma, uji, bërlloku, etj. Për kundër faktit të mos ofrimit të denjë të shërbimeve nga kompanitë publike, konsumatori në emër të pronës që posedon, arkëtohet me fatura pa ofruar shërbimin paraprak.

Sipas veprimit të kryerjes, vepra penale paraqitet në dy forma:

1. Arkëtimi i kundërligjshëm dhe
2. Pagesa e kundërligjshme.

Në rastin e parë, personi zyrtar apo përgjegjës, arkëton nga dikush diçka që ai nuk është i detyruar ose arkëton më tepër se sa që ky kishte borxh, edhe pse është i vetëdijshëm se detyrimi për pagesë nuk ekziston ose që nuk ekziston në shumën e kërkuar. Për ekzistimin e veprës nuk është me rëndësi fakti nëse ka qenë i vetëdijshëm apo jo personi ndaj të cilit kryhet arkëtimi, se kur paguan diçka që nuk do të duhej, të paguante apo paguan më tepër se sa që janë detyrimet e tij reale, përkatësisht se po paguan më pak. Kryerësi i veprës penale mund të jetë vetëm personi zyrtarë a personi përgjegjës, në fushëveprimin e punës së të cilit bëjnë pjesë punët e arkëtimit dhe pagesës.

Forma e fajit-vepra penale kryhet me dashje. Për ekzistimin e veprës penale, nuk është i nevojshëm një qëllim i veçantë për të cilin kryhet arkëtimi apo pagesa, por nga vetë natyra e veprës, rezulton që kjo vepër penale ekziston vetëm në kushtet që arkëtimi i

tërësishëm i pa detyruar apo mos pagesa, të jenë regjistruar në mënyrë të rregullt për institucionin. Për ekzistimin e veprës penale është e parëndësishme nëse ka ekzistuar apo jo te personi i dëmtuar vetëdijja se i është arkëtuar diçka e paligjshme, apo se i është shkurtuar pagesa.

Ligji shkon edhe më tutje, duke e detajuar situatën në arsyetime eventuale nga palët para gjykatës, se pranimi eventual i dikujt, që t'i paguhet më pak se sa i takon realisht, nuk përjashton kundërligjshmërinë e kësaj vepre, përkatësisht ekzistimin e saj. Për ekzistimin e veprës penale, është e nevojshme që sendi të jetë marrë me rastin e kryerjes së veprimeve të ligjshme nga personi zyrtarë, që paraqet element themelor të kësaj vepre penale në bazë të së cilës ai është radhitur në këtë grup të veprave.

5. 8. Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor

Personi zyrtarë, i cili gjatë bastisjes së lokaleve, personit apo gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor, merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, për vete ose personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë(6) muaj deri në pesë (5)vite. Kryerës i veprës penale, mund të jetë vetëm personi zyrtarë. Sipas ligjit, veprën e kryen personi zyrtar i cili me rastin e kontrollimit të banesës, lokaleve apo personit, ose me rastin e zbatimit të përmbarimit, merr sendin e luajtshëm me qëllim që, me përvetësimin e tij, t'i sjellë vetës apo tjetrit përfitim të kundërligjshëm.

Këtu kemi të bëjmë me vjedhjen në detyrë, në kryerjen e punëve zyrtare, duke e keqpërdorur pozitën zyrtare ngase këtu nuk bëhet fjalë për sendet që i janë besuar personit zyrtarë. Në shumicën e rasteve në Republikën e Kosovës, si shembull konkret merret polici, zakonisht me rastin e legjitimitetit të personit, kontrollimit, bastisjes së pronave etj, mirëpo, ligji e përgjithëson termin person zyrtarë, e që nuk nënkupton domosdo vetëm policin si person zyrtar.

Me rastet e përmbarimit, konfiskimit të pasurisë së luajtshme, sendeve të madhësive të ndryshme, kemi situata kur angazhohen edhe kompani kontraktuese në shërbim të institucionit përkatës për konfiskimin e sendit në fjalë.

Vepra penale kryhet me marrjen e sendit të luajtshëm, ndërsa tentativa e veprës penale është e dënueshme dhe ekziston kur marrja ka filluar, mirëpo, sendi nuk konsiderohet akoma i marrë, përkatësisht kryerësi nuk ka siguruar pushtetin mbi sendin.

Vepra penale mundet të kryhet vetëm me dashje direkte, është vështirë të mendohet se është krijuar nga pakujdesia apo rastësish. Sidoqoftë, situatat në rrethana të jashtëzakonshme të ilustruara me shembuj konkret, nuk përjashtojnë mundësinë kur personi i autorizuar pa vetëdije dhe pa dashje, duke mos pasur fare qëllim merr gjësendin e luajtshëm. Kryerësi i veprës penale, mund të jetë vetëm personi zyrtar.

5. 9. Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare

Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk e bënë një gjë të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vite. Vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni, konsiderohet se është kryer kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit për paraqitjen e deklaratës.

Tutje vepra penale lidhur me mos raportimin ose raportimin e rremë të pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, gjithashtu parashikon që:

- Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë(6) muaj deri në pesë(5) vite.
- Vlera e padeklaruar e pasurisë të të ardhurave ose të dobisë tjetër pasurore, e cila është fituar në mënyrë jo ligjore, konfiskohet. Nuk ka asnjë dyshim se këtu kemi të bëjmë për një sanksionim të ri, i cili nuk ishte i parashikuar me Kodin Penal të vjetër të Kosovës. Me këtë ligj, është parashikuar detyrimi i zyrtarëve të lartë publik, për deklarimin e pasurisë, dhuratat dhe prejardhjen e tyre.

Ky nen rregullon kontrollin publik të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, të hyrave dhe përfitimeve të tjera materiale, detyrimeve financiare nga zyrtarët publik, anëtarët e

familjes dhe personat e lidhur me ta, duke përfshirë sanksionet e përcaktuara me këtë ligj.

Sipas nenit 4, të ligjit përkatës, “zyrtari i lartë publik, përfshinë”:

- kryetarin e Kosovës dhe të gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar nga kryetari;
- deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- kryeministrin;
- zëvendëskryeministrin;
- Ministrat dhe zëvendësministrat, në qeverinë e Kosovës, si dhe të gjithë të emëruarit nga ta: udhëheqësit e sekretarive dhe zyra të tjera të Kryetarit të Kosovës, Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës;
- sekretarin e përhershëm të zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, sekretarin e përhershëm të Kuvendit, sekretarin e përhershëm të Kryeministrit, sekretarin e përhershëm të Ministrive, drejtorët e departamenteve dhe pozitat e barasvlershme;
- gjykatësit dhe Prokurorët;
- Drejtorët dhe anëtarët e Bordit të kompanisë publike;
- Personat e akredituar jashtë vendit, si përfaqësues të Kosovës;
- Udhëheqësit e agjencive, drejtorive, dhe institucioneve të tjera të nivelit qendror, të themeluar me ligj ose me ndonjë akt tjetër;
- Kryetarin dhe nënkryetarët e komunave, kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit e kuvendeve komunale;
- Drejtorin e administratës dhe personelit të kuvendeve komunale;
- Auditorët e përgjithshëm dhe inspektorët e nivelit qendror, guvernatorin dhe zëvendës guvernatorin e Bankës Qendrore;
- Udhëheqësit e Bankave dhe institucioneve financiare me kapital publik;
- Rektorin, prorektorët, dekanët dhe prodekanët e universitetit publik dhe sekretarin e tij, si dhe sekretarët e njësive akademike dhe organizatave të universitetit publik;

- Të gjithë drejtorët dhe anëtarët e bordeve e të shoqërive aksionare me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror dhe publik me shumë se 50% (shembull Telekomi i Kosovës);
- Zyrtarët e lartë që kryejnë funksione publike në strukturat e rendit, sigurisë dhe shërbimit doganor, si komandantin, zëvendës komandantin e FSK-së, drejtorin dhe zëvendës drejtorin e Policisë së Kosovës, Drejtorin dhe zëvendës drejtorin e Doganës së Kosovës, Drejtorin dhe zëvendës drejtorin e Agjencisë së Inteligjencës, “anëtarët e familjes”- bashkëshortin dhe fëmijët e zyrtarit publik.(ref. Ligji 1276).

Këtë vepër penale, mund ta kryejnë vetëm ata persona të cilët sipas ligjit të cituar më lartë, kanë detyrim ligjorë, që çdo vit të paraqesin me kohë dhe me saktësi, pasurinë që kanë realizuar si bartës të funksioneve të ndryshme sipas ligjit.

Këtu sa i përket anës subjektive, vepra penale mundet të kryhet vetëm me dashje drejtpërsëdrejti, që përfshinë dijen e kryerësit se ai ka detyrim të deklaroj pasurinë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, por nuk dëshiron ta bëjë atë, dije e tij se ai nuk po i jep të gjitha të dhënat e nevojshme. Do me thënë, kjo vepër penale konsumohet, vetëm atëherë kur vërtetohet se kryerësi nuk i ka përmbushur me dashje detyrimet ligjore për deklarimin e pasurisë, i ka falsifikuar qëllimisht të dhënat e paraqitura, përkatësisht nuk i ka paraqitur të dhënat e nevojshme.

Deklarimin e pasurisë, sipas ligjit janë të obligueshëm ti përmbahen të gjithë zyrtarët të cilët u specifikuan më sipër dhe këtë deklaram të pasurisë e bëjnë në Agjencinë Kundër Korrupsionit të Kosovës. Në të kundërtën, në rast se një zyrtarë me qëllim apo pa qëllim, anashkalon afatin ligjor të pasurisë, atëherë e tëra që mund të pasoj është një padi dërguar organeve kompetente (prokurorisë apo gjyqësisë) nga Agjencia Kundër Korrupsionit.

Nga ajo që kemi parë deri me tani, ka ngecje shumë të madhe në zbatimin e ligjit lidhur me deklarimin e pasurisë, e që vjen si pasojë e procedurave të ngadalshme, shpërfilljes që i bëhet Agjencisë Kundër Korrupsionit, përkundër faktit që mos deklarimi i pasurisë nga ana e këtyre zyrtarëve, bëhet publik nga ana e Agjencisë të Kundër Korrupsionit, dhe duke pasur parasysh vonesat në kohë, të shqyrtimit të lëndëve nga ana e gjyqësorit,

vetëti lind pyetja, a do të duhej të pritët në vendime të gjyqësorit apo të mirën masa administrative në kuadër të institucionit përkatës, ku vepron zyrtari i cili nuk ka deklaruar pasurinë në përputhje me kërkesat ligjore.

5. 10. Mekanizmat institucional për luftimin e korrupsionit

Përvoja nga shumë shtete të tjera dëshmon se suksesi në luftën kundër keqpërdorimit të detyrës zyrtare, kërkon aktivizimin e një spektri të gjerë të institucioneve dhe spektër të gjërë të veprimeve në fushën e legjislacionit, edukimit, monitorimit, hetimit dhe prokurorisë. Të gjitha këto normalisht bien në kuadër të përgjegjësisë të natyrshme të autoriteteve të ndryshme institucionale të shtetit, përfshirë edhe agjencitë.

Roli qendror në shumicën e këtyre çështjeve performohet nga shumica e institucioneve jo të specializuara, duke kryer edhe detyrat kundër korrupsionit, përveç detyrave të tjera, si një ministri e financave për aspektet kundër mashtrimit; një ministri e administratës publike për etikën e shërbimit civil; një ministri e drejtësisë për masa penale; si dhe policia për të hetuar rastet e korrupsionit.

Në vitin 2004 ishte deklaruar një angazhim anti-korrupsion nga ana e kreut të UNMIK-ut (Jansens, 2015, f. 215). Kuvendi i Kosovës në të njëjtin vit ka aprovuar Ligjin Kundër Korrupsionit. Ligji parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të strategjisë kundër korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve administrative të korrupsionit publik, eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, papajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar. Megjithatë, këtu duhet përmendur faktin së pas miratimit të ligjit, u nevojitën 3 vite për të funksionalizuar dhe bërë të mundshme punën e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Gjithashtu me ligjin në fjalë parashihen dhe definojnë shumë saktë, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e punëve në detyrë, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta, si dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publikë duke kryer biznes me operatorë ekonomik, ku personi zyrtari ose një person në marrëdhënie të afërt me të është i përfshirë.

Ligji ka bazë të mjaftueshme me të cilin pengon edhe veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare të shkaktuara nga presioni hierarkik brenda një organizate. Në këtë drejtim neni 3.2 i ligjit specifikon:

“Personi zyrtari nga i cili eprori i tij kërkon që gjatë kryerjes së shërbimit të tij të veprojë në mënyrë të paligjshme, të pandershme dhe jo lojale ndaj autoritetit publik, apo që t’i japë një privilegj një personi fizik apo juridik, duhet të informojë eprorin e tij drejtpërdrejt me shkrim, nëse eprori drejtpërdrejt pas kundërshtimit me gojë përsëri këmbëngul në kërkesat e përmendura më lart.”

Në Kosovë, ka hyrë në fuqi gjatë vitit 2007, edhe një ligj tjetër, ky është Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike. Përgjegjësia për zbatim i është caktuar Agjencisë Kundër Korrupsionit, roli i së cilës në monitorimin e situatave të cënueshme të konfliktit aktualisht është pjesa kyçe e aktiviteteve të punës së këtij institucioni.

Situatat e monitoruara kryesisht janë dy llojesh: ato që kanë të bëjnë me pozitat e papajtueshme (pozitat shtesë në sektorin publik dhe të tjerat në biznesin privat); si dhe të tjerat lidhur me situatën trashëguar nga zyrtari (pronësi ose aksione të rëndësishme në kompani).

Përndryshe, bazat e funksionimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës janë përcaktuar në kapitullin VII të Kushtetutës me emërtimin “Sistemi i drejtësisë” (nenet 102 deri 111). Neni 102(1) (3) i Kushtetutës parasheh se pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat, të cilat gjykojnë vetëm në bazë të Kushtetutës dhe ligjit. Gjykatat përbëjnë pushtet të ndarë dhe janë të pavarura prej shtyllave të tjera të pushtetit. Ligji për gjykatat tekstualisht në përmbajtjen e tij, e ka paraparë reformimin e sistemit gjyqësor, i cili duhet të pasoj në ndërkohë.

Duke filluar nga viti 2013, gjykatat në Kosovë kanë një strukturë të re, që përfshinë Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatat Themelore. Gjykata të specializuara mund të themelohen me ligj, kur kjo të jetë e nevojshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të themelohen gjykata të jashtëzakonshme (neni 103.7 i Kushtetutës). Procedurat

gjyqësore përfshijnë se paku dy shkallë. Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e sistemit gjyqësor.

Institucionet e Republikës së Kosovës kanë miratuar infrastrukturë ligjore të cilat promovojnë krijimin e një klime etike po ashtu, përfshirë këtu veç tjerash edhe Kode të mirësjelljes. Nga Institucionet përkatëse kërkohet që të gjithë stafit të tyre, ti sqarohet kriteri që shpie deri te respektimi dhe zbatimi i parimeve dhe rregullave e Kodeve të mirësjelljes gjatë ushtrimit të veprimtarive dhe funksioneve të tyre, respektivisht në mënyrë më të përmbledhur gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare.

Në raste shkelje të rregullave të parapara me kod të mirësjelljes për çdo punonjës në Institucione do të filloi procedura disiplinore për çdo shkelje që do të rezultojë në masa disiplinore edhe shkëputjen e marrëdhënies së punës. Po kështu, edhe sipas nenit 70 paragrafi 1. 4. 1 të Ligjit Nr. 03/l-212, pra Ligji i punës ka përcaktuar se institucionet, në këtë rast punëdhënësi, mund t’ia ndërpresë kontratën e punës në rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit po kështu duke ju referuar po këtij neni paragrafit 1. 6. 1 kur është fajtor për përsëritjen e një sjelljeje të keqe më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve.

Megjithatë, duhet pranuar si dhe analizuar shkaqet mbi faktin se Republika e Kosovës vazhdon të mbetet ndër vendet më të korruptuara në Evropë, por edhe në përgjithësi në shkallë botërore, e padyshim kryeson sa i përket vendeve të rajonit. Kosova rangohet si vend me nivel shumë të lartë të korrupsionit nga indikatorë ndërkombëtar duke përfshirë këtu edhe “Corruption Perception Index” nga Transparency International, dhe raportet tjera siç është Raporti i Këshillit të Evropës i cili vlerëson progresin/regresin e rrugës Evropiane të Kosovës. (KE, 2015)

Sipas raportit të fundit të organizatës “Transparency International”, e cila publikon indeksin e korrupsionit pothuaj për të gjitha vendet e botës, Kosova renditet në vendin e 110 në listën e shteteve më të korruptuara nga totali prej gjithsejtë 174 vendeve të cilat janë pjesë e analizës nga organizata e sipërpërmendur (Balkan Insight, 2014). Krahasuar me vendet e tjera të rajonit, Kosova mban pozitë më të avancuar vetëm ndaj Shqipërisë, e cila renditet në vendin e 116-të (Transparency International, 2014).

Renditja e tillë e Kosovës nuk është një rastësi për vitin 2014, si dhe nuk mund të konsiderohet se ky vit dallohet me shumë nga vitet e tjera përgjithësisht. Në vitin 2011, në të njëjtin raport të lëshuar nga organizata në fjalë, në një analizë të bërë në mesin e 183 vendeve, Kosova edhe atëherë renditej keq, duke qenë e pozicionuar e 112-ta në listë. (Frederic, Dilip, & Heyer, 2015, f. 193)

Luftimi i korrupsionit në Kosovë ndër vite po bëhet vetëm me retorikë dhe me veprime joserioze, duke u krijuar mekanizma të ndryshëm kundër kësaj dukurie, por pa asnjë rezultat. Mekanizmi i fundit i krijuar për luftën kundër korrupsionit është iniciuar nga vetë Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, mekanizëm ky institucional për mbikëqyrje i quajtur si “Këshilli Kundër Korrupsionit”.

Ana kryesore pozitive e këtij këshilli është se ai mund të rris bashkëpunimin dhe koordinimin mes institucioneve përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit. Për më tepër, organizatat e shoqërisë civile ftohen të marrin pjesë në takime dhe këshilli është një forum i rëndësishëm për të diskutuar pengesat dhe sfidat në luftën kundër korrupsionit. Por dobësia kryesore e këtij institucioni është se i mungon kapaciteti veprues dhe deri tani më shumë ka qenë si një tryezë e kthyer vetëm në një forum diskutimesh pa konkretizim. (Capussela, 2015, f. 128)

Ky këshill i cili është krijuar që nga shkurti i vitit 2012, e për të cilin është pretenduar të jetë një kulm mbikëqyrës apo dhe koordinues për të gjithë mekanizmat e tjerë në shtet të cilët luftojnë korrupsionin, nuk ka dhënë ndonjë rezultat i cili si i tillë mund të shpaloset në këtë studim, përveç që ka mbajtur disa takime, ku janë dhënë deklarata prononcuese për media, por që në fakt rezultati i këtyre takimeve dhe aktiviteteve të këshillit në fjalë është gati pa ndonjë ndikim në luftimin e përgjithshëm institucional të Kosovës kundër korrupsionit, e në rastin konkret edhe kundër veprave penale kundër detyrës zyrtare.

Luftimi i korrupsionit në Kosovë është si një prioritet absolut i shpallur nga të gjitha institucionet publike të shtetit, që kanë për mandat parandalimin dhe luftimin e korrupsionit e ku përfshihet edhe kategoria e veprave penale kundër detyrës zyrtare. Megjithatë, vazhdimisht mungojnë rezultatet konkrete, sidomos në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë. Vetë Këshilli Prokurorial i Kosovës, më 4 nëntor 2013,

ka miratuar Planin e veprimit për efikasitetin e sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit. (Prokurori i Shtetit, 2014).

Në Kosovë vepron edhe Agjencia Kundër Korrupsionit. Kjo Agjenci është krijuar në vitin 2007 si një institucion i pavarur për të verifikuar dhe raportuar mbi pasurinë e deklaruar të zyrtarëve shtetërorë dhe për konflikt të interesit, vazhdon të jetë nën kritika të vazhdueshme nga ana e institucioneve shtetërore dhe nga partitë politike. Por edhe për tërë këto vite të punës, kjo agjenci nuk ka arritur që të bëjë kallëzim penal për të ashtuquajturit “peshqit e mëdhenj”. Për këtë arsye kjo agjenci është kritikuar nga mediet, analistët dhe shoqëria civile për mos efikasitet. Gjithashtu nga disa këndvështrime konsiderohet që institucionet politike të vendit nuk kanë qenë shumë të vendosura për të mbështetur Agjencinë Kundër Korrupsionit, në kuadër të asaj që në të shumtën e rasteve njohët si mbështetje politike e nevojshme. (Zaum & Cheng, 2012, f. 20)

Mandati AKK-së për të verifikuar pasurinë e deklaruar nga zyrtarët e shtetit ka mbetur jo edhe aq autoritativ, ngase është vazhdimisht duke u shpërfillur, pa kompetenca të mjaftueshme dhe të thella hetimore, shpesh duke dhënë rezultate të kufizuara në luftë kundër korrupsionit. Kjo tregohet edhe nga të dhënat statistikore të dhëna nga vet Agjencia. Nga numri i përgjithshëm i rasteve për periudhën prej 2008 deri 2012 të raportuara nga AKK që janë dërguar prokurorëve të Kosovës dhe Policisë, vetëm 9.39% të këtyre rasteve përfunduan me aktakuza të ngritura nga ana e Prokurorisë.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës është themeluar me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (Ligji nr 03/L-052), ligj ky i miratuar në Kuvendin e Kosovës në mars 2008, si një nga ligjet në Pakon e Propozimit gjithëpërfshirës të ndërmjetësuesit finlandez Marti Ahtisaarit, me qëllim që t’i ofrojë Kosovës institucionet e nevojshme për "pavarësi të mbikëqyrur". PSRK-ja u bë funksionale me 9 dhjetor 2008 si një "zyrë e përhershme dhe e specializuara e prokurorisë që vepron në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Shtetit në Kosovë".

Ligji i Prokurorisë Speciale të Kosovës është hartuar nën udhëheqjen e administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë gjatë vitit 2007 në mënyrë që të përmbushë nevojat e Kosovës për të luftuar krimin e organizuar, pastrimin e parave, terrorizmin, krimet

ekonomike dhe krimet e luftës. Gjë që vjen si rezultat i faktit se prokuroritë e deriatëhershme vështirë i trajtonin rastet e rënda të kriminalitetit.

Misioni i UNMIK-ut ishte i vetëdijshëm për rolin e tij te zvogëluar pasi që institucionet e Kosovës shpallen pavarësinë e vendit në vitin 2008, kishin për qëllim krijimin e Prokurorisë Speciale, si dhe për të siguruar transferimin e rasteve të pazgjidhura të UNMIK-ut në misionin e ri te ardhshëm për sundimin e ligjit EULEX.

Që nga themelimi i saj, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, u përqendrua kryesisht në çështjet e krimeve të luftës, por në vitet e fundit PSRK-ja i ka kushtuar gjithnjë e më shumë vëmendje rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Megjithatë, rezultatet kanë qenë të kufizuara me një normë prej përafërsisht 26 % të dënimeve për rastet e ngarkuara nga Prokuroria Speciale në vitin 2012.

Deri në shkurt 2010, Prokuroria Speciale ka operuar me një mesatare prej gjashtë prokurorëve special të EULEX-it, si dhe gjashtë prokurorë special vendor. Pas shkurtit të vitit 2010, janë emëruar dhjetë prokurorë tjerë special vendor si dhe një nënkryetar siç parashihet në Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Deri në qershor 2011, Prokuroria Speciale përbëhej nga 11 prokurorë ndërkombëtarë, dhjetë prokurorë vendorë të Kosovës dhe nga një numër i personelit ndihmës, përfshirë këtu edhe staf të ekspertëve financiarë në kuadër të të ashtuquajturës “Task Force” kundër korrupsionit.

Vetë kreu institucional i “Task Forcës”, nën akuzat për vepra penale korruptive me qëllim të mbulimit të disa rasteve tjera korruptive, ishte arrestuar me 2012 për shkak të mitëmarrjes (Frederic, Dilip, & Heyer, 2015, f. 194). Sa i përket punës së cilësuar të dobët të “Task Forcës” kësaj i referohet edhe Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2014, ku nxjerrët në pah efikasiteti i dobët i këtij mekanizmi institucional të përbërë nga zyrtarë të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë për të proceduar tutje rezultatet e hetimeve dhe të gjeturave në Prokurorinë Speciale të Kosovës. (European Commission, 2014, f. 16)

Ndër sfidat kryesore të Prokurorisë Speciale është interesi i ulët i prokurorëve për të aplikuar për pozicionet e lira. Sipas EULEX-it në përgjithësi ka pasur një mungesë të

prokurorëve kompetent dhe një rënie në cilësinë e stafit. Kur Prokuroria Speciale shpalli konkurs për disa vende të lira për prokurorë, me qëllim për të balancuar numrin e personelit vendor me atë të EULEX-it siç është paraparë me ligjin e PSRK-së, askush nuk aplikoi për këto pozita.

Më pas këto pozita të punës, janë mbushur vetëm pasi Prokurori i Shtetit organizoi ekipe mobile në rajone të ndryshme në mënyrë që të rekrutohen dhe të caktohen pozitat për Prokurorinë Speciale. Një vërtetim i përgjithshëm është se prokurorët ndjehen të frikësuar për shkak të ndjeshmërisë së pozitës dhe për shkak të sulmeve të vazhdueshme kundër prokurorëve nga ana e medie, ndërkohë që KPK dhe KGJK kanë bërë pak për të mbrojtur punën e prokurorëve. Një çështje tjetër shqetësuese është edhe rrjedhja e informatave lidhur me hetimet dhe dëshmitë në publik, shqetësim ky me të cilin organet kompetente duhet të merren më aktivisht.

Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Prokuroria e Shtetit, viteve të fundit kanë pasur përplasje të vazhdueshme sa i përket trajtimit dhe hetimit të rasteve. E para është kritikuar nga prokuroria se po sjellë raste me mungesë të informacioneve bazike të dyshimeve për vepra penale kundër detyrës zyrtare, si dhe sipas prokurorisë këto raste vetëm sa po ju humbin kohë gjatë shqyrtimit të lëndëve të ndryshme. Ndërsa Agjencia Kundër Korrupsionit, zakonisht raporton se aktiviteti i tyre është duke ngecur në momentin kur ajo procedohet tutje për shqyrtim në prokurori, sepse sipas tyre rastet po hedhen poshtë nga Prokuroria, kurse në këtë rast nuk po vazhdojnë hetimet dhe rrjedhimisht puna e tyre po u shkon huq.

Nga numri i përgjithshëm i rasteve të përcjella nga Agjencinë Kundër Korrupsionit, nga viti 2007 deri në vitin 2014 në Prokuroritë Kompetente dhe Policinë e Kosovës, prokuroritë dhe institucionet tjera kanë dhënë informacion kthyes duke konfirmuar se 295 raste janë në procedurë hetimore, 47 aktakuza dhe propozim akuza dhe ka filluar procesi gjyqësor, 124 raste është konfirmuar se janë hedhur poshtë/pushuar hetimet, ndërsa për 67 raste të përcjella nuk ka informata kthyes. Një rast është vendosur edhe në Gjykatën e Apelit.

Në fund të këtij nënkapitulli, në vijim paraqitet një listë e plotë e mekanizmave institucional të Kosovës, përveç legjislativit dhe ekzekutivit, që kanë detyra zyrtare drejt

parandalimit si dhe luftimit të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, respektivisht veprave penale kundër detyrës zyrtare:

- Gjykatat, në të gjitha rrafshet
- Prokuroria, në të gjitha rrafshet
- Prokuroria Speciale
- Task Forca për luftimin e korrupsionit
- Policia e Kosovës
- Inspektorati Policor i Kosovës
- Agjencia Kundër Korrupsionit
- Këshilli Kundër Korrupsionit
- Misioni Ligjor i Unionit Evropian “Eulex”

5. 11. Ndryshimet në legjislacion

Veprat Penale kundër detyrës zyrtare në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës përfshihen brenda kapitulli XXIV, kurse në Kodin e ri Penal të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 2012, përfshihen në kuadër të Kapitullit XXIX. Kodi i ri Penal si duket ka marrë parasysh përvojën e shkurtër institucional të Kosovës të pasluftës, andaj hartuesit e kanë konsideruar të nevojshme përfshirjen në Kod Penal edhe të neneve të reja, respektivisht të specifikimit të veprave penale që nuk ishin të përfshira në kuadër të KPPK.

Ky është një rezultat logjik i një serë anomalish të identifikuara me kohë që s’do mend se kanë ndodhur në institucione apo edhe ndërmarrje publike në Kosovë, por për të cilat nuk kishte sqarim në Kodin Penal, respektivisht nuk mund të trajtoheshin si vepra penale kundër detyrës zyrtare, por në të shumtën e rasteve vetëm konsideroheshin objekt i procedurave të brendshme administrative-disiplinore në kuadër të mekanizmave që kishte në dispozicion institucioni përkatës.

Në këtë drejtim, edhe duhet parë vetë karakterin e përkohshëm të Kodit Penal të aprovuar gjatë kohës së protektoratit ndërkombëtarë në Kosovë, i cili mbetet gjithsesi një dokument zyrtar i domosdoshëm dhe emergjent për kohën, i hyrë në fuqi në një

kohë kur në Kosovë kishte boshllëqe serioze në sistemin politik dhe juridik të vendit si pasojë e rrethanave të mëparshme.

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
	Neni 422 - Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtarë
	Neni 423 - Keqpërdorimi i informatës zyrtare
	Neni 424 - Konflikti i interesit
Neni 340 - Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës	Neni 425 - Përvetësimi në detyrë
Neni 339 - Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit	Neni 426 - Mashtrimi në detyrë
	Neni 427 - Përdorimi i paautorizuar i pasurisë
	Neni 428 - Marrja e ryshfetit
Neni 344 - Dhënia e ryshfetit	Neni 429 - Dhënia e ryshfetit
	Neni 430 - Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj
Neni 345 - Ushtrimi i ndikimit	Neni 431 - Ushtrimi i ndikimit
Neni 346 - Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	Neni 432 - Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore
Neni 347 - Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	Neni 433 - Zbulimi i fshehtësisë zyrtare
Neni 348 - Falsifikimi i dokumenteve zyrtare	Neni 434 - Falsifikimi i dokumenteve zyrtare
Neni 349 - Arkëtimi dhe pagesa e paligjshme	Neni 435 - Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme
Neni 350 - Lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria	
Neni 351 - Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësorë	Neni 436 - Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor
	Neni 437 – Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare

Tabela 3: Pasqyrë e dallimeve ndërmjet Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe Kodi të ri Penal të Republikës së Kosovës sa i përket veprave penale kundër detyrës zyrtare (UNMIK/Rreg/2003/25) (Kodi Penal i Republikës së Kosovës)

Ndërkaq në anën tjetër mungonte tradita e një sistemi të mirëfilltë gjyqësor, duke pasur parasysh që pas vitit 1990 në Kosovë, sistemi i drejtësisë ishte kryekëput në shërbim të regjimit serb, kurse edhe para vitit 1990 kur efektivisht ende funksiononte autonomia e Kosovës dhe praktikisht Kosova kishte një sistem të saj të drejtësisë, në fuqi ishte legjislacioni i cili ishte hartuar sipas frymës së asaj kohe dhe rrethanave që impononte në sistem politik monist.

Kodi i Përkohshëm Penal përmbante katërmëdhjetë nene që specifikonin veprat penale kundër detyrës zyrtare, kurse Kodi i ri Penal, përmban gjashtëmbëdhjetë nene të kësaj natyre. Në vijim paraqitet lista me të gjitha nenet ku specifikohen veprat penale kundër detyrës zyrtare sipas Kodit Penal të vjetër dhe atij të ri, ku siç vërehet edhe aty ku neni ka të njëjtin funksion, ka disa ndryshime në emërtimin e veprës penale por që nuk ndryshojnë shumë në funksionalitetin e nenet.

Pra nga tabela e mësipërme e paraqitur, shihet që shumica e neneve në kuadër të kodeve penale lidhur me veprat penale kundër detyrës zyrtare kanë të ndryshuar pozicionin numerik (radhitjen) gjatë hyrjes në fuqi të Kodit Penal të ri, për shkak se Kodi Penal i Republikës së Kosovës, si Kod Penal i hyrë në fuqi me 2012, ka përgjithësisht një përmbajtje më të gjerë edhe sa i përket veprave penale të kategorive tjera në kuadër të kapitujve të tjerë.

Për dallim nga Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, në Kodin e ri Penal të Republikës së Kosovës nuk ekziston në mënyrë të specifikuar vepra penale “Lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria” e cila në Kodin Penal të mëparshëm përfshihej sipas nenet 350. Kurse në Kodin e ri Penal të Republikës së Kosovës, ka katër nene me funksion të ri, respektivisht vepra penale të reja të specifikuara. Këto janë nenet 423, 424, 430 dhe 437.

Pasqyra tabelore në vijim, paraqet nenet me funksion të njëjtë dhe ky ndryshim ka pësuar vetëm numri i nenit në kuadër të Kodit Penal.

KPPK	KPRK
Veprat penale me funksione të njëjta sipas neneve në Kodin Penal	
339	422
340	425
341	426
342	427
343	428
344	429
345	431
346	432
347	433
348	434
349	435
351	437

Tabela 4: Veprat penale me funksione të njëjta sipas neneve në Kodin P

Kapitulli VI

Tregues statistikorë dhe vështrim empirik

6. 1. Vështrim i përgjithshëm

Mbështetur në raporte të shumta nga Institucionet, Agjencitë apo Organizatat e ndryshme joqeveritare, të cilat veprojnë në Kosovë, treguesit statistikorë vërtetë konfirmojnë se rastet e korrupsionit në Kosovë, sidomos ato të keqpërdorimeve të detyrës zyrtare, kanë një prani të madhe. Në rastin e Kosovës, fakti që vendi nuk posedon edhe me aq resurse natyrore dhe përgjithësisht të ardhura të tjera (shembull nga turizmi, degë industriale të ndryshme, prodhimtaria apo eksporti i produkteve vendore), aferat korruptive përqendrohen në administratë publike si dhe përgjithësisht në sektorin publik (Zaum & Cheng, 2012, f. 6).

Aq më tepër përqendrimi i korrupsionit vetëm në kuadër të atij “zyrtar” është një rrezik shtesë vetvetiu, jo rastësisht, korrupsioni si dukuri, kurse kjo vlen edhe për Kosovë, nga shumë studiues konsiderohet si kërcënimi më i madh për qëndrueshmërinë e institucioneve të vendit e madje gjithashtu për stabilitetin e vetë institucioneve publike, por edhe shtetit (Perritt, 2010, f. 89).

Institucionet e Kosovës gjithsesi kanë qenë efikase në hartimin dhe miratimin e legjislacionit përkatës, gjithashtu ky efikasitet është shprehur edhe në hartimin e politikave dhe strategjive të reja, megjithatë janë treguar të dobëta në realizimin efikas dhe të paanshëm të kërkesave të tilla. Një krahasim i shkurtër flet se ka hapësirë për të përmirësuar bashkëpunimin në mes të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit, por edhe për të konsideruar iniciativat e saj të fundit, andaj duke shikuar nëse ky bashkëpunim dhe iniciativë ka qenë deri tani në përputhje me kërkesat e caktuara të imponuara nga aferat korruptive.

Përndryshe duhet cekur përgjithësisht te autor të huaj të ndryshëm, të cilët i kushtojnë vëmendjen periudhës kur në Kosovë ishte në krye të hierarkisë së pushtetit administrata ndërkombëtare e misionit të UNMIKU-t, e cila ishte ajo që kishte në dorë të saj “çelësat” e udhëheqjes me organe të rendit dhe drejtësisë, mbretëron në të shumtën e

rasteve mendimi se kjo administratë ka dështuar në detyrat e saj drejt krijimit të një rendi ligjorë (Jansens, 2015, fv. 200-201).

Në anën tjetër, duket se që nga paslufta, te qytetarët ka një perceptim se korrupsioni, hap rrugë për të “luftuar” për interesa të ngushta apo familjare, kurse këtu në radhë të parë mendohet në korrupsionin në sektorin publik, respektivisht në keqpërdorimin e detyrës zyrtare (Perritt, 2010, f. 250). Gjithashtu edhe statusi i ndërlikuar i Kosovës deri në shpalljen e pavarësisë së vendit, nuk ka stabilizuar mekanizmat përkatës që do të duhej të luftonin korrupsionin zyrtar. (Rotberg, 2009, fv. 83-84)

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, kënaqëshmëria e opinionit publik, pra qytetarëve, me punën e Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit ka qenë në rënie. Ndërsa Policia e Kosovës vazhdimisht gëzon besimin më të lartë të opinionit publik në 6 vitet e fundit (80 % shtator 2008 në 75,1 % prill 2013), Prokuroria e shtetit në anën tjetër, gëzon besim më të ulët, 22.7 % në maj 2008 në 17,7 % prill 2013 (KIPRED, 2014).

Një mospërputhje e tillë e besimit të publikut është reflektuar edhe në përpjekjet për bashkëpunim efikas ndër-institucional, sidomos në fushën e luftimit kundër korrupsionit, respektivisht të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe shkeljeve ligjore të kësaj kategorie

Shkallë e madhe e mosbesimit nga ana e opinionit publik shfaqet edhe kur bëhet fjalë për vetë Gjykatat, në një anketim të zhvilluar nga UNDP gjatë vitit 2013, rreth 17% e qytetarëve respondentë të kësaj ankete, janë përgjigjur se mendojnë që ka korrupsion në Gjykata. (UNODC, 2014)

Korniza ligjore e cila përcaktohet qartë për bashkëpunimin në mes të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë në hetimin e keqpërdorimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, është në masë të madhe mirë e përcaktuar dhe duhet thënë se shume është hollësisht e specifikuar nga Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, por gjithashtu edhe nga Ligji për Policinë i miratuar në Kuvendin e Kosovës. Pra, nuk ka barriera ligjore të përkufizuara jo mirë të cilat mund të jenë shkaktare të niveleve jo të kënaqshme të bashkëveprimit

ndër-institucional në luftën kundër korrupsionit në administratën publike dhe në përgjithësi në sektorin publik.

Megjithatë, problemet ndodhin gjatë bashkëpunimit praktik që shkaktohet nga mungesa e bazës së duhur të të dhënave dhe menaxhimit të dosjeve të rasteve. Por jo vetëm Organizatat Joqeveritare, por edhe vetë raportet e lëshuara nga institucione kompetente në Republikën e Kosovës e konfirmojnë këtë.

6. 2. Aktiviteti i Gjykatave

Në të dhënat e lëshuara nga Këshilli Gjyqësorë i Kosovës në të cilën përfshihet periudha katërvjeçare 2008-2012, rezulton se prej 1457 lëndëve të zgjidhura të rasteve të korrupsionit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, 412 prej tyre kanë të bëjnë ekskluzivisht me marrjen e mitos, si një nga dukuritë më të shpeshtuara në kuadër të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. (Hajdari, 2014)

Por pikërisht këtu dallohet një shpërputhje e madhe gati e pakrahasueshme e lëndëve të zgjidhura dhe atyre të proceduara nga ana e Prokurorisë. Vetë përcjellja e statistikave të saktë në drejtim vjen duke u komplikuar dukshëm edhe si pasojë e faktit se shumë lëndë të proceduara barten nga viti në vit.

Në një analizë të bërë lidhur me keqpërdorimet e detyrës zyrtare që lidhen me punët e tenderëve të shpallur nga institucione publike dhe ku konkurrojnë operator ekonomik kryesisht privat, gjatë periudhës 2008-2013 janë shënuar 288 raste të tilla, në të cilat sipas të dhënave nga Këshilli Gjyqësorë i Kosovës janë gjykuar dhe dënuar 1457 persona të cilët ranë ndesh me ligjin. (Hajdari, 2014)

Mangësi kryesore në fushën e prokurimit publik është mungesa e menaxhimit efektiv të konfliktit të interesit në procesin e dhënies së kontratave publike. Organet e prokurimit publik nuk bashkëpunojnë mirë me njëra tjetrën dhe “pavarësia e zyrtarëve të prokurimit publik duhet të forcohet më tej”.

Aq më tepër, sektori i prokurimit publik vuan nga mangësitë tjera që krijojnë mundësi për korrupsion, siç janë rastet kur institucionet e prokurimit publik dalin me interpretime të ndryshme lidhur me procedurat e prokurimit, prokurimin një-burimor,

mungesën e udhëzimeve dhe rregulloreve mbi atë se si të trajtohen rastet kur kompanitë ofrojnë çmime jorealiste për artikujt në tenderët e tyre, gjë që është shenjë paralajmëruese për para-marrëveshje për dhënien e kontratës.

Disa parregullsi të zakonshme në procesin e prokurimit përfshijnë dokumentacionin e pa rregullt, anulimin e tenderëve pa bazë ligjore, dështimi për të siguruar kushtet teknike në kriteret matëse pa bërë diskriminim, shkelja e kontratës dhe vendosja e kriterëve në ofertë që do ta favorizonin një grup të caktuar apo grup të kompanive. Transparenca më e madhe në procedurat e prokurimit publik, mund të zvogëlojë keqpërdorimet.

Prokurimi publik përbën një të pestën e bruto produktit vendor të Kosovës andaj mu për këtë edhe konsiderohet si një shtytës i rëndësishëm i ekonomisë së Kosovës. Megjithatë, prokurimi publik ballafaqohet me dy probleme madhore: atë të mungesës së transparencës dhe llogaridhënies, duke rrezikuar kështu integritetin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik.

Gjithnjë sipas të njëjtit raport, e që në fakt paraqet raportet më të kompletuara të lëshuar nga ky institucion, për keqpërdorim të detyrës zyrtare janë dënuar 58 gjyqtarë, gjë që paraqet një mesatare relativisht shqetësuese, prej gati 12 gjyqtarëve të dënuar brenda një viti kalendarik.

Gjatë vitit 2010, në kuadër të kategorisë së lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, Këshilli Gjyqësori Kosovës ka pasur gjithsej 138 raste: 109 lëndë për shpërdorim të pozitës zyrtare, 20 për marrje të mitos dhe 9 për dhënie të mitos. Tek kategoria lëndë të pranuar në punë 65, janë 43 për shpërdorim të pozitës zyrtare, 15 për marrje të ryshfetit dhe 7 sosh për dhënie të mitos.

Aktualisht janë 203 lëndë në punë: 152 për shpërdorim të pozitës zyrtare, 35 për marrje të ryshfetit dhe 16 për dhënie të ryshfetit. Gjatë vitit 2010 janë zgjidhur gjithsej 62 lëndë: 38 për shpërdorim të detyrës zyrtare, 17 për marrje të ryshfetit dhe 7 për dhënie të ryshfetit. Ndërkaq, në fund të periudhës raportuese kanë mbetur gjithsej 141 lëndë të pazgjidhura: 114 për shpërdorim të pozitës zyrtare, 18 për marrje të mitos dhe vetëm 9 në kuadër të dhënies së mitos.

Në vitin 2011 në gjykatat komunale ishin 206 lëndë të trashëguara nga periudha raportuese, 132 lëndë janë të pranuar dhe 120 lëndë të zgjidhura. Nga 82 lëndë me aktgjykim gjykues, 14 lëndë kanë përfunduar me dënim me burg, 45 lëndë me dënim me gjobë, 22 lëndë dënim me kusht, 1 lëndë me dënime të tjera. Me aktgjykim lirues janë shqiptuar 6 lëndë, me aktgjykim refuzues 3 dhe 29 në mënyra të tjera. Viti 2011 është përmbyllur me 218 lëndë të pazgjidhura.

Gjykatat e rregullta komunale të Kosovës kanë trashëguar nga vitet paraprake gjithsej 197 lëndë. Po këto gjykata gjatë gjithë vitit 2012 kanë pranuar në punë gjithsej 169 lëndë, ndërkaq si lëndë në punë që janë në proces të shqyrtimit janë gjithsej 366. Gjykatat e rregullta komunale gjatë 2012 kanë zgjidhur gjithsej 148 lëndë. Ndërkaq, në fund të periudhës raportuese, kanë mbetur gjithsej 218 lëndë të pazgjidhura. Kurse gjatë vitit 2013, Gjykatat e Kosovës për veprën penale të korrupsionit marrje e mitos, kanë pasur gjithsej në punë lëndë në të cilat kanë qenë të implikuar 122 persona, ku nga këto lëndë kanë zgjidhur lëndë në të cilat kanë qenë të implikuar vetëm 31 persona ndërsa lëndët ku kanë qenë të implikuar 91 persona kanë mbetur të pazgjidhura në fund të kësaj periudhe. (FOL, 2013)

Kurse, për veprën penale të korrupsionit dhënie e mitos, Gjykatat e Kosovës, gjatë vitit 2013, kanë pasur në punë lëndë në të cilat kanë qenë të implikuar 67 persona, ku lëndë në të cilat kanë qenë të implikuar vetëm 23 persona, janë të zgjidhura, ndërsa lëndët ku kanë qenë të implikuar 44 persona janë të pazgjidhura në fund të vitit 2013. Tutje për veprën penale të korrupsioni keqpërdorim i pozitës zyrtare, Gjykatat e Kosovës kanë pasur në punë gjithsej lëndë në të cilat kanë qenë të implikuar 603 persona gjatë vitit 2013, ku nga këto janë zgjidhur lëndë në të cilat kanë qenë të implikuar vetëm 66 persona ndërsa lëndët ku kanë qenë të implikuar 537 persona, kanë mbetur të pazgjidhura në fund të kësaj periudhe.

Ndërkaq në vitin 2014, Gjykatat e Kosovës kanë pranuar në punë gjithsejtë 982 raste, ndërsa prej tyre janë zgjidhur vetëm 126 raste. Për dhënie të mitos, gjykatat kanë pranuar në punë 66 raste, ndërsa kanë zgjidhur vetëm 25 raste, si dhe për keqpërdorim të pozitës zyrtare, kanë pranuar në punë 790 raste, ndërsa janë zgjidhur gjithsej 194 raste, një numër ky që nuk është shumë inkurajues kur bëhet fjalë për efikasitetin e punës së gjykatave për vepra penale kundër detyrës zyrtare.

Raste të tjera i takojnë veprave të ndryshme penale të tjera të përfshira në kuadër të Kapitullit XXIX të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. (Bota Sot, 2014)

Sipas raportit të fundit të lëshuar nga ana e vetë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, rezulton se vërtetë Gjykatat e Kosovës janë të mbingarkuara me numër enorm të lëndëve të cilat po grumbullohen. Numri i përgjithshëm i lëndëve me të cilat Gjykatat janë të ngarkuara me mbi 700 mijë lëndë vetëm të proceduara gjatë vitit 2014, nga të cilat janë zgjedhur vetëm diç më shumë se 404 mijë, por që mbetet pra i pazgjidhur një numër jashtëzakonisht i madh i lëndëve. (KGJK, 2015, f. 21)

Lidhur me numrin e madh të lëndëve të grumbulluara, një nga arsyetimet sipas deklaratave për media të lëshuara nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është edhe zvarritja e stërzgatur e emërimit të gjyqtarëve nga ana e Presidentes së Kosovës. (Koha Ditore, 2015)

6. 3. Raportimet e Prokurorisë mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare

Kallëzimet penale, për veprat penale kundër detyrës zyrtare, janë të parashikuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në Kapitullin XXIX - Veprat penale kundër detyrës zyrtare. Siç u cek më herët, këto vepra penale në kuadër të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, të sistemuara brenda Kapitullit XXIV.

Prokuroritë Publike të cilat veprojnë në Kosovë, fillimisht vetëm Prokuroritë Komunale dhe Prokuroritë e Qarkut, kurse më vonë sistemit prokurorial të Kosovës i bashkohet edhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, sot të gjitha së bashku i nënshtrohen institucionalisht, si dhe funksionojnë në kuadër të një kulmi institucional si Prokurori e Shtetit. Prokuroritë në Republikën e Kosovës, pra funksionojnë në tre nivele.

Mbështetur në këtë, edhe raportet e reja që lëshohen lidhur me punën e prokurorive, lëshohen nga kreu institucional i tyre, përkatësisht nga Zyra e Prokurorit të Shtetit. Të tilla janë raportet e viteve të fundit. Më parë raporte mbi punën e prokurorive në Kosovë, nuk lëshoheshin nga ky institucion, kurse në shumë raste disa raportime kishin të bënin më shumë me tematikë të lidhur në aspektin më shumë administrativ të brendshëm të aktiviteteve si dhe statistikave bazike mbi stafin.

Raportet e para të rregullta lidhur me punën e Prokurorive Publike në Kosovë, fillojnë me raportimin për të arriturat e vitit 2007. Deri më atëherë, nuk mund të themi se kishte transparencë të mjaftueshme dhe raportime të punës, përfshirë këtu edhe informimin me të dhëna bazike statistikore. Raportet lidhur me punën e prokurorive, janë gjithsesi treguesi më i mirë edhe sa i përket çështjes kryesore e cila është në fokus të këtij studimi, pra lidhur me veprat penale kundër detyrës zyrtare, më konkretisht të kallëzimeve penale të kësaj natyre.

Siç do të shihet edhe nga statistika e prezantuar, numri i lëndëve rreth veprave penale kundër detyrës zyrtare marrë si pjesëmarrje në numrin e përgjithshëm të të gjitha veprave penale, është dukshëm më i vogël nëse e krahasojmë me pjesëmarrjen e pazgjidhshmërisë së këtyre veprave penale në nivel vendi, në krahasim me numrin e përgjithshëm të kallëzimeve të pazgjidhura.

Këtu do të fillohet me analizën e punës së prokurorive lidhur me veprat penale kundër detyrës zyrtare duke filluar me treguesit e vitit 2007, i cili është praktikisht viti i parë kur fillohet me praktikën e raportimeve të rregullta në kuptimin e plotë të fjalës. Gjatë këtij viti, 1,5% e numrit të përgjithshëm të paraqitjeve penale kishin të bënin me vepra penale kundër detyrës zyrtare, respektivisht 395 kallëzime penale të tilla. Numri më i madh i këtyre veprave penale, ka të bëjë me nenin 339 të Kodit Penal, pra me shpërdorimin e pozitës zyrtare dhe autorizimit. Në veprat penale sipas nenin 339 të Kodit Penal, përfshihen 234 raste e që është shumicë absolute e veprave penale kundër detyrës zyrtare, me 59.2%. (PPRK 2007)

Veprat e tjera penale kanë të bëjnë me falsifikimin e dokumentacionit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare me 40 raste, kurse gjithashtu janë të pranishme edhe veprat penale të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare me 39 raste. Numri i tjetër prej 38 rasteve i takon veprave të ndryshme penale kundër detyrës zyrtare. (PPRK 2007)

Në raport me vitin 2007, raportimet e prokurorive mbi punën e zhvilluar gjatë vitit 2008, tregojnë për një rritje të numrit të kallëzimeve për veprat penale kundër detyrës zyrtare. Përderisa me 2007 kishte 395 raste të tilla, me 2008 ky numër ngritët në 503 raste kurse gjithashtu rritet edhe përqindja e veprave penale kundër detyrës zyrtare, përderisa me 2007 ishte 1,5%, me 2008 ishte 2%.

Në vitin 2008 në prokuroritë publike të Kosovës mungojnë të dhënat për rastet e shqyrtuara që ju përkasin veprave penale kundër ekonomisë. Të dhënat për këtë kapitull të Kodit Penal të Kosovës ka vetëm nga numri i rasteve të paraqitura. Sikurse në vitin paraprak, sërish me 2008, numrin më të madh të veprave penale kundër detyrës zyrtare e përbënin veprat penale sipas nenit 339 të shpërdorimit të pozitës zyrtare dhe autorizimit me 365 raste, respektivisht me 78,8% të rasteve të kësaj kategorie. (PPRK 2008)

Vepra tjera që bien në sy janë ato sipas nenit 340 mbi përvetësimin gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare me 37 raste, pastaj vijojnë ato sipas nenit 348 mbi falsifikimin e dokumentacionit me 16 raste të kallëzimeve penale.

Brenda vitit 2008, Prokuroritë Komunale dhe Prokuroritë e Qarkut kanë marrë në shqyrtim 214 kallëzime penale, kurse numri i personave të hetuar arrinte në 463. Prej të cilave 286 (61,8%) u përkasin Prokurorive Komunale, ndërsa 177 (38,2%) Prokurorive të Qarkut. Mirëpo për shkak të lëndëve të pazgjidhura gjatë vitit paraprak, numrit i shtohen edhe rastet e 192 personave të tjerë.

Pra numri i përgjithshëm i personave që kanë të bëjnë me vepra penale kundër detyrës zyrtare kështu arrin në 655. Numri më i madh i kallëzimeve penale të veprave penale kundër detyrës zyrtare janë parashtruar nga Policia e Kosovës, dhe atë rreth 80% e numrit të përgjithshëm të kallëzimeve penale brenda vitit 2008.

Në vitin 2008, janë zgjedhur rastet e 302 personave (46,1%), ndërsa 353 raste (53,9%) kanë mbetur të pazgjidhura. Në kuadër të rasteve të pazgjidhura përfshihen 113 kallëzime penale. Vendimet e prokurorëve lidhur me fletëparaqitjet penale të veprave penale kundër detyrës zyrtare janë si vijon:

- 58 ose 19,2 % të fletëparaqitjeve janë zgjidhur me rrëzim të fletëparaqitjes
- 21 ose 6,9 % të paraqitjeve është pushuar hetimi
- 67 ose 22,2 % të paraqitjeve është ngritë propozim akuza
- 19 ose 6,3% të fletëparaqitjeve është bërë propozimi për dhënien e urdhrit ndëshkimor
- 19 ose 6,3 % të fletëparaqitjeve është ngritë akuza e drejtë për drejtë

- 53 ose 17,6 % të fletëparaqitjeve është ngritë akuza pasi janë kryer hetimet
- 58 ose 19,2% fletëparaqitjeve janë zgjidhë me cedim në kompetencë
- 10 ose 3,3 % fletëparaqitjeve janë zgjidhë në mënyrë tjetër

Me faktin se më shumë se gjysma e rasteve mbetën të pazgjidhura gjatë vitit 2008, përkatësisht 353 raste të tilla, përgjithësisht mund të thuhet se gjatë këtij viti prokuroritë nuk kanë qenë shumë efikase në zgjidhjen e rasteve. Kjo rezulton gjithashtu edhe në disproporcion në raport me numrin e përgjithshëm të të gjitha veprave penale të zgjidhura nga Prokuroritë Komunale dhe Prokuroritë e Qarkut, ngase marrë në total, përderisa janë zgjidhur mbi 80% të rasteve të përgjithshme të fletëparaqitjeve penale, kur bëhet fjalë për veprat e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, janë zgjidhur vetëm 46,1% të rasteve.

Në veprat penale kundër detyrës zyrtare, bën pjesë dhe vepra penale e falsifikimit të dokumenteve zyrtare, e përfshirë në Kodin Penal sipas nenit 348. Kjo vepër penale konsiderohet si e kryer kur zyrtari në dokumentin zyrtar apo afarist shënon të dhëna të rreme të cilat i vërteton me nënshkrimin e vet apo me vulë zyrtare.

Gjatë vitit 2008, Prokuroritë Komunale dhe ato të Qarkut kanë pasur në punë 16 fletëparaqitje për veprën penale që ka të bëjë me falsifikimin e dokumenteve zyrtare. Gjatë periudhës raportuese, prokuroritë për këtë lloj të veprave kanë zgjidhur rastet për 11 persona, kurse të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kanë mbetur edhe 1 kallëzim penal me 5 persona.

Gjatë punës së realizuar brenda vitit 2008, prokuroritë kanë marrë në punë 2 raste për veprën penale nga neni 346-Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe 3 raste nga neni 350 - Lirimi i kundërligjshëm i personit nga liria. Shkalla e ulët e zgjidhshmërisë (46,1%) për fletëparaqitjet penale të cilat kanë të bëjë me veprat penale kundër detyrës zyrtare, mund të arsyetohet me faktin se veprat penale kundër detyrës zyrtare, përveç që janë shumë të ndërlikuara, sepse në të shumtën e rasteve këto vepra kryhen në kuadër të marrëveshje sekrete ndërmjet zyrtarëve të korruptuar, andaj kjo vetvetiu flet se sa vështirë mund të sigurohen provat, përkatësisht dëshmitë për kryerjen e këtyre veprave.

Në kuadër të vitit 2009, rritet përqindja e kallëzimeve penale të veprave të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në kuadër të numrit të përgjithshëm të veprave penale të raportuar. Kësaj radhe veprat penale sipas kapitullit XXIX, përbëjnë 2,5% të rasteve, kurse numri i këtyre veprave penale është 588. Numrin më të madh të veprave penale kundër detyrës zyrtare, sikurse edhe në vitet paraprake e përbëjnë veprat penale nga neni 339 - shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit, me 369 ose 62,8 % të paraqitjeve penale, veprat penale nga neni 340 – përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës marrin pjesë në këtë kapitull me 16 ose 2,9 % të paraqitjeve penale dhe veprat penale nga neni 348 - falsifikimi i dokumenteve zyrtare, me 111 ose 19,9 % paraqitjeve penale. (PPRK 2009)

Përndryshe gjatë vitit 2009, Prokuroritë Komunale, Prokuroritë e Qarkut dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, së kanë marrë në punë 222 kallëzime penale, në kuadër të të cilave përfshiheshin 437 persona. Duke i marrë për bazë edhe rastet e 303 personave të cilët kanë mbetur të pazgjidhura nga viti 2008, atëherë gjithsejtë në punë gjatë vitit raportues kanë qenë rastet e 740 personave të cilat kanë të bëjnë me veprat penale të korrupsionit.

Gjatë periudhës raportuese të vitit 2009, janë zgjidhur rastet e 361 ose 48,8% të personave, kurse të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kanë mbetur rastet e 353 ose 51,2% të personave me 155 kallëzime penale.

Nga numri i fletëparaqitjeve penale të cilat janë pranuar në punë, 257 ose 58,8 % u përkasin Prokurorive Publike Komunale, 105 ose 24,0% u përkasin Prokurorive Publike të Qarkut kurse 75 ose 17,2% i përkasin Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Është me rëndësi të përmendet fakti se 68,0 % të kallëzimeve penale të këtij lloji janë parashtruar nga Policia e Kosovës. Krahasuar me vitin paraprak 2008, në vitin raportues 2009 ka rënie të numrit të kallëzimeve të parashtruara nga Policia e Kosovës për 12,8%. Përgjithësisht krijohet bindja se kjo rënie nuk mund të lidhet krejtësisht me rënie e rasteve korruptive gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, por mund të bëj ndoshta me faktin e perfeksionimit të kamuflimeve që personat zyrtar të korruptuar ndërmarrin.

Lidhur me fletëparaqitjet penale ndaj 740 personave sa kanë qenë në punë, Prokuroritë Komunale, Prokuroritë e Qarkut dhe Prokuroria Speciale, kanë vendosur kallëzimet

penale ndaj 361 ose 48,8% personave. Vendimet e prokurorëve në këtë rast, gjatë vitit 2009 janë si vijon:

- 94 ose 26,0 % të paraqitjeve është ngritë propozim-akuza
- 79 ose 21,9% fletëparaqitjeve janë zgjidhë me cedim në kompetencë
- 70 ose 19,4 % të fletëparaqitjeve është ngritë akuza pasi janë kryer hetimet
- 51 ose 14,1 % të paraqitjeve janë zgjidhë me hedhje poshtë të fletëparaqitjes
- 47 ose 13,0 % të paraqitjeve është pushuar hetimi
- 8 ose 2,2 % të fletëparaqitjeve është ngritë akuza e drejtë për drejtë
- 6 ose 1,7% të fletëparaqitjeve është bërë propozimi për dhënien e urdhrit ndëshkimor
- 5 ose 1,4 % fletëparaqitjeve janë zgjidhë në mënyrë tjetër
- 1 ose 0,3% të paraqitjeve janë zgjidhë me pezullim të hetimit

Gjatë vitit 2009 kanë mbetur të pazgjidhura fletëparaqitjet penale ndaj 379 ose 51,2% të personave, kurse në të njëjtën periudhë janë zgjidhur paraqitjet penale ndaj 361 ose 48,8 % të personave. Përqindja prej 48,8% të veprave penale kundër detyrës zyrtare të zgjidhura, sërish edhe gjatë vitit 2009 bie në disproporcion me numrin e përgjithshëm të rasteve të zgjidhura i cili arrin në 74,2%. (PPRK 2009)

Gjatë vitit 2009, Prokuroritë Komunale dhe të Qarkut kanë pasur në punë 118 fletëparaqitje për veprën penale që ka të bëjë me falsifikimin e dokumenteve zyrtare, për këtë lloj të veprave janë zgjidhur rastet për 24 persona, kurse të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kanë mbetur edhe 10 kallëzime penale me 94 persona. Në vitin raportues, krahasuar me vitin paraprak, numri i paraqitjeve penale për këto lloje veprash është zmadhuar në mënyrë enorme për 92 ose 484,2%.

Gjatë vitit 2010, Prokuroritë Komunale, Prokuroritë e Qarkut dhe Prokuroria Speciale, kanë qenë të ngarkuar me raste ku ishin të përfshirë 1051 persona të cilat kanë të bëjnë me veprat penale kundër detyrës zyrtare. Nga rastet e 1051 personave, sa kanë qenë në punë në periudhën raportuese, 634 ose 60,3 % të rasteve janë pranuar në punë gjatë periudhës raportuese, kurse 417 ose 39,7% janë raste të cilat kanë mbetur të pazgjidhura nga periudhat paraprake në kuadër të vitit 2009.

Në vitin 2010 janë zgjedhur rastet e 368 ose 35,0% të personave, kurse në fund të periudhës raportuese kanë mbet të pazgjedhura 282 kallëzime penale me rastet 683 ose 65,0% të personave. Nga numri i kallëzimeve penale të pranura në punë në periudhën raportuese (634), 310 ose 48,9% u përkasin Prokurorive Publike Komunale, 189 ose 29,8% u përkasin Prokurorive Publike të Qarkut dhe 135 ose 21,3% i përkasin PSRK-së (PPRK 2010). Vlen të përmendet se 60,9 % të kallëzimeve penale të këtij lloji janë parashtruar nga Policia e Kosovës. Rastet 368 personave të cilat janë zgjedhur gjatë viti 2010, kanë përfunduar si vijon:


- ndaj 98 personave ose 26,6% është ngrit aktakuza pas hetimit
- ndaj 69 personave ose 18,8% të rasteve është hedhur kallëzimi penal
- ndaj 60 personave ose 16,3% të rasteve është ngrit propozim akuza
- ndaj 44 personave ose 12,0% të rasteve kanë përfunduar me dërgim të rastit në kompetencë
- ndaj 42 personave ose 11,4% të rasteve është pushuar hetimi
- ndaj 21 personave ose 5,7% të rasteve është ngrit propozim akuza për dhënien e urdhrit ndëshkimor
- ndaj 13 personave ose 3,5% të rasteve është pezulluar hetimi
- ndaj 11 personi ose 3,0% kallëzimi penal është zgjedhur në mënyrë tjetër
- ndaj 8 personave ose 2,2% është ngrit aktakuza e drejtpërdrejtë
- ndaj 2 personave ose 0,5% të rasteve është hequr dorë nga ndjekja penale

Sa i përket kallëzimeve penale për veprat penale kundër detyrës zyrtare, Prokurorit nuk kanë qenë efikase nga se në fund të periudhës raportuese kanë mbet të pazgjedhura rastet e 683 ose 65,0% të personave.

Në përgjithësi gjatë vitit 2010, prokuroritë në Kosovë kanë zgjedhur 56,6% të kallëzimeve penale, kurse kallëzimet penale kundër detyrës zyrtare janë zgjedh 35,0 % çka do të thotë se 21,6% janë zgjedh më pakë kallëzimet penale për veprat penale kundër detyrës zyrtare se sa kallëzimet penale në përgjithësi.

Krahasuar rastet e pazgjedhura në fund të periudhës raportuese të vitit 2010 me rastet e pazgjedhura në fund të vitit 2009, numri i rasteve të pazgjedhura për këtë lloj të veprave penale është zmadhuar për 266 ose 63,8% të personave.

Përgjithësisht nëse bëjmë një krahasim të viteve 2007, 2008 dhe 2009, vërret se përveç që vjen deri te numri i rritur i rasteve të kallëzimeve penale për vepra kundër detyrës zyrtare, njëkohësisht ritët edhe përqindja e kallëzimeve penale të kësaj kategorie brenda numrin të përgjithshëm të kallëzimeve penale të ngritura nga ana e Prokurorive Publike në Kosovë. Përderisa përqindja e tyre me 2007 ishte 1,5%, me 2008 ishte 2%, në vitin 2009 kjo përqindje do të rritet në 2,9%. Në këtë drejtim paraqitet edhe pasqyra grafike në vijim:



Diagrami 1: Kallëzimet Penale kundër detyrës zyrtare në kuadër të të gjitha kallëzimeve penale 2007-2009 (PPRK 2007), (PPRK 2008), (PPRK 2009)

Gjatë vitit 2011 prokuroritë kanë qenë të ngarkuar me rastet e 1503 personave, prej të cilave raste, 820 ose 54,5% janë pranuar në punë gjatë periudhës raportuese, kurse 683 ose 45,4 % janë raste të cilat kanë mbet të pazgjidhura nga vitet e kaluara. Gjatë periudhës raportuese, Prokuroritë Komunale, Prokuroritë e Qarkut dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, kanë zgjidhur rastet e 760 ose 50,6% të personave, kurse në fund të periudhës raportuese kanë mbet të pazgjidhura 267 kallëzime penale me rastet e 743 personave ose 49,4% numrit të tyre. (PPRK 2011)

Nga rastet 760 personave të cilat janë zgjidhur gjatë periudhës raportuese, 354 ose 46,6% kanë përfunduar me ngritje të aktit akuzues. Nga numri i rasteve të personave që kanë qenë punë, 570 ose 37,9% të personave u përkasin Prokurorive Komunale, 765 ose

50,9% të personave u përkasin Prokurorive Publike të Qarkut dhe 168 ose 11,2% të personave i përkasin Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Përndryshe numri i rasteve të personave që kanë të bëjë me veprat penale fjalë në periudhën raportuese, krahasuar me fund të vitit 2010 është zmadhuar për rastet e 60 personave ose për 8,8%. Nga rastet e përfunduara për 760 persona, 389 ose 51,2% raste të personave i kanë përfunduar PPK-et, rastet e 293 ose 38,6% të personave i kanë përfunduar PPQ-et dhe rastet e 78 ose 10,3% të personave i ka përfunduar PRSK. Në vitin raportues, krahasuar me vitin 2010, prokurorit kanë zgjidhur më shumë raste të këtij lloji për 392 ose 106,5% të personave.

Për veprat penale kundër detyrës zyrtare, gjatë vitit 2012 prokuroritë kanë pranuar në punë 376 kallëzime kundër 868 personave. Në fillim të vitit prokuroritë kanë pasur kallëzimet e pazgjidhura penale kundër 802 personave, që do të thotë se kanë pasur kallëzimet penale kundër gjithsejtë 1670 personave.

Duke vepruar sipas këtyre kallëzimeve, prokuroritë kanë akuzuar me propozim akuza 140 persona, me propozim akuza me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor 24 persona, me aktakuza të drejtpërdrejta 26 persona dhe me aktakuza pas hetimeve 106 persona. Kundër 192 personave kallëzimet penale janë dërguar në kompetencë, janë hedhe kallëzimet penale kundër 158 personave është pezulluar hetimi kundër 2 personave janë pushuar hetimet kundër 97 personave dhe kallëzimet kundër 25 personave janë zgjidhur në mënyrë tjetër. Në fund të vitit kanë mbetur të pazgjidhura 265 kallëzime kundër 900 personave. (Prokurori i Shtetit)

Gjatë vitit 2012, gjyqtarët për konfirmimin e aktakuzave për këto vepra penale kanë konfirmuar aktakuza kundër 89 personave, kanë hedhur akuzën kundër një personi dhe akuzat kundër 23 personave ia kanë kthyer në plotësim prokurorisë. Gjykatat po ashtu, gjatë vitit raportues kanë shpallur fajtorë dhe gjykuar me urdhër ndëshkimor 14 persona, kanë shpall fajtorë dhe dënuar 104 persona, iu kanë shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm dy personave, kanë refuzuar aktakuzën kundër 24 personave dhe 18 persona i kanë liruar nga aktakuza. (Prokurori i Shtetit, 2013)

Prokuroria e Kosovës gjatë vitit 2013, për veprën penale të korrupsionit marrje e mitos ka pasur gjithsej në punë lëndë në të cilat kanë qenë të implikuar 56 persona, ku nga këto në fund të vitit ka zgjidhur gjithsej lëndë në të cilat kanë qenë të implikuar 30 persona dhe në fund të periudhës kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej lëndë në të cilat kanë qenë të implikuar 26 persona.

Për veprën penale të korrupsionit dhënie e mitos, Prokuroria ka pasur gjithsej në punë lëndë në të cilat kanë qenë të implikuar 59 persona, ku nga këto lëndë që kanë implikuar 36 persona i ka zgjidhur ndërsa nga këto lëndë që kanë implikuar 23 persona janë të pazgjidhura në fund të vitit 2013, si dhe për veprën penale të korrupsionit keqpërdorim i pozitës zyrtare, Prokuroria e Kosovës ka pasur gjithsej në punë lëndë që kanë implikuar 1585 persona gjatë vitit 2013, ku nga këto vetëm janë zgjidhur lëndë që kanë implikuar vetëm 363 persona ndërsa lëndë që kanë implikuar 1222 persona kanë mbetur të pazgjidhura në fund të kësaj periudhe. (Prokurori i Shtetit, 2014).


	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Vepra Penale kundër detyrës zyrtare	395	503	588	665	820	376	363	697

Tabela 5: Numri i Kallëzimeve Penale për vepra penale kundër detyrës zyrtare 2007 - 2014

Sa i përket viteve 2013 dhe 2014, përkundër faktit që Prokuroria e Shtetit pretendon se është rritur niveli i transparencës, për herë të parë që nga viti 2007, nuk specifikohen rastet lidhur me veprat penale kundër detyrës zyrtare të përfshira në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Të dhënat e vitit 2013 për aktivitetin e Prokurorisë janë marrë nga Organizata Joqeveritare të cilat kanë monitoruar punën e saj. Gjithashtu mbi këto

baza shihet se Prokuroria për vepra penale kundër detyrës zyrtare, ka pranuar si lëndë 1.886 raste, kurse në anën tjetër prej këtyre rasteve ka arritur të zgjedhe gjithsej 697 raste.

Andaj të dhënat mbi aktivitetet e prokurorive sa i përket viteve të cekura, do të bazuar edhe në burime të tjera të cilat janë përdorur me qëllim të shtjellimit të këtij studimi, kurse meqenëse nuk janë pjesë e specifikuar zyrtare në raportet e lëshuara nga Prokuroria e Shtetit, ato do të përmbledhen bazuar në informacione sekondare por relevante dhe të konfirmuara. Më poshtë vijon një përmbledhje statistikore dhe pasqyrë grafike mbi numrin e Kallëzimeve Penale të ngritura për vepra kundër detyrës zyrtare në periudhën 2007-2014, ku siç shihet ka një rënie të ndjeshme të rasteve të raportuara në vitin 2012.



Diagrami 2: Numri i Kallëzimeve Penale për vepra penale kundër detyrës zyrtare 2007 – 2014

Me hyrjen në fuqi të Planit të Veprimit të aprovuar Këshilli Prokurial i Kosovës, më 4 nëntor 2013, prokuroritë kanë pasur në punë 516 raste të pazgjidhura me 1.682 persona, ndërsa më 30 qershor 2015 kanë mbetur 589 raste të pazgjidhura me 1.706 persona. Bazuar në numrin e rasteve të pazgjidhura më 4 nëntor 2013, kur ishin 516 raste me 1.682 persona të involvuar dhe numrin e rasteve të pranuar gjatë Planit të Veprimit më vonë gjatë periudhës vijuese me 716 raste të veprave penale ku janë të përfshirë në raste të ndryshme 1.441 persona, rezulton se prokuroritë kanë pasur në punë 1.232 raste me 3.123 persona. (Prokurori i Shtetit, 2013)

Prej këtij numri të përgjithshëm që nga hyrja në fuqi e Planit të Veprimit, prokuroritë në Kosovë kanë arritur të zgjidhin 688 raste apo 56 % të tyre me 1,598 persona të involvuar apo 51 % të numrit të përgjithshëm të personave të involvuar në vepra penale kundër detyrës zyrtare.

Përndryshe sipas prononcimeve të lëshuara nga vetë Prokuroria e Shtetit, thuhet se që kur ka nisur zbatimi i planit të veprimit më 4 nëntor 2013 e deri më 30 shtator 2014, prokuroritë kanë pasur në punë 971 raste ndaj 2589 personave, ndërsa janë zgjidhur 396 raste ndaj 974 personave.

Për 228 persona janë hedhur kallëzimet penal; ndaj 307 persona janë pushuar hetimet; për 43 persona është ngritur aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor; aktakuzë e drejtpërdrejtë është ngritur ndaj 64, ndërsa për 332 persona është ngritur aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve.

Personat të cilët kryejnë vepra penale kundër detyrës zyrtare, janë rëndom edhe persona zyrtarë të cilët kanë autorizime të konsiderueshme prandaj edhe parashtruesit e kallëzimeve penale e edhe prokurorët gjatë hetuesisë shfaqin një lloj frike sepse siguria e prokurorëve nuk është e nivelit të duhur. Për zbardhjen e veprave penale të korrupsionit, nevojitet veprim i koordinuar i të gjitha organeve kompetente shtetërore dhe atë për një periudhë të gjatë kohore, çka do të thotë se zgjedhja e këtyre kallëzimeve nuk varët vetëm nga prokurori.

Mungesa e rezultateve në luftimin e korrupsionit theksohet qartë në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2014, ku thuhet se zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër-Korrupsionit ka dështuar të gjenerojë rezultate efektive, për shkak të mbështetjes së dobët politike. Nga vetë Raporti i Progresit, nënkuptohet se mungesa e një luftë efikase kundër korrupsionit, zhbën shumë prej të arriturve që Kosova mund të ketë arritur edhe në drejtime tjera të konsolidimit të saj. Në dokumentin e lëshuar nga ana e Komisionit Evropian theksohet qartë se shkalla e sundimit të ligjit, pavarësia jo e duhur e gjyqësorit, mungesat në luftën kundër krimit të organizuar, si dhe jo efikasiteti në luftën kundër korrupsionit paraqet një shqetësim. (European Commission, 2014)

Mungesa e vullnetit politik në luftimin e korrupsionit, mos-koordinimi dhe bashkëpunimi efikas dhe efektiv në mes të agjencive dhe institucioneve ekzekutive dhe atyre të pavarura në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, ndikon drejtpërdrejtë në mungesën e rezultateve në luftimin e korrupsionit në Kosovë.

Raporti i Komisionit Evropian, i cekur më lartë, i kushton vëmendje edhe mungesës së implementimit të pikave akcionale për të cilat zotohen institucionet e Kosovës, dhe përmend tekstualisht angazhimin e Agjencisë Kundër Korrupsion dhe faktin se janë ndërmarë vetëm gjysma e pikave akcionale dhe strategjive të planifikuara. (European Commission, 2014, f. 14)

6. 4. Raportimet e Policisë mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare

Duke filluar nga viti 2008 kur Kosova shpallet shtet i pavarur, fillojnë edhe raportimet e pavarura vjetore, periodike e deri në baza ditore, të lëshuara nga ana e Drejtorisë së Policisë të Kosovës, kurse gjithashtu me raporte pavarura për shkak të specifikës dhe natyrës së punës, del edhe Inspektorati Policor. Në kuadër të kësaj, Policia e Kosovës ka përpiluar edhe raportin vjetorë mbi punën e saj gjatë vitit 2007, i cili është botuar në periudhën raportuese vijuese gjatë vitit 2008, sikurse edhe imponon vetë natyra e përmbledhjeve statistikore në përgjithësi kur bëhet fjalë për raportimet.

Në neni 6 të Ligjit për Policinë specifikohen edhe raportet e obligueshme të Policisë së Kosovës me sistemin e drejtësisë në Kosovë. Aty thuhet:

1. Policia zbaton urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara në mënyrë të ligjshme nga prokurori publik ose gjyqtari kompetent.
2. Policia bashkëpunon dhe i raporton Zyrës së Prokurorit Publik kompetent për informatat lidhur me akuzat për aktivitete të dyshimta kriminale, për të cilat policia është njoftuar në pajtim me ligjin e aplikueshëm. (Ligji për Policinë, 2012, fig. 4)

Tutje neni 15 i këtij ligji përcakton edhe obligimin e Policisë që përveç me sistemin e drejtësisë, të bashkëpunojë ngushtë edhe me faktorë të tjerë, gjë e cila është e rëndësishë

të jashtëzakonshme kur bëhet fjalë për identifikimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare. Në nenin 15 thuhet:

1. Zyrtari policor ka për detyrë t'i pranojë informatat e ofruara nga personat lidhur me kryerjen e ndonjë veprë penale ose me shkeljet e tjera të ligjit që janë relevante për punën dhe kompetencat e policisë.

2. Kur policia konstaton se vepra e raportuar nuk është vepër penale apo është vepër penale e cila ndiqet në bazë të padisë private, zyrtari policor duhet ta informojë personin që ka raportuar dhe palën e dëmtuar nëse ekziston ajo. 3. Informatat për vepra penale përcillen në Zyrën e Prokurorit Publik kompetent në pajtim me Kodin e Procedurës Penale. (Ligji për Policinë, 2012, f. 6)


Përndryshe Policia e Kosovës, duke filluar nga viti 2012, funksionon në bazë të Ligjit për Polici të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të njëjtin vit. Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës.

Marrë në përgjithësi, shikuar qysh nga puna e raportuar e realizuar në vitin 2007, përfshirë këtu të gjitha vitet vijuese deri me 2014, numri i lëndëve të rasteve të korrupsionit të personave zyrtar publik dhe më gjerësisht të të gjitha veprave penale kundër detyrës zyrtare, të cilat Policia e Kosovës i ka proceduar tutje në Prokurori, është kryesisht pa ndonjë lëvizje të madhe të ndryshimeve përgjatë viteve, së paku atyre numerik.

Gjithsesi duhet potencuar se në këtë rast një përjashtim të madh përbën viti 2008, kur Policia e Kosovës tani vepron si Polici e Shtetit pa qenë në lidhje hierarkike të varshmërisë apo subordinimit me Policinë e Administratës së UNMIK-ut. Në vijim, paraqiten rastet e veprave penale kundër detyrës zyrtare të proceduara nga ana e Policisë së Kosovës.

		2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Vepra kundër zyrtare	penale detyrës	175	285	160	179	147	159	170	153

Tabela 6: Raportim i Policisë së Kosovës 2007-2014 (Burimi: Raportet Vjetore të Policisë 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014)




Diagrami 3: Raportim i Policisë së Kosovës 2007-2014 (Burimi: Raportet Vjetore të Policisë 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014)

Dallimi i theksuar i veprave penale kundër detyrës zyrtare të raportuar nga ana e Policisë së Kosovës për vitin 2008, mund të jetë edhe produkt i akumulimit të hetimeve të pamjaftueshme të realizuara gjatë kohës sa Policia e Kosovës i ishte nënshtruar në aspektin organizativ Policisë së UNMIK-ut. Gjithsesi, numri i hetimeve, e ku shihet qartë se në vitin 2014 shënohet një numër më i vogël i rasteve në raport me dy vitet paraprake, nuk mund të jetë tregues i saktë i shkallës së kriminalitetit i cili ndërlidhet me veprat zyrtare kundër detyrës zyrtare.

Sa i përket dallimeve statistikore nëse marrim parasysh të dhënat nga Drejtoritë Rajonale të Policisë, është marrë për bazë periudha e viteve 2010 dhe 2011, e ku veç tjerash bie në sy, një diskrepancë jo proporcionale sipas rajoneve.

Drejtoria Rajonale	Prishtinë	Prizren	Pejë	Mitrovicë	Gjilan	Ferizaj
2010	22	13	38	98	3	5
2011	31	5	32	33	10	3

Tabela 7: Krahasim i veprave penale kundër detyrës zyrtare 2010-2011 sipas drejtorive rajonale të Policisë së Kosovës (Burimi: Raportet Vjetore të Policisë 2010 dhe 2011)



Diagrami 4: Krahasim i veprave penale kundër detyrës zyrtare 2010-2011 sipas drejtorive rajonale të Policisë së Kosovës (Burimi: Raportet Vjetore të Policisë 2010 dhe 2011)


Pra edhe nga të dhënat statistikore, dallohet qartë dhe kjo sidomos vjen në shprehje gjatë vitit 2010, një numër i madh i veprave penale në kuadër të veprimit të Policisë së Kosovës në rajonin e Mitrovicës, kurse përgjithësisht gjatë këtyre dy viteve, shihet një numër gati minimal i veprave penale kundër detyrës zyrtare në rajonet e Gjilanit dhe Ferizajt.

Kur bëhet fjalë për rajonin e Prishtinës, nuk duhet harruar faktin se kjo është një Drejtori Rajonale e cila mbulon kryeqytetin si qendër administrative dhe seli e shumicës së institucioneve publike të Kosovës apo edhe ndërmarrjeve publike gjithashtu, por treguesit statistikor të viteve 2010 dhe 2011, megjithatë nuk tregojnë numër të pritur më të krahasueshëm me rajone tjera. Duhet thënë së në analizën e këtyre dy viteve, dy rajone tjera, e këto janë Peja dhe Mitrovica kanë numër më të madh të keqpërdorimeve të detyrës zyrtare se vet Prishtina.

Policia e Kosovës, viteve të fundit ka një vëmendje të shtuar sa i përket raportimeve që vijnë nga Departamenti i Kufirit. Më parë kompetencat e sotme të këtij Departamenti kanë qenë gati tërësisht të mbikëqyrura nga UNMIK-u. Treguesit statistikorë në këtë rast flasin edhe për shpërdorime të detyrës si raste megjithëse minimale, përjashtuar këtu rastet të cilat kanë ndodhur gjatë vitit 2013, gjithashtu edhe raste të marrjes së mitos, kurse këtu tregohen edhe të dhënat rreth tentimit nga ana e qytetarëve për të korruptuar zyrtarët e Policisë së Kosovës, përkatësisht pjesëtarët e Policisë Kufitare.

	2011	2012	2013	2014
Shpërdorim i detyrës zyrtare	2	1	5	1
Marrje e ryshfetit	0	1	1	1
Dhënie e ryshfetit	0	8	12	10
	2	10	18	12

Tabela 8: Raportim i Departamentit të kufirit (Policia e Kosovës) 2011-2014 (Burimi: Raportet Vjetore të Policisë 2011, 2012, 2013 dhe 2014)



Diagrami 5: Raportim i Departamentit të kufirit (Policia e Kosovës) 2011-2014 (Burimi: Raportet Vjetore të Policisë 2011, 2012, 2013 dhe 2014)

Një nga fushat ku Policia e Kosovës gjithashtu lufton korrupsionin janë edhe vetë radhët e saj, fushë kjo e cila mbulohet nga Inspektorati Policor i Kosovës. Gjatë viti 2014, Inspektorati Policor, ka hetuar 83 vepra penale me elemente të korrupsionit dhe veprave të tjera kundër detyrës zyrtare, ndër të cilat janë 48 vepra keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, 12 vepra falsifikim i dokumentit zyrtar, 10 vepra të marrjes së ryshfetit, 4 vepra të ushtrimit të ndikimit, 4 vepra zbulim i fshehtësisë zyrtare, 2 vepra të dhënies së mitos, 1 vepër të përvetësimit në detyrë, 1 vepër të mashtrimit dhe 1 vepër të konfliktit të interesit. Përndryshe gjatë të njëjtit vit, në Inspektoratin Policor të Kosovës janë trajtuar 1.304 ankesa të ndryshme nga qytetarët dhe institucionet e ndryshme, kundër pjesëtareve të Policisë së Kosovës. (IPK, 2014)

6. 5. Aktiviteti i Agjencisë Kundër Korrupsionit në hetimin e rasteve korruptive gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare

Agjencia Kundër Korrupsionit është institucion i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Kosovës në korrik të vitit 2006, ndërsa ka filluar veprimtarinë me 12 shkurt të viti 2007. Baza ligjore për themelimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, është Ligji kundër Korrupsionit (2004/34) i cili i kishte përcaktuar përgjegjësitë dhe fushëveprimin e saj.

Ligji kundër Korrupsionit i nxjerrë qysh në vitin 2004 nga Kuvendi i Kosovës, në nenin e tij 5 specifikon si vijon (Ligji kundër korrupsionit, 2004):

5.1. Kur një person fizik apo juridik beson që vendimi i një personi zyrtar apo i personit përgjegjës të personit juridik është marrë për shkak të korrupsionit, ai duhet t'i drejtohet me shkrim Agjencisë kundër korrupsionit.

5.2. Agjencia Kosovar kundër korrupsionit është i detyruar të shqyrtojë kërkesën dhe brenda 60 ditëve nga marrja e saj të informojë personin fizik apo juridik për rezultatin lidhur me kërkesën.

Mandati i Agjencisë është i përqendruar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe sensibilizimin e opinionit publik me qëllim të ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë që bazohet në shtetin e së drejtës. Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës, përveç në ligjin e përmendur më lartë, ushtron mandatin e saj ligjor në bazë të kompetencave dhe autorizimeve që burojnë edhe nga aktet në vijim:

- Ligji nr. 04/L-050 (Ligj për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, 2011)
- Ligji i cili ka hyrë në fuqi më 2014, nr. 04/L-228 (Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, 2014)
- Ligji nr. 04/L-051 (Ligj për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, 2011)

Pra bazë mbi të cilën funksionon Agjencia Kundër Korrupsionit është edhe “Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë”.

Ky ligj i përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë për ta deklaruar pasurinë, të hyrat dhe prejardhjen, detyrën e agjencisë për ta kontrolluar deklarimin dhe kontrollin e


pasurisë si dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe prejardhjen e tyre.

Gjithashtu ligji në fjalë rregullon, procedurën e deklarimit dhe kontrollin e pasurisë, të hyrat dhe detyrimet e zyrtarëve të lartë publik, anëtarët e familjes si dhe sanksionet e përcaktuara, e po ashtu rregullon edhe procedurën e deklarimit, kontrollit për dhuratat dhe prejardhjen e tyre të pranuar nga të gjithë personat zyrtarë.

Agjencia Kundër Korrupsionit, që nga funksionalizimi e deri në momentin e raportimit, nga të gjitha rastet e hetuara ku janë gjetur prova të mjaftueshme për vërtetimin e dyshimeve për shkelje korruptive, i ka përcjell në prokuroritë publike të Kosovë, prokurorinë e EULEX-it, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Njësinë e Hetimeve Financiare, gjithsejtë 420 raste.

Të ndara sipas viteve, rastet e përcjella nga ana e Agjencia Kundër Korrupsionit për procedim të mëtutjeshëm, janë si vijon:

- Në vitin 2007 AKK në Institucionet Kompetente ka përcjellë 47 raste në të cilat kanë qenë të përfshirë 91 persona (AKK 2007)
- Në vitin 2008 ka përcjellë gjithsejtë 53 raste në të cilat kanë qenë të përfshirë 113 persona (AKK 2008)
- Në vitin 2009 AKK ka përcjellë 68 raste ku janë të përfshirë 159 persona (AKK 2009)
- Në vitin 2010 ka përcjellë 33 raste, ndërkaq janë të përfshirë 164 persona (AKK 2010)
- Në vitin 2011 ka përcjellë 39 raste të përfshirë 121 persona (AKK 2011)
- Në vitin 2012 janë përcjellë gjithsejtë 52 raste me përfshirje të 159 personave (AKK 2012)
- Në vitin 2013 janë përcjellë gjithsejtë 128 raste kundër 238 personave (AKK 2013)
- Në vitin 2014 janë përcjellë 131 raste kundër 163 personave (AKK 2014)



Diagrami 6: Raste të proceduara nga Agjencia Kundër Korrupsionit për hetime të mëtutjeshme (Burimi: Raportet Vjetore të Agjencisë Kundër Korrupsionit 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014)

Në vitin e parë raportues të Agjencia Kundër Korrupsion të Kosovës, rastet e proceduara më tutje te organet kompetente, për të cilat Agjencinë kishte prova të mjaftueshme. Këto janë raste për keqpërdorime gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Në tekstin e mëposhtëm është dhënë në mënyrë më të stërholluar, ndarja e këtyre rasteve sipas institucioneve.

- Nga rastet e dërguara nga Agjencia Kundër Korrupsion për procedim të mëtutjeshëm penal në Prokurori, kategorizimi i tyre është si vijon:
- ndaj gjyqtarëve janë dërguar në Prokurori për procedim të mëtutjeshëm 14 raste ose 30 % e rasteve, gjë që gjatë vitit 2007 përbën numrin më të madh;
- ndaj zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës (këtu përfshihen edhe ministrinë në kuadër të saj), janë dërguar në Prokurori 13 raste të dyshuara ose 28 % nga numri i përgjithshëm i rasteve të proceduara;
- ndaj zyrtarëve të pushtetit lokal janë dërguar në Prokurori 11 raste të dyshuara ose 23 % e totalit;
- ndaj zyrtarëve të institucioneve tjera publike, e ku përfshiheshin Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, KEK, Hekurudhat e UNMIK-ut, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, janë dërguar 9 raste, apo shprehur në përqindje, 19 % të numrin të përgjithshëm të rasteve të proceduara.

Në vitin e dytë raportues të Agjencisë Kundër Korrupsion, pra në kuadër të vitit 2008, ritet ndjeshëm numri i rasteve që ky Agjencinë i procedon tutje për tu hetuar. Dallon edhe vetë numri i pranimit të rasteve të dyshuara, përderisa në vitin 2007 kishte 124 raste të tilla të cilat i ka pranuar Agjencia Kundër Korrupsion, në vitin 2008 u pranuan 146 raste.

Në prononcimet që vinin nga Agjencia, kjo menjëherë u detektua si tregues i rritjes së besimit nga ana e qytetarëve në punën e Agjencisë Kundër Korrupsion. Megjithatë ky konstatim i cili vjen nga vetë zyrtarët kompetentë të Agjencisë Kundër Korrupsionit, përmban edhe elemente të vetë promovimit medial, ngase ato vlera numerike duhet të trajtuar në kuadër të aktiviteteve të përgjithshme të korrupsionit zyrtar në Kosovë.

Departamenti i Hetimeve për periudhën raportuese të vitit 2008, gjithsejtë ka trajtuar 146 raste të dyshuara për veprime korruptive në institucionet publike të Kosovës, ku në mesin e personave të dyshuar janë të evidentuar persona zyrtar si dhe persona zyrtarë të lartë të institucioneve publike.

- 43 raste korruptive, përkatësisht 30% e numrit të përgjithshëm të rasteve janë rastet e hetuara për veprime korruptive në kategorinë e Institucioneve tjera, (këtu hyjnë Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, KEK, Hekurudhat e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ish-Ndërmarrjet Shoqërore Doganat e Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës)
- 37 rast apo 25% e tyre janë në lidhje me rastet e hetuara për veprime të dyshuara korruptive ndaj personave zyrtar si dhe personave zyrtar të lartë në Qeverinë e Republikës së Kosovës,
- 33 raste apo 23% e numrit të përgjithshëm të rasteve kanë të bëjnë me gjykatat në Republikën e Kosovës, përkatësisht gjyqtarët dhe personat tjerë zyrtarë në kuadër të këtyre institucioneve si të dyshuar për veprime korruptive
- 26 raste, apo 18% e rasteve kanë të bëjnë me veprime nga Pushteti Lokal, përkatësisht personat zyrtar të tyre si të dyshuar për veprime korruptive

- 5 raste, apo 3% e tyre kanë të bëjnë me Prokuroritë, ato në nivel të qarkut dhe komunale, krahasuar me vitin 2007 ku kishim vetëm një rast të dyshuar për veprime korruptive të zyrtarëve të institucionit të prokurorisë
- 2 raste kanë të bëjnë me Kuvendin e Republikës së Kosovës, krahasuar me vitin paraprak ku nuk kishim raste të paraqitura për veprime korruptive

Agjencia Kundër Korrupsion sikurse që ishte rast në krahasimin 2007-2008, menjëherë në vitin 2009 pranon një numër dukshëm më të madh të rasteve të dyshuara për keqpërdorime gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Në vitin 2008 ishin pranuar 130 raste të tilla, kurse një vit më vonë, në vitin 2009 pranohen 45 raste më shumë. Bazuar në të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsion, struktura e rasteve të raportuara dhe të hetuara është si vijon:

- 53 raste të raportuara dhe të hetuara për vepra penale kundër detyrës zyrtare kishin të bënin me gjyqtarë dhe staf tjetër të Gjykatave në Kosovë
- 43 raste kishin të bënin me vepra penale kundër detyrës zyrtare në institucione tjera publike ku bëjnë pjesë Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, KEK, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Doganat e Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, si dhe ndërmarrje të tjera dikush shoqërore
- 31 raste kishin të bënin me zyrtarë të Qeverisë së Republikës të Kosovës, ku përfshihen edhe agjencitë e ndryshme që veprojnë në kuadër të ministrive
- 31 raste kishin të bënin me veprime penale kundër detyrës zyrtare në pushtetin lokal

Shikuar rastet e dërguara për procedim të mëtutjeshëm gjatë vitit 2009 nga ana e Agjencisë Kundër Korrupsion, 93 raste janë përcjell për mos raportim të pasurisë të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër materiale ose të detyrimeve financiare nga paragrafi 1 i nenit 437 të KPK-së. Ndërsa, në 92 raste shkelja është kryer nga zyrtarët e pushtetit lokal dhe në 1 rast nga zyrtari i institucioneve tjera. 8 raste me dyshimin për raportim të rremë të pasurisë, të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër materiale ose të detyrimeve financiare, nga paragrafi 2 i nenit 437 të KPK-së.

Nga numri i përgjithshëm i lëndëve të pranura në Agjencinë Kundër Korrupsion gjatë vitit 2010, hetuesit e Agjencisë kanë gjetur elemente bazike për fillimin e hetimet të 139 rasteve.

- Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara sipas detyrës zyrtare ku të dyshuar kanë qenë gjyqtar dhe staf tjetër i Gjykatave të Republikës së Kosovës (Gjykatat e Rregullta dhe të kundërvajtjes) janë evidentuar 17 raste.
- Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara për veprime korruptive të zyrtarëve në kategorinë e Institucioneve Tjera, (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, KEK, RTK, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ish- Ndërmarrjet Shoqërore, Ndërmarrjet tjera Publike, Institucionet e Pavarura, OJQ-të), si të dyshuar për vepra penale kundër detyrës zyrtare janë të evidentuar 47 raste.
- Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara për veprime korruptive të zyrtarëve në kategorinë e zyrtarëve publik të Qeverisë së Republikës së Kosovës (ministritë si dhe agjencitë që veprojnë në kuadër të ministrive të caktuara) për periudhën raportuese, janë evidentuar 44 raste.
- Pushteti Lokal (Komunat e Republikës së Kosovës), përkatësisht personat zyrtar të nivelit lokal si të dyshuar për veprime korruptive, për periudhën raportuese janë evidentuar 28 raste.
- Në vitin 2010 janë evidentuar 3 raste të dyshuara për veprime korruptive kundër prokurorëve të prokurorive publike.

Agjencia Kundër Korrupsion, gjatë periudhës raportuese të vitit 2010, pas informacioneve të marra nga qytetarët e ndryshëm por edhe informacioneve të siguruara sipas detyrës zyrtare, ka zhvilluar procedurën e hetimeve paraprake në lidhje me dyshimet për veprime korruptive të zyrtarëve publikë.

Rastet për të cilat ka arritur të provojë pretendimet faktike me provat e mbledhura gjatë fazës së hetimeve, Agjencia Kundër Korrupsion i ka proceduar në Prokuroritë Publike kompetente të Kosovës, organet policore kompetente dhe Prokurorinë e EULEX-it 29 informata dhe kallëzime penale. Ndërsa, në 2 raste pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim

të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale, por është dyshuar për shkelje administrative, dhe Agjencia këto dy raste i ka përcjell tek organet kompetente.

Gjatë vitit 2011, Agjencia Kundër Korrupsion ka filluar procedurën e hetimeve parake në 160 raste (AKK 2011). Në këto raste janë të përfshira Gjykatat e Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, Pushteti Lokal, Prokuroritë e Republikës së Kosovës, si dhe institucione të tjera. Në vijim paraqitet struktura e këtyre rasteve sipas institucioneve gjatë vitit 2011:

- Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara sipas detyrës zyrtare ku të dyshuar kanë qenë gjyqtar dhe staf tjetër i Gjykatave të Republikës së Kosovës (Gjykatat e Rregullta dhe të kundërvajtjes) janë evidentuar 11 raste.
- Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara sipas detyrës zyrtare për veprime korruptive të zyrtarëve publik në kategorinë e Institucioneve Tjera, (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, KEK, RTK, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ish- Ndërmarrjet Shoqërore, Ndërmarrjet tjera Publike, Institucionet e Pavarura) janë evidentuar 60 raste.
- Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara sipas detyrës zyrtare për veprime korruptive të zyrtarëve publik në kategorinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës (ministritë si dhe agjencitë që veprojnë në kuadër të ministrive të caktuara) për periudhën raportuese janë evidentuar 30 raste.
- Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara sipas detyrës zyrtare kundër personave zyrtarë publik të kategorizuar te Pushteti Lokal (Komunat e Republikës së Kosovës), për periudhën raportuese janë evidentuar 56 raste.
- Nga rastet e raportuara janë evidentuar 3 raste të dyshuara për veprime korruptive lidhur me punën e prokurorive

Gjatë vitit 2011 në institucionet kompetente për procedim të mëtutjeshëm penal janë përcjell 39 informata dhe kallëzime penale. Ndërsa, në 5 raste pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale, por është dyshuar për shkelje administrative, dhe Agjencia këto raste i ka përcjell në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore.

Rastet e përcjella sipas strukturës së veprave penale

Në mesin e 39 rasteve të përcjella në prokuroritë publike dhe organet policore kompetente për procedim të mëtutjeshëm, në disa prej tyre janë të përfshira dy e më shumë vepra penale. Gjithashtu, janë përcjellë edhe vepra penale të cilat AKK i ka hasur gjatë zhvillimit të procedurave hetimore paraprake për veprime të mundshme korruptive, e të cilat nuk janë me elemente korruptive. Struktura e veprave penale të përcjella në institucionet kompetente, është si në vijim:

- Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit Nga numri i përgjithshëm i rasteve të proceduara në prokuroritë publike dhe organet policore kompetente, numrin me të madh të tyre e përbejnë veprimet korruptive të parapara sipas nenit 339 të KPK-së, pra Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit. Sipas figurës së veprës penale në fjalë janë përcjell 33 informata dhe kallëzime penale të kësaj natyre. Ndërsa, sipas institucioneve shpërndarja është: 13 Pushteti Lokal, 9 Qeveria, 11 Institucionet tjera.
- Te pushteti lokal kjo vepër penale në 3 raste është përcjellë së bashku me veprën penale Falsifikimi i Dokumenteve Zyrtare e paraparë me nenin 348 të KPK-së, në 1 rast së bashku me veprën penale Legalizimi i Përmbajtjes së Pavërtetë e paraparë me nenin 334 të KPK-së dhe Lidhja e Kontratës së Dëmshme e paraparë me nenin 237 të KPK-së dhe në 1 rast së bashku me veprën penale Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme e paraparë me nenin 349 të KPK-së.
- Te institucionet e kategorizuara si Qeveria kjo vepër penale në 3 raste është përcjellë së bashku me veprën penale Falsifikimi i Dokumenteve Zyrtare e paraparë me nenin 348 të KPK-së dhe në 1 rast së bashku me veprën penale Cenim i të Drejtave në Punësim e paraparë me nenin 183 të KPK-së. Te Institucionet tjera Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit në 1 rast është përcjellë së bashku me veprën penale Falsifikimi i Dokumenteve Zyrtare e paraparë me nenin 348 të KPK-së, në 1 rast së bashku me veprën penale Lidhja e Kontratës së Dëmshme e paraparë me nenin 237 të KPK-së dhe në 1 rast së bashku me veprën penale Përvetësimi Gjatë Ushtrimit të Detyrës e paraparë me nenin 340 të KPK-së.

- Nxjerrja e Kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore Veprimet korruptive të dyshuara të cilat janë përcjellë në prokuroritë publike dhe organet policore kompetente për procedim penal, që janë karakterizuar si vepër penale Nxjerrja e Kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore sipas nenit 346 të KPK-së, janë tipike për veprimet e gjykatave dhe si të tilla janë përcjellë 2 raste me persona zyrtarë të gjykatave.
- Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme Veprim korruptiv i dyshuar i cili është përcjellë në Prokurori për procedim penal të mëtutjeshëm i karakterizuar si vepër penale Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme sipas nenit 349 të KPK-së, është vetëm 1 rast nga Qeveria.
- Gjithashtu kjo vepër penale të pushteti lokal në një rast është përcjellë së bashku me veprën penale Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit që është cekur edhe më lartë.
- Vjedhja Gjatë kësaj periudhe raportuese nga rastet e përcjella në organet policore kompetente për procedim penal të mëtutjeshëm zë vend edhe vepra penale Vjedhja e paraparë në nenin 252 të KPK-së, ku është 1 rast nga Institucionet tjera.
- Mashtrimi në detyrë Mashtrimi në detyrë si vepër penale e paraparë në nenin 341 të KPK-së, në 1 rast nga Qeveria është përcjellë me dyshime të arsyeshme për veprime korruptive në Prokurorinë publike kompetente për procedim penal të mëtutjeshëm.
- Shmangia nga Tatimi është përcjell në organet policore kompetente për procedim penal të mëtutjeshëm që është karakterizuar si vepër penale Shmangia nga Tatimi e paraparë sipas nenit 249 të KPK-së, së bashku me veprën penale Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare e paraparë me nenin 340 të KPK-së është vetëm 1 rast nga kategoria e institucioneve tjera.

Në vitin 2012, Agjencia Kundër Korrupsion ka pranuar shumë informata për dyshime se persona të caktuar mund të jenë përfshirë në veprime korruptive. Në 164 raste Agjencia ka gjetur elemente bazë për fillimin e hetimeve ndaj tyre. Ndërsa pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake është konstatuar se prej 164 rasteve të raportuara për

korupsion në 52 ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale.

Në këto 52 raste brenda vitit 2012, ku përfshihen 159 persona, Agjencia Kundër Korrupsion ka ushtruar kallëzime penale dhe të njëjtat i ka përcjellë tek Policia e Kosovës dhe Prokuroritë kompetente për procedim penal për këto vepra të dyshuara korruptive.

Ndërsa, në 7 raste pas përfundimit të procedurave hetimore paraprahe është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale, por është dyshuar për shkelje administrative, dhe Agjencia këto raste i ka përcjell në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore.

Rastet e përcjella nga Agjencia gjatë vitit 2012, sipas strukturës së veprave penale:

- Shpërdorim i Pozitës Zyrtare dhe Autorizimit, për këtë vepër penale janë përcjell 36 raste, ku janë të përfshirë 124 persona. Numri total i rasteve që janë përcjell në Polici dhe Prokuroritë e Kosovës dhe të EULEX-it është 46 raste, derisa në to janë të përfshirë 108 persona nën dyshimin se kanë kryer vepër penale: shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit. Kjo vepër në disa raste është përcjellë së bashku me vepra tjera penale.
- Përvetësimi gjatë Ushtrimit të Detyrës, për këtë vepër penale janë përcjell në Prokurori kompetente 1 rast, ku është i përfshirë 1 person.
- Marrje Ryshfetit, bazuar në nenin 343 të Kodit Penal të Kosovës, janë përcjell në polici 2 raste, ku janë të përfshirë 2 persona.
- Dhënie Ryshfeti, për këtë vepër penale janë përcjell në polici 1 rast, ku janë të përfshirë 3 persona.
- Lidhja e Kontratës së Dëmshme, bazuar në nenin 237 të Kodit Penal të Kosovës, Agjencia ka përcjell në Prokurori kompetente 1 rast, ku janë të përfshirë 2 persona.
- Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë, vepër penale bazuar në nenin 334 të KPRK, AKK ka përcjell në Prokurori kompetente 1 rast, ku është i përfshirë 1 person.

Gjatë vitit 2013, në mesin e 128 rasteve të përcjella në Prokurori dhe Policinë e Kosovës për procedim të mëtutjeshëm, në disa prej tyre janë të përfshira dy e më shumë vepra penale. Struktura e veprave penale të përcjella në institucionet kompetente më së shumti ka të bëjë me vepra kundër detyrës zyrtare si në vijim:

- Keqpërdorim i Pozitës apo autoritetit zyrtar - Nga numri i përgjithshëm i rasteve të përcjella në Prokuroritë dhe tek Policia e Kosovës numrin më të madh të tyre e përbejnë veprimet korruptive të parapara sipas nenit 339, përkatësisht 422 të KPK-së. Sipas figurës së veprës penale në fjalë janë përcjell 39 informata dhe kallëzime penale të kësaj natyre. Në disa raste kjo vepër penale shoqërohet edhe me vepra tjera penale. Në dy raste janë përcjell të shoqëruara së bashku me veprën penale Keqpërdorim i Pozitës apo autoritetit zyrtar (neni 339, përkatësisht 422 të Kodit Penal të Kosovës).
- Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare - Numrin më të madh të rasteve të përcjella në prokurori e përbejnë veprimet e sanksionuara sipas nenit 437 të Kodit Penal të Kosovës, gjithsejtë 74 kallëzime penale.

Gjatë vitit 2014, AKK ka zhvilluar procedurën e hetimeve paraprake në gjithsejtë 304 raste, prej të cilave 56 prej tyre janë bartur nga vitet paraprake, kurse gjatë vitit 2014 janë pranuar edhe 248 raste. Prej tyre 131 raste, janë përcjell në Prokurori dhe Polici për procedim të mëtutjeshëm, 11 raste janë përcjell në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore, 4 raste janë deleguar në kompetencë të organeve përkatëse, 102 raste janë mbyllur, ndërsa 56 raste janë në procedurë. Numri i përgjithshëm i informacioneve anonime të trajtuara është 37.

Përgjithësisht duket se Kosova çalon shumë kur bëhet fjalë për deklarimin e pasurisë të zyrtarëve të saj publik. Gjithsesi bazuar në të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit ka një vetëdijesim edhe në këtë drejtim. Zhvillimi i një strategjie kundër korrupsionit duhet të përfshijë edhe politikat e deklarimit të aseteve, dhe njëkohësisht kjo duhet të jetë pjesë e listës së prioriteteve. Momentalisht, kjo është një politikë e lënë anash, përkundër faktit që pasuria e zyrtarëve të lartë publik është mbledhur dhe rritur në mënyrë të pashpjegueshme për disa vite dhe perceptimit të zakonshëm të përhapur në

mesin e qytetarëve të Kosovës se zyrtarët publik përfaqësojnë shtresën shoqërore më të pasur.

Sistemi i deklarimit të pasurisë nga ana e zyrtarëve, është ndeshur me shumë probleme duke përfshirë madje edhe terminologjinë kontradiktore që përdoret për të plotësuar formularët, përcaktimin e pabazuar të vlerave të pronës pa marrë në konsideratë vlerën e tregut, mungesën e një procesi të qartë të verifikimit apo udhëzimeve që vlerësojnë saktësinë e deklaratave, mungesën e një procedurë të paanshme për të vendosur se cilat deklarata të vlerësohen dhe mungesën e legjislacionit dhe udhëzimeve që identifikojnë kursin e veprimtimit për trajtimin e zyrtarëve publik me pasuri të rritur në mënyrë të dyshimt që nuk ka bazë të saktë të prejardhjes.

Kapitulli VII

Praktika gjyqësore në Republikën e Kosovës lidhur me procedimin dhe gjykimin e korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare

7. 1. Vështrim i përgjithshëm

Eksperienca praktike, performanca e secilit institucion relevant në kontekst të një hulumtimi teorik dhe empirik ka një vlerë dhe rëndësi të veçantë para së gjithash si një formë specifike e verifikimit dhe konfirmimit të asaj që thuhet e pasqyrohet përmes teorisë. Në rastin tonë eksperienca praktike e institucioneve relevante siç janë Gjykatat, apo thënë ndryshe praktika gjyqësore është një referim dhe mbështetje shumë e rëndësishme për paraqitjen analitike të dukurisë së hulumtuar, krahas qasjes teorike-juridike. Nga praktika gjyqësore në Republikën e Kosovës lidhur me trajtimin dhe gjykimin e rasteve të caktuara nga kategoria e veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare i kemi identifikuar dhe përzgjedhur disa nga to si më ilustrueset përmes analizës të cilave do të arrijmë të shohim qasjen dhe punën profesionale, ose të metat dhe mangësitë në punën e gjykatave gjatë trajtimit e gjykimin të kryesve të veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Janë analizuar njëmbëdhjetë aktgjykime, dy aktgjykime liruese e nëntë dënuese, nga dy Gjykata Themelore, Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Gjykata Themelore në Ferizaj. Nga lloji i veprave penale që janë analizuar gjatë hulumtimit të praktikës gjyqësore, dominon përvetësimi në detyrë me tri aktgjykime të analizuar, dy aktgjykime nga ushtrimi i ndikimit, dy shpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, dy aktgjykime të analizuar nga lloji i marrjes së ryshfetit dy nga lloji i dhënies së ryshfetit dhe një aktgjykim është analizuar nga lloji i nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore i cili rezultojë të jetë lirues. Janë analizuar edhe disa aktgjykime tjera, mirëpo për shkak të vëllimit të madh, nuk janë përfshirë në këtë kapitull, analiza e të cilëve aktgjykime rezulton për afërsisht e njëjtë me rezultatin dhe epilogun e analizës dhe shqyrtimit të këtyre njëmbëdhjetë rasteve, lëndëve. Nga intervista dhe konsultimi me menaxhmentin e gjykatës dhe disa gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjakovë lidhur me eksperiencën e tyre rreth kësaj kategorie të veprave penale rezulton konstatimi nga ata se rreth 70% të rasteve të gjykuara nga kjo Gjykatë përfundojnë me aktgjykime liruese si pasojë e mungesës së provave, pasojë kjo e mos kualifikimit adekuat të veprave penale në fazën e ngritjes së aktakuzës.

7.2. Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e shpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar neni 422 i KPK, Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda

Në vijim do ta analizojmë aktgjykimin **PKR nr. 932/13** lidhur me shqyrtimin kryesor i mbajtur me datë 14.03.2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Departamentin e krimeve të rënda ku nga trupi gjykues i përbërë nga tre gjykatës shpallen fajtor të akuzuarit me inicialet N.Z. dhe F. S. për veprat penale nga neni 422 i KPK.

Aspekti deskriptiv

“ I pandehuri N. Z. me datën e pa caktuar të muajit gusht 2012 në cilësinë e personit zyrtar të Inspektorit tatimor në Agjencinë Tatimore të Kosovës (ATK) duke e shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar ka tejkaluar kompetencat e tija, në atë mënyrë që me qëllim që vetes apo tjetrit të i sjell përfitim material, ka rekomanduar të dëmtuarin S. K.-ndërtues privat që të angazhoj për shërbimet e kontabilitetit të akuzuarin e dytë F. S., të cilin e ka njohur më herët e po ashtu dhe ai si person zyrtar si kontabilist privat i licencuar me autorizim nga organet shtetërore kompetente, nuk i ka përmbushur detyrat e tija zyrtare duke mos ia rregulluar dokumentacionin të dëmtuarit sipas ligjeve të ATK-së, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër ku i ka shkelur seriozisht të drejtat e personit tjetër, ka kërkuar dhe ka realizuar 7.500 euro (shtatë mijë e pesëqind euro), kinse për t’ia rregulluar obligimet tatimore pranë ATK-së të dëmtuarit S. K., ashtu që i dëmtuari pas kontakteve me të akuzuarin e dytë me datën 23.08.2012 në restorantin “QAO” në Prishtinë po ashtu edhe me 30.08.2012, i dëmtuari të akuzuarit F. S. ia ka dorëzuar shumën prej 3.000 euro (tremijë) euro në kesh, dhe me datën 04.09.2012 shumën prej 1.000 euro (njëmijë) euro në kesh dhe me datën 18.09.2012 shumën prej 5.000 (pesë mijë euro) po ashtu në kesh, i pandehuri i dytë ka përfituar në këtë mënyrë shumën prej 11.900 euro (njëmbëdhjetë mijë e njëqind euro), në dëm të dëmtuarit S. K., - me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, “ Trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionist mer vendim konform nenit 80 par. 2 nënpar. 2.3 të KPPKR-së për pikat I., II., III., IV. dhe V. **shqiptohet dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj,** të cilin dënim do ta vuaj pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 83 par. 1 të KPKR-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 07.03.2013 deri më 28.06.2013.

1.1. Në bazë të nenit 65 të KPRK-së të pandehurit N. Z. i shqiptohet edhe dënimi plotësues: **ndalim i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik** në kohëzgjatje prej 3(tri) vjetëve, duke filluar nga dita kur përfundon mbajtja e dënimit me burgim.

2. I pandehuri tjetër F. S.

Konform nenit 80 par. 2 nënpar. 2.3 të KPPKR-së për pikat I., II., III., IV. dhe V. shqiptohet **dënim unik me burgim** në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënimi i pandehuri do ta vuaj pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 83 par.1 të KPKR-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 07.03.2013 deri më 28.06.2013.

2. 1. Në bazë të nenit 66 të KPRK-së të pandehurit F. S. i shqiptohet edhe **dënimi plotësues: ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës** në kohëzgjatje prej 3(tri) vjetëve, duke filluar nga dita kur përfundon mbajtja e dënimit me burgim.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohen të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç në shumë prej nga 200 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. “(Aktgjykimi **PKR nr. 932/13**, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i krimeve të rënda).

Aspekti analitik

Nisur nga qasja analitike e këtij aktgjykimi lidhur me veprën penale nga neni 422 të KPK mund të përfundojmë se vendimi i trupit gjykues mbi shpalljen fajtor të dy të akuzuarve për veprën penale bashkëkryerje, si dhe zhvillimi i procedurës penale deri në shqyrtimin kryesor ka pasur ecurinë e vet profesionale e ligjore në harmoni me parimet bazë etike, ligjore dhe është respektuar në përpikëri Kodi i Procedurës Penale i R. të Kosovës i hyr në fuqi në vitin 2013. Nga ky vështrim analitik i kësaj praktike gjyqësore rezulton se dënimi unik prej 2 vjet e gjashtë muaj, për te dy të akuzuarit (si rezultat i katër dënimeve prej shatë muaj burg për secilën pikë të dispozitivit) është

dënim i ulët për veprën penale nga kategoria e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, kurse shqiptimi i dënimeve plotësuese si ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbime publike në kohëzgjatje prej tri viteve të akuzuarve si dhe rekomandimi i të dëmtuarve për në kontest civil janë plotësime të nevojshme si dënime plotësuese për të ndikuar si mekanizëm preventiv ndaj të gjithë zyrtarëve tjerë si kryes potencial të cilët janë të punësuar në administratë publike e shërbime publike. Duke pasur parasysh ecurinë në rritje të numrit të veprave penale të keqpërdorimit me detyrën zyrtare si dhe tendencën e humbjes së besimit të qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore e shërbimeve publike mendojmë se dënimi unik prej dy vjet e gjashtë muaj burgim për bartësit e aktivitetit penal të kësaj kategorie është dënim i ulët dhe kësaj nuk mund të arrihen rezultate të synuara në jetësimin e kauzës për shtet të ligjor e demokraci të qëndrueshme.

7.3 Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e përvetësimit në detyrë neni 425 i KPK, Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda

Në vijim do ta analizojmë aktgjykimin **PKR nr. 351/15** lidhur me shqyrtimin kryesor i mbajtur me datë 03.03. 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Departamentin e krimeve të rënda ku nga trupi gjykues i përbërë nga tre gjykatës shpallë fajtor të akuzuarin me inicialet S.R. për veprat penale nga neni 425 i KPK.

Aspekti deskriptiv

“... sepse në periudhën kohore Janar - Mars të vitit 2015, i pandehuri S. R. në cilësinë e personit zyrtar në Prishtinë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ka bërë prezantimin e rremë të raportit të llogarive duke plotësuar të dhëna të rreme dëftesa-pagesat e të cilëve i kanë bërë pacientët, ashtu që nga këto pagesa ka përvetësuar shumën prej 650 euro (me shkronja: gjashtëqind e pesëdhjetë euro), të cilat i janë besuar në detyrën e tij zyrtare, - me të cilën ka kryer veprën penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 1 të KPRK-së. Andaj, Gjykata në bazë të nenit 425 par. 1 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 75, 76 par. 1 nënpar. 1.6 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 4/katër/MUAJVE si dhe DËNIM ME GJOBË NË SHUMËN PREJ 1.000 euro/Njëmijë/€, të cilat dënime do të ekzekutohen pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. Konform nenit 46 par. 3 të KPRK-së, nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk ka mundësi ta paguaj gjobën e përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim burgu, ku për çdo 20 euro do të vuaj 1(një) ditë burgu.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50/pesëdhjetë/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Obligohet i akuzuari që në emër të dëmit të shkaktuar institucionit përkatës... në Prishtinë të i paguaj shumën prej 650(gjashtëqind e pesëdhjetë euro) me kamatë ligjore sikurse mjetet e deponuara në bankë me afat mbi një vit....

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 1 të KPRK-së, meqë në vendin dhe kohën siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i akuzuari me dashje direkte në cilësinë e personit zyrtar si arkëtar në QKUK-në Prishtinë, ka bërë prezantimin e rremë të raportit të llogarive për periudhën Janar – Mars 2015, duke plotësuar të dhëna të rreme dëftesat-pagesat e të cilëve i kanë bërë pacientët, dhe se nga këto pagesa ka përvetësuar shumën prej 650 euro(me shkronja:gjashtëqind e pesëdhjetë euro), të cilat i janë besuar në detyrën e tij zyrtare.

Gjykata është e bindur se me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së përkatësisht dënimin i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi ndëshkimor që t'i përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventivë e përgjithshme).

Konform nenit 463 par. 1 e 2 të KPPRK-së, obligohet i akuzuari që në emër të dëmit të shkaktuar të i paguaj shumën prej 650(gjashtëqind e pesëdhjetë euro) me kamatë ligjore sikurse mjetet e deponuara në bankë me afat mbi një vit. Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50/pesëdhjetë/€, bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje dhe gjendjen ekonomike të të pandehurit, i cili obligohet që ti paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë. “ (Aktgjykimi **PKR nr. 351/15** Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i krimeve të rënda)

Aspekti analitik

Nisur nga qasja analitike e këtij aktgjykimi lidhur me veprën penale nga neni 425 të KPK mund të përfundojmë se vendimi i trupit gjykues mbi shpalljen fajtor të akuzuarit S.R. për veprën penale **përvetësim në detyrë**, si dhe zhvillimi i procedurës penale deri në shqyrtimin kryesor ka pasur ecurinë e vet profesionale e ligjore në harmoni me parimet bazë etike, ligjore dhe është respektuar në përpikëri Kodi i Procedurës penale i R. të Kosovës i hyr në fuqi në vitin 2013. Nga ky vështrim analitik i kësaj praktike gjyqësore rezulton se dënimi prej katër muajve burgim dhe dënimi me gjobë prej njëmijë euro rezulton të jetë i ulët sipas mendimit tim për veprën penale nga kategoria e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, kurse marrja në konsideratë nga ana e trupit gjykues e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit që në shqyrtimin fillestar nuk e justifikon dënimin e ultë përball perceptimit kolektiv dhe opinionit publik se gjykatat nuk po i dënojnë sa duhet keqpërdoruesit e detyrave zyrtare dhe autorizimeve zyrtare.

Duke pasur parasysh ecurinë në rritje të numrit të veprave penale të keqpërdorimit me detyrën zyrtare si dhe tendencën e humbjes së besimit të qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore e shërbimeve publike, mendoj se dënimi prej katër muaj burgim dhe dënimi me gjobë prej njëmijë euro për bartësin e aktivitetit penal të kësaj kategorie me inicialet S.R. është dënim i ulët dhe kësaj nuk mund të arrihen rezultate të pretenduara në jetësimin e kauzës për shtet ligjor e demokraci të qëndrueshme.

7.4 Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e marrjes së ryshfetit neni 428 i KPK, Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda

Në vijim do ta analizojmë aktgjykimin **PKR. nr. 652/2015** lidhur me shqyrtimin kryesor i mbajtur me datë 05.04. 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Departamentin e krimeve të rënda ku nga trupi gjykues i përbërë nga tre gjykatës shpallë fajtor të akuzuarin me inicialet V. B. për veprat penale nga neni 428 i KPK.

Aspekti deskriptiv

“Janë fajtor për shkak se e akuzuara V. B. Në muajin Gusht të vitit 2015, në cilësinë e prokurores së shtetit, në mënyrë të tërthorët ka pranuar para për vete dhe për të akuzuarin I. K. në mënyrë që të veprojë në pajtim me detyrën e saj zyrtare, në atë mënyrë që duke vepruar si prokurore në çështjen penale PP.I. nr. 298/2014, kundër të pandehurve E., H., A. dhe D. H., në shkëmbim të lirimit të veturave të sekuestruara përkohësisht, familjes H. i janë kërkuar 22.000,00 euro, nga i akuzuari I., përmes të akuzuarit I., të cilën shumë A. H., pasi që paraprakisht i pranon nga fondi i policisë, me datë 06.08.2015 ia dorëzon të akuzuarit I. S., i cili 4.000,00 euro nga ajo shumë i merr për vete, ndërsa shumën prej 18.000,00 euro ia dorëzon të akuzuarit I. K. me destinim përfundimtar të një pjese të kësaj shume tek e akuzuara V. B., ku e njëjta pas pranimi të parave, ka përpiluar kërkesën PP.I. nr. 298/2014 të datës 21.08.2015 për kthimin e sendeve të sekuestruara, dhe është nisur për në Austri, ku gjatë udhëtimit me autobus të linjës Prishtinë – Gracë (Austri), me datë 22.08.2015, në pikë kalimin kufitar në “Merdare”, gjatë kontrollimit nga ana e Policisë i është gjetur në posedim shuma e të hollave prej 5.000,00 euro, të gjitha bankënota të policisë, pjesë e shumës prej 22.000,00 euro që A. H. ia ka dorëzuar të pandehurit I. S., me çka ka kryer veprën penale *marrja e ryshfetit* nga neni 428 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Trupi gjykues i Gjykatës Themelore, Departamenti i krimeve të rënda GJYKON:

Të akuzuarën **V. B.** me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 22.08.2015 e deri me datë 26.11.2015, e të cilin dënim e akuzuara do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe me dënim me gjobë në shumë prej 5.000,00 (pesëmijë) euro, e të cilin

dënim e akuzuara duhet ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 65 të KPRK-së të akuzuarës **V. B.** i shqiptohet dënimi plotësues

NDALIMI I USHTRIMIT TË FUNKSIONEVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE OSE NË SHËRBIMIN PUBLIK

Të akuzuarës V. B. i ndalohet ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik për një periudhë kohore prej 3 (tri) viteve duke filluar nga dita kur e përfundon mbajtjen e dënimit me burgim. ”(Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, PKR. nr. 652/2015, Departamenti i Krimeve të Rënda)

Aspekti analitik

Nisur nga qasja analitike e këtij aktgjykimi lidhur me veprën penale nga neni 428 paragrafi 1 të KPK mund të përfundojmë se vendimi i trupit gjykues mbi shpalljen fajtor të akuzuarit V.B. për veprën penale marrje e ryshfetit, si dhe zhvillimi i procedurës penale deri në shqyrtimin kryesor ka pasur ecurinë e vet profesionale e ligjore në harmoni me parimet bazë etike, ligjore dhe është respektuar në përpikëri Kodi i Procedurës penale i R. të Kosovës i hyr në fuqi në vitin 2013. Nga ky vështrim analitik i kësaj praktike gjyqësore rezulton se dënimi prej tri viteve burgim dhe dënimi me gjobë prej pesëmijë euro si dhe dënimi plotësues ; ndalim i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, rezulton të jetë adekuat sipas mendimit tim për veprën penale nga kategoria e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, kurse plotësimi i dënimit kryesor edhe me dënimin plotësues si; ndalim i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik e bënë këtë vendim të Gjykatës më të akceptueshëm për opinionin publik kur dihet fakti se e akuzuara ka ushtruar funksion me rëndësi në administratën shtetërore.

Duke pasur parasysh ecurinë në rritje të numrit të veprave penale të keqpërdorimit me detyrën zyrtare si dhe tendencën e humbjes së besimit të qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore e shërbimeve publike mendoj se ky vendim i kësaj gjykate në këtë rast duhet të ndikoj pozitivisht në balancimin e drejtësisë të segmenti i nxjerrjes së vendimeve të drejta e të paanshme gjyqësore, kështu duke ndikuar pozitivisht në kthimin e besimit të qytetarëve të drejtësia e sundimi i ligjit.

7.5. Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e marrjes së ryshfetit neni 428 i KPK, Gjykata Themelore Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda

Në vijim do ta analizojmë aktgjykimin **PKR. nr. 40/15** lidhur me shqyrtimin kryesor i mbajtur me datë 18.02. 2015 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në Departamentin e krimeve të rënda ku nga trupi gjykues i përbërë nga tre gjykatës shpallë fajtor të akuzuarin me inicialet N. V. për veprat penale nga neni 428 i KPK.

Aspekti deskriptiv

I pandehuri: **N. V.** i lindur me 04.04.1972 në fsh. D. K. Kaçanik, me vendbanim në Ferizaj, nga i ati B. dhe e ëma H., e gjinisë Sh., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar babë i dy fëmijëve,

ËSHTË FAJTOR

Sepse: me dt. 16 qershor 2014 rreth orës 10:20 në Ferizaj, në Spitalin Rajonal në Ferizaj, në cilësinë e personit zyrtarë në mënyrë të drejtpërdrejtë ka kërkuar dhuratë në pajtim me detyrën e tij të punës, në atë mënyrë që ka kërkuar 100euro nga personi J. R. – baba i fëmijës L. R. i moshës 9 muajsh, për të kryer anestezionin, kështu që i dëmtuari pas operacionit të fëmijës detyrohet që të i jep 100 euro dhe atë dy bankënota 50 euro me numër serik X0358628372 dhe Z71573251176, me që i pandehuri nuk i kishte përshkruar terapinë pa i ja dhënë paratë, të cilat para i pandehuri i fut në xhepin e majtë të pantallonave kurse në rastin e kontrollimit nga ana e policisë i konfiskohen përkohësisht.

- Me këtë rast ka kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të neneve 146, 328 par. 2 si dhe neneve 3, 6, 11, 15, 34, 36, 38, 64, 71, 73 të KPK-së dhe nenit 391 të KPPK- së.

CAKTON

Për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par. 1 të KPRK-së dënim burgimi në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**. Dhe dënim me gjobe në lartësi prej **600 (gjashtëqind) euro**, i pandehuri, obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të

paguajë shumë prej 30 euro në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit. Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 14.04.2015 në të cilin Prokurori i Shtetit R. M., në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri N. V., në shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranojë fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nen. 248 të KPPK-së ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke theksuar se i pranon në tërësi veprimet të cilat janë përshkruar në dispozitiv të aktakuzës duke shtuar se “për këtë vepër jam penduar thellë dhe kam menduar se kjo nuk përbën vepër penale.”

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së, meqë me datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri me qëllim dhe dashje direkt duke qenë plotësisht i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe për pasojat. Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, kështu bëri zbutjen e dënimeve dhe të pandehurit i vërtetoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **6/gjatë/muaj dhe dënimin me gjobë në lartësi prej 600 (gjashtëqind) euro**, me bindjen se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve, në kuptim të preventives speciale dhe të përgjithshme.

Konform nenit 450 par. 2 nën par. 2.6 dhe par. 3 dhe neni 451 të KPPRK-së, i pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 30 euro, e cila shumë është caktuar duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës dhe gjendjen ekonomike të pandehurit.

(Gjykata Themelore në Ferizaj, **PKR. nr. 40/15** Departamenti i krimeve të rënda)

Aspekti analitik

Nisur nga qasja analitike e këtij aktgjykimi lidhur me veprën penale nga neni 428 paragrafi 1 të KPK mund të përfundojmë se vendimi i trupit gjykues mbi shpalljen fajtor të akuzuarit N.V. për veprën penale marrje e ryshfetit, si dhe zhvillimi i procedurës penale deri në shqyrtimin kryesor ka pasur ecurinë e vet profesionale e ligjore në harmoni me parimet bazë etike, ligjore dhe është respektuar në përpikëri Kodi i Procedurës penale i R. të Kosovës i hyr në fuqi në vitin 2013. Nga ky vështrim analitik i kësaj praktike gjyqësore rezulton se dënimi me gjobë prej gjashtëqind euro, rezulton të jetë i vogël sipas mendimit tim për veprën penale nga kategoria e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, marrja e ryshfetit, kur dihet fakti se korrupsioni është një “epidemi” që ngulfat funksionimin e shtetit dhe administratës në përgjithësi dhe dënimi vetëm me gjobë mendoj se është i ulët kur dihet fakti se bëhet fjalë për një keqpërdorues me profesion mjek specialist.

7.6 Vështrim analitik i një aktgjykimi për veprën penale, ushtrimi i ndikimit, neni 431 i KPK, Gjykata Themelore Ferizaj, PKR 108/15 Departamenti për Krime të Rënda

Në vijim do ta analizojmë aktgjykimin **PKR 108/15** lidhur me shqyrtimin kryesor i mbajtur me datë 15.03.2016, 12.04.2016, 19.05.2016 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në Departamentin e krimeve të rënda ku nga trupi gjykues i përbërë nga tre gjykatës shpallë fajtor të akuzuarin me inicialet F. A. për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 i KPK.

Aspekti deskriptiv

“ I akuzuari **F. A.**, nga Gjilani, i lindur më datën 26.05.1957 në fsh.G. K.Gjilan,, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, menagjer i Kompanisë së sigurimit,

ËSHTË FAJTOR

Sepse në muajin nëntor të vitit 2013, në Ferizaj, në pompën e derivateve (...), në mënyrë të drejtpërdrejt ka marr të holla në shumë prej 7000 (shtatëmijë) Euro nga H. M., në mënyrë që të ushtroj ndikim të padrejtë në vendimmarrje tek personat zyrtar-gjyqtar e Prokuror, në atë mënyrë që i pandehuri përmes bisedës telefonike me bashkëshorten e të dëmtuarit, i ka premtuar se me ndërmjetësimin e tij do ta lirojnë E. nga qendra e paraburgimit dhe se duhet ti siguroni 7000 Euro sa më shpejt që është e mundur.

-me këtë kreu veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par 1 të KPK-së.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe në bazë të nenit 4,6,7,17,21,41,45dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365të KPPK-së të **akuzuarin, F. A.**

GJYKON

Me dënim burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim i akuzuari do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Obligohet i akuzuari që të dëmtuarit E. M. në emër të kërkesës pasurore juridike të ia paguaj shumën prej 7.000 (shtatëmijë) euro, në afatin prej 15 ditëve nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar. Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 euro, në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Gjykata ka konstatuar përtej dyshimit të bazuar se në veprimet e të akuzuarit janë prezentë të gjithë elementët objektive dhe subjektive të veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par. 1 të KPRK-së, meqë i akuzuari me qëllim të ndikimit tek personat zyrtar-prokurorët dhe gjyqtarët, kinse për ta liruar të dëmtuarin E. M. nga paraburgimi, nga bashkëshortja e të dëmtuarit E. M. ka kërkuar të hollat në shumë prej 7000 euro, (Gjykata Themelore Ferizaj, PKR 108/15 Departamenti për Krime të Rënda)

Aspekti analitik

Nisur nga qasja analitike e këtij aktgjykimi lidhur me veprën penale nga neni 431 paragrafi 1 të KPK mund të përfundojmë se vendimi i trupit gjykues mbi shpalljen fajtor të akuzuarit F.A. për veprën penale ushtrimi i ndikimit , si dhe zhvillimi i procedurës penale deri në shqyrtimin kryesor ka pasur ecurinë e vet të rregullt ligjore në harmoni me parimet bazë etike, ligjore dhe është respektuar në përpikëri Kodi i Procedurës penale i R. të Kosovës i hyr në fuqi në vitin 2013. Nga ky vështrim analitik i kësaj praktike gjyqësore rezulton se dënimi me një vit burgim, rezulton të jetë i vogël sipas mendimit tim për veprën penale nga kategoria e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ushtrimi i ndikimit, kur dihet fakti se kategoria e veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare është një dukuri negative në rritje “epidemi “që ngulfat funksionimin e shtetit ligjor dhe administratës në përgjithësi dhe unë mendoj se në këtë rast kemi të bëjmë edhe me veprën penale mashtrim, pra kualifikimi i veprës duhet të merr edhe një dimension tjetër, sipas mendimit tim bëhet fjalë më shumë për veprën penale mashtrim se sa ushtrim të ndikimit sepse ushtrimi i ndikimit nuk është realizuar asnjëherë kurse mashtrimi ka ndodhur dhe pasojat e veprës penale janë evidente sepse pason i dëmtuari, pasoja e veprës penale të kryer.

7.7. Vështrim analitik i një aktgjykimi nga kategoria e veprës penale përvetësim në detyrë, neni 425 par. 2 të KPK, Gjykata Themelore Ferizaj, PKR 167/15 Departamenti për Krime të Rënda

Në vijim do ta analizojmë aktgjykimin **PKR 167/15** lidhur me shqyrtimin kryesor i mbajtur me datë 31.03.2016 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në Departamentin e krimeve të rënda ku nga trupi gjykues i përbërë nga tre gjykatës shpallë fajtor të akuzuarin me inicialet E. H. për veprën penale përvetësim në detyrë nga neni 425 i KPK.

Aspekti deskriptiv

“ I pandehuri **E. H.** shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar baba i shtatë fëmijëve, me profesione teknik i ekonomisë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: me dt 31.10.2005 gjerë në fillim të vitit 2015 i pandehuri në cilësinë e personit zyrtar - arkëtar në një ndërmarrje publike në Ferizaj me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ka përvetësuar pasurin-parat të cilat i janë besuar për shkak të detyrës së tij dhe në shumë prej 18.705.32 euro (tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesë euro e tridhjetë e dy cent) në arkën me numër kantar 2431 të cilat para janë grumbulluar nga inkasantët dhe pagesat tjera nga klientët, ku i pandehuri ka tërhequr para në formë të akontacionit në mënyrë të vazhdueshme dhe i ka kthyer vetëm 200 (dy qind) euro ndërsa pjesën tjetër të parave nuk e ka kthyer me ç’ rast ka dëmtuar kompaninë publike në vlerë prej 18.505.32 euro ku gjatë një kontrolli nga ana e menaxhmentit të kompanisë është vërejtur mungesa e parave.

- me të cilën kreu veprën penale përvetësim në detyrë nga neni 425 par. 2 të KPRK-se

Në bazë të dispozitës së lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 49, 50, 51, 52, dhe 73, të KPRK-së si dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurit

I caktohet **dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1/një/viti, si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 500/pesëqind/ Euro**, te cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në periudhën kohor prej **2/dy/vite** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i pandehuri që kompanisë së dëmtuar në Ferizaj të i ja kthejë dëmin e mbetur të shkaktuar në vlerë prej 10,405.28 (dhjetëmijë e katërqind e pesë euro e njëzet e tetë cent), në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyruar. Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) € në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit.”

(Gjykata Themelore Ferizaj, **PKR 167/15** Departamenti për Krime të Rënda)

Aspekti analitik

Nisur nga qasja analitike e këtij aktgjykimi lidhur me veprën penale nga neni 425 paragrafi 2 të KPK mund të përfundojmë se vendimi i trupit gjykues mbi shpalljen fajtor të akuzuarit E. H. për veprën penale përvetësimi në detyrë, si dhe zhvillimi i procedurës penale deri në shqyrtimin kryesor ka pasur ecurinë e vet të rregullt ligjore në harmoni me parimet bazë etike, ligjore dhe është respektuar në përpikëri Kodi i Procedurës penale i R. të Kosovës i hyr në fuqi në vitin 2013. Nga ky vështrim analitik i kësaj praktike gjyqësore rezulton se dënimi me një vit burgim me kusht, e dënim me gjobë prej pesëqind euro rezulton të jetë dënim i vogël sipas mendimit tim për veprën penale nga kategoria e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, përvetësimi në detyrë, kur dihet fakti se kategoria e veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare është një dukuri negative në rritje “epidemi “që ngulfat funksionimin e shtetit ligjor dhe administratën në përgjithësi dhe unë mendoj se në këtë rast kemi të bëjmë edhe me vlerë të konsideruar parash, respektivisht dëmtim të konsideruar të një organizate, pra dënimi me kusht konsideroj se nuk është dënim që përcjell mesazh parandalues te kryesit potencial të kësaj kategorie të veprave penale si dhe nuk mund të ndikoj te qytetarët që tu kthehet besimi në sistemin e drejtësisë objektiv i synuar i shteteve demokratike.

7.8 Vështrim analitik i një aktgjykimi për veprën penale, ushtrimi i ndikimit, neni 431 i KPK, Gjykata Themelore Ferizaj, P. nr. 1503/ 2012 Departamenti për Krime të Rënda

Në vijim do ta analizojmë aktgjykimin **P. nr. 1503/2012** lidhur me shqyrtimin kryesor i mbajtur me datë dhe më 16.03.2016, në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në Departamentin e krimeve të rënda ku nga trupi gjykues i përbërë nga tre gjykatës shpallë fajtor të akuzuarin me inicialet A. S. për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 i KPK.

Aspekti deskriptiv

“ I akuzuari **A. S.** me banim në Ferizaj, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar i martuar prind i katër fëmijëve, me gjendje të dobët ekonomike, mbrohet në liri,

E s h t ë fajtor

Sepse nga dt. 31.03.2011 deri më 26.07.2011 në Ferizaj ka pranuar oferta për të ushtruar ndikim mbi vendimmarrje tek personat zyrtar B. I. dhe R. P., që të dy ekzaminues në Ministrinë e Infrastrukturës – Departamenti i automjeteve në Ferizaj, për t’iu ndihmuar kandidatëve N. Q., J. H., G. B.,...në dhënien e provimit për patentë shofer, duke marrë nga këta kandidat nga 50 – 650€ për të ndikuar tek personat zyrtar që kandidatët e lartpërmendur të kalojnë në testin me shkrim dhe vozitjen për patentë shofer,

- me këtë ka kryer veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par. të KPK-së, Andaj gjykata ne bazë të neneve 3,6,11,15,34,43,64 e 345 par. 1 të KPK-së si dhe të nenit 365 të KPP-së,

E GJYKON

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet me kusht që i akuzuari në afat prej 1 viti e 6 muaj, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale (koha e verifikimit).

Obligohet që Gjykatës, të ia paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 50€, në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në shqyrtimin gjyqësor, Gjykata ka shqyrtuar të gjitha provat e çështjes penale, i vlerësoi një nga një dhe në ndërlidhje reciproke njëra me tjetrën në kuptim të nenit 361 par. 2 të KPPK-së, në bazë të të cilave vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv. Trupi gjykues, pasi vlerësoi të gjitha provat e çështjes të ndërlidhura me veprimet e të akuzuarit A. S., duke u bazuar në nenin 360 par. 2 të KPP-së, konstatoi se në veprimet e të akuzuarit, ekzistojnë elementet e veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par. 1 të KPK-së, për të cilën vepër i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe e shpalli fajtor si në dispozitiv të aktgjykimit. Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar me burgim me kusht është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësin penale të të akuzuarit, dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i paraparë në nenin 34 të KPK-se. **(Gjykata Themelore Ferizaj, P. nr. 1503/ 2012 Departamenti për Krime të Rënda)**

Aspekti analitik

Nisur nga qasja analitike e këtij aktgjykimi lidhur me veprën penale nga neni 431 paragrafi 1 të KPK mund të përfundojmë se vendimi i trupit gjykues mbi shpalljen fajtor të akuzuarit A. S. për veprën penale ushtrimi i ndikimit , si dhe zhvillimi i procedurës penale deri në shqyrtimin kryesor ka pasur ecurinë e vet të rregullt ligjore në harmoni me parimet bazë etike, ligjore dhe është respektuar në përpikëri Kodi i Procedurës penale i R. të Kosovës i hyrë në fuqi në vitin 2013. Nga ky vështrim analitik i kësaj praktike gjyqësore rezulton se dënimi me një vit burgim me kusht, rezulton të jetë i vogël sipas mendimit tim për veprën penale nga kategoria e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ushtrimi i ndikimit, kur dihet fakti se kategoria e veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare është një dukuri negative në rritje “epidemi “që ngulfat funksionimin e shtetit ligjor dhe administratën në përgjithësi dhe unë mendoj se në këtë rast kemi të bëjmë edhe me veprën penale mashtrim, pra kualifikimi i veprës duhet të merr edhe një dimension tjetër, sipas mendimit tim bëhet fjalë më shumë për veprën penale mashtrim se sa ushtrim të ndikimit sepse ushtrimi i ndikimit nuk është realizuar asnjëherë kurse mashtrimi ka ndodhur dhe pasojat e veprës penale janë evidente sepse pason dëmi, përkatësisht pasojnë disa të dëmtuar, pra dënimi vetëm me një vit burgim me kusht në periudhë kohore verifikuese prej një vit e gjysmë është vërtet i vogël.

7.9 Vështrim analitik i një aktgjykimi për veprën penale, dhënia e ryshfetit, neni 429 i KPK, Gjykata Themelore Ferizaj, PKR.nr.88/ 2015 Departamenti për Krime të Rënda

Në vijim do ta analizojmë aktgjykimin **PKR. nr. 88 /2015** lidhur me shqyrtimin kryesor i mbajtur me datë 24.12.20015 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në Departamentin e krimeve të rënda ku nga trupi gjykues i përbërë nga tre gjykatës shpallë fajtor të akuzuarin me inicialet H.H. për veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 i KPK.

Aspekti deskriptiv

“Gjykata Themelore në Ferizaj shpall fajtor të akuzuarin Haziz Hajdari se me datë 23.01.2015, në mënyrë të kundërligjshme i ka dhënë personit zyrtar – policit F. B. dhuratë dhe atë 3 metra dru të cilat ia ka dërguar në shtëpinë e tij në fshatin K. me qëllim që personi zyrtar të mos veprojnë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, pra që ti ndihmojë në transportimin ilegal të druve për shitje duke e njoftuar se në cilën rrugë gjenden patrullat policore,

Me këtë ka kryer veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,21,41, 43, 45, 73, 75, 422 par. 1 e 429 par. 1 KPRK-së si dhe të nenit 365 të KPP-së,

GJYKON

Të akuzuarin **H. H.** me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 muaj.

Dënimin e shqiptuar me burgim, do ta vuaj pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë. Obligohet që Gjykatës, të ia paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 50 €, në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë.

Në shqyrtimin gjyqësor, Gjykata ka paraqitur të gjitha provat e çështjes penale, i vlerësoi një nga një dhe në ndërlidhje reciproke njëra me tjetrën në kuptim të nenit 361 par. 2 të KPPK-së, në bazë të të cilave vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv. Gjykata është e bindur se dënimet e shqiptuara me burgim dhe i zëvendësuar me dënim gjobe ndaj të akuzuarit H. H. janë në harmoni me peshën e veprës penale,

me shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se me dënimet e tilla do të arrihet qëllimi i paraparë në nenin 41 të KPRK-se, me bindje se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë që në të ardhmen i akuzuari mos të kryej vepra të tilla dhe të tjera penale – si preventivë speciale dhe njëherazi do të ndikoj të personat e tjerë në parandalimin e kryerjes së veprave të tilla penale – preventiva e përgjithshme.

Aspekti analitik

Nisur nga qasja analitike e këtij aktgjykimi lidhur me veprën penale nga neni 429 paragrafi 1 të KPK mund të përfundojmë se vendimi i trupit gjykues mbi shpalljen fajtor të akuzuarit H.H. për veprën penale dhënia e ryshfetit, si dhe zhvillimi i procedurës penale deri në shqyrtimin kryesor ka pasur ecurinë e vet të rregullt ligjore në harmoni me parimet bazë etike, ligjore dhe është respektuar në përpikëri Kodi i Procedurës penale i R. të Kosovës i hyrë në fuqi në vitin 2013. Nga ky vështtrim analitik i kësaj praktike gjyqësore rezulton se dënimi me burgim prej kohëzgjatjeje prej tre muaj, rezulton të jetë adekuat sipas mendimit tim për veprën penale nga kategoria e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, dhënia e ryshfetit, kur dihet fakti se korrupsioni nuk do të mund të zhvillohet pa qenë edhe pala tjetër, dhënësi i ryshfetit. Unë mendoj se inkriminimi i dhënies së ryshfetit e sidomos gjykimi dhe dënimi i kryerësve të këtyre veprave do të ndikoj në vetëdijesimin e qytetarëve dhe shtimin e përgjegjësisë së tyre për të mos ndikuar në punën zyrtare të zyrtarëve publik përmes mitdhënies, e cila siç u tha më lartë është vepër penale e dënuar edhe me burgim.

7.10 Vështrim analitik i një aktgjykimi për veprën penale, përvetësimi në detyrë, neni 425 par. 2 i KPK, Gjykata Themelore Ferizaj, PKR. 208 / 2015 Departamenti për Krime të Rënda

Në vijim do ta analizojmë aktgjykimin **PKR 208/15** lidhur me shqyrtimin fillestar i mbajtur me datë 31.03.2016 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në departamentin e krimeve të rënda ku nga trupi gjykues i përbërë nga tre gjykatës shpallë fajtor të akuzuarën me inicialet K.G. për veprën penale përvetësim në detyrë nga neni 425 par. 2. i KPK.

Aspekti deskriptiv

“ E pandehura **K. G.** nga Ferizaj ka të kryer shkollën e mesme, me profesion arkëtare, e gjendjes së varfër ekonomike, është fajtor **sepse:** me dt. 15.06.2013 në bankën NLB-në Prishtinë, filiali rr.”Rexhep Bislimi” në Ferizaj e pandehura me kodin e arkës 741 në cilësinë e personit zyrtar si arkëtare (trezoriste) përmes domenit të saj (USER NAME) me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka përvetësuar pasurinë – parat të cilat i janë besuar për shkak të detyrës dhe pozitës së saj, në atë mënyrë që ka tërhequr para në trezorin e bankës për nevojat e veta personale, duke ndërhyrë pa autorizim, në atë mënyrë që ka vënë nënshkrimin e vetë në fletëtërheqjet dhe fletëdeponimet, në kontot e 5 klientëve të Bankës këssoj duke përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme shuma të konsideruara parash.... **me** çka kreu veprën penale në vazhdim përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 2 të KPRK-se.

Në bazë të dispozitës së sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75, dhe 76, të KPRK-së si dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurën e,

G J Y K O N

I caktohet **dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1/një/viti,** i cili nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura në periudhën kohore prej **2/dy/vite** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, dhe Dënim me gjobë në lartësi prej 500/pesëqind/ Euro, të cilin dënim është e obliguar që ta paguaj ne afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prere. Në dënimin e shqiptuar

me gjobë llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim nga dt. 10.08.2015 deri me dt. 13.08.2015.

Obligohet e pandehura që të dëmtuarës NLB Bankë në Prishtinë, në emër të kërkesës pasurore - juridike t'ia kthej dëmin e mbetur të shkaktuar në shumë prej 12,900.00 (dymbëdhjetë mijë e nëntëqind) euro, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.

Obligohet e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro) në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës formësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në vazhdim përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 2 të KPRK-së. **(Gjykata Themelore Ferizaj, PKR. 208 / 2015 Departamenti për Krime të Rënda)**

Aspekti analitik

Nisur nga qasja analitike e këtij aktgjykimi lidhur me veprën penale nga neni 425 paragrafi 2 të KPK mund të përfundojmë se vendimi i trupit gjykues mbi shpalljen fajtor të akuzuarit K. G. për veprën penale përvetësimi në detyrë, si dhe zhvillimi i procedurës penale deri në shqyrtimin kryesor ka pasur ecurinë e vet të rregullt ligjore në harmoni me parimet bazë etike, ligjore dhe është respektuar në përpikëri Kodi i Procedurës penale i R. të Kosovës i hyrë në fuqi në vitin 2013. Nga ky vështrim analitik i kësaj praktike gjyqësore rezulton se dënimi me një vit burgim me kusht, rezulton të jetë i vogël sipas mendimit tim për veprën penale nga kategoria e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, përvetësim në detyrë, kur dihet fakti se kategoria e veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare është një dukuri negative në rritje “epidemi” që ngulfat funksionimin e shtetit ligjor dhe administratën në përgjithësi dhe nëse e bëjmë një krahasim me praktikën gjyqësore për vepër të kategorisë së njëjtë të zhvilluar e gjykuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda atëherë nga ky krahasim rezulton se për vepër të njëjtë në kushte e rrethana relativisht të njëjta, trupi gjykues në Gjykatën Themelore në Prishtinë e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar e dënuar me 4 muaj burgim të akuzuarin për këtë lloj vepre gjë

që në fund na jepë të drejt ky fakt se në Gjykatat e Republikës së Kosovës zbatohet “një politikë e butë “ ndëshkimore ndaj kryerësve të veprave penale të kategorisë së keqpërdorimit të detyrës zyrtare e në veçanti te vepra penale e përvetësimit në detyrë.

7.11 Vështrim analitik i një aktgjykimi për veprën penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-se, Gjykata Themelore Ferizaj, PKR. nr. 69/15 Departamenti për Krime të Rënda

Në vijim do ta analizojmë aktgjykimin **PKR nr. 69/15** lidhur me shqyrtimin kryesor i mbajtur me datë 29 dhjetor 2015 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në Departamentin e krimeve të rënda.

Aspekti deskriptiv

“ I akuzuari: **B. N.**, i lindur në Gjilan, me vendbanim në Shtërpçë, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, i akuzuari: **A. R.**: komuna e Shtërpçës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.2 dhe 1.3 të KPPK-së, ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale, dhe nuk është provuar se të akuzuarit në bashkëkryerje të kenë kryer veprën penale: keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-se:

LIROHEN NGA AKUZA

Sepse: nuk është provuar se të akuzuarit të kenë kryer në bashkëkryerje veprën penale: keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-se dhe se veprimet e të akuzuarve përbëjnë shkelje administrative të cilat janë bërë nën lajthim faktik përkatësisht juridik

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. Me provat e proceduara në shqyrtimin publik gjyqësor dhe vlerësimin e tyre veç e veç dhe në lidhje me prova tjera konform nen. 364 të KPPK-së, Gjykata gjeti se nuk u provua se të pandehurit B. N. dhe A. R. ta kenë kryer veprën penale siç i ngarkon aktakuza: keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-se.

Trupi gjykues pasi vlerësoi dëshmitë e dëshmitarëve, provat materiale dhe mbrojtjen e të akuzuarit, konstatoi se nuk është arritur që të vërtetohet përtej dyshimit të

bazuar se në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohen. Trupi gjykues vlerësoi se në rastin konkret me veprimet e tyre të pandehurit kanë rënë ndesh me nenin 34 të Ligjit të Prokurimit Publik dhe se ato veprime të ndërmarra të njëjtit janë shkelje administrative të kryera nën lajthimin faktik dhe juridik.

Duke pas parasysh faktin se gjykata me rastin e vlerësimit dhe vendosjes, ka obligim ligjor që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme, pra faktet që shkojnë në favor apo në disfavor të pandehurit, e në veçanti duke u ndërlidhur me parimin e **prezumimit të pafajësisë**, neni 3 i KPPK-së dhe me parimin **“in dubio pro reo”** se të gjitha mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal duhet të interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij. Prandaj sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret me provat e propozuara dhe të zbatuara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar se te pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata në kuptim të nen. 364 par. 1 të KPPRK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. **(Gjykata Themelore Ferizaj, PKR. nr. 69/15 Departamenti për Krime të Rënda)**

Aspekti analitik

Nisur nga qasja analitike e këtij aktgjykimi lidhur me veprën penale nga neni 422 paragrafi 2 të KPK mund të përfundojmë se vendimi i trupit gjykues mbi refuzimin e akuzës për dy të pandehurit është i drejtë dhe në harmoni me kodin penal dhe kodin e procedurës penale të R. të Kosovës, si dhe zhvillimi i procedurës penale deri në shqyrtimin kryesor ka pasur ecurinë e vet të rregullt ligjore në harmoni me parimet bazë etike, ligjore dhe është respektuar në përpikëri kodi i procedurës penale i R. të Kosovës i hyrë në fuqi në vitin 2013. Nga ky vështrim analitik i kësaj praktike gjyqësore rezulton se Gjykata si organ i pavarur në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi e në administrim autonom të provave shpall të pafajshëm të akuzuarit e deritashëm pasi që organi i akuzës nuk mund të provoj akuzën e ngritur ndaj tyre dhe kësaj zbaton drejtësinë në nivelin e kësaj shkallshmërie duke kontribuar në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj sistemit të drejtësisë në vend.

7.12 Vështrim analitik i një aktgjykimi për veprën penale, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore e sanksionuar sipas nenit 432 të KPK-se. Gjykata Themelore Ferizaj, PKR. nr. 25/15 Departamenti për Krime të Rënda

Në vijim do ta analizojmë aktgjykimin **PKR, nr. 25 /15** lidhur me shqyrtimin gjyqësor i mbajtur në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në Departamentin e krimeve të rënda. Ky është një aktgjykim lirues për veprën penale të pretenduar nga ana e Prokurorisë se ka ndodhë vepra penale, nxjerrja e kundërligjshme e vendimit gjyqësor e sanksionuar me nenin 432 të KPK, vepër kjo më e rrallë e hasur gjatë hulumtimit tonë në praktiken gjyqësore.

Aspekti deskriptiv

“I akuzuari: **B. Y.** punon si gjyqtar, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar. Shtetas i Republikës së Kosovës, i akuzuari: **N. H.**, punon si ekspert gjyqësor i martuar baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.2 dhe 1.3 të KPPK-së, meqë ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale, dhe nuk është provuar se të akuzuarit **B. Y.** të ketë kryer veprën penale: nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore e sanksionuar sipas nenit 432 të KPK-së ndërsa i pandehuri **N. H.** të ketë kryer veprën penale: keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar sipas nenit 422 par. 2 nënpar 2,2 e në lidhje me par. 1 të KPK-së, të njëjtit LIROHEN NGA AKUZA “ (Gjykata Themelore Ferizaj, PKR. nr. 25/15 Departamenti për Krime të Rënda)

Aspekti analitik

Nisur nga qasja analitike e këtij aktgjykimi lidhur me veprën penale të pretenduar nga neni 432 të KPK mund të përfundojmë se vendimi i trupit gjykues mbi refuzimin e akuzës për dy të pandehurit është i drejtë dhe në harmoni me kodin penal dhe kodin e procedurës penale të R. të Kosovës, si dhe zhvillimi i procedurës penale deri në shqyrtimin kryesor ka pasur ecurinë e vet të rregullt ligjore në harmoni me parimet

bazë etike, ligjore dhe është respektuar në përpikëri Kodi i Procedurës penale i R. të Kosovës i hyrë në fuqi në vitin 2013. Nga ky vështrim analitik i kësaj praktike gjyqësore rezulton se Gjykata si organ i pavarur në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi e në administrim autonom të provave shpall të pafajshëm të akuzuarit e deritashëm pasi që organi i akuzës nuk mund të provoj akuzën e ngritur ndaj tyre dhe këssoj zbaton drejtësinë në nivelin e kësaj shkallshmërie duke kontribuar në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj sistemit të drejtësisë në vend. Njëkohësisht kjo lëndë, analiza e këtij aktgjykimi konfirmon në praktikë se edhe gjyqtarët, ekspertët gjyqësor dhe të tjerët mundë të jenë çështje, lëndë shqyrtimi në procesin gjyqësor dhe epilogu duhet të jetë rezultat i të provuarit të veprës penale të aktgjykimi dënues dhe rezultat i pafuqisë së të provuarit të veprës të aktgjykimi lirues.

Përfundimi

Nga shtjellimi teorik i kësaj problematike përmes edhe pjesës hulumtuese, mund të përfundojmë se keqpërdorimi i detyrës zyrtare i manifestuar në shumë forma të parapara me kodin penal të Kosovës është njëra ndër sfidat serioze të shtetit të Kosovës, ngase kjo dukuri e ndërlidhur ngushtë me korrupsionin e, ky i fundit edhe me krimin e organizuar paraqesin rrezik për demokracinë dhe pengesë serioze për ndërtimin e shtetit ligjor, objektiv ky i shtetit të Ri. Gjatë shtjellimit analitik të kësaj problematike ka rezultuar se faktorët kryesor që ndikojnë në dukurinë e keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Republikën e Kosovës janë ;

- mungesa e përkushtimit të duhur dhe efikasitetit të nevojshëm të sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial, si dhe mungesa e vullnetit politik të strukturave shtetërore, e cila në mënyrë indirekte ka ndikuar, (ndërhyrë) në pavarësinë formale juridike të sistemit të drejtësisë dhe krijimin e një vartësie kontekstuale funksionale të këtij të fundit.
- Sa i përket formave më të shpeshta të kryerjes së veprave penale nga kategoria e veprave të keqpërdorimit të detyrës zyrtare ka rezultuar se veprat që ndërlidhen me ryshfetin dhe miton janë më të shpeshta, shpërdorimi i detyrës zyrtare, përvetësimi në detyrë, ushtrimi i ndikimit.
- Ndërsa sa i përket motiveve të kryesit e kësaj kategorie të veprave penale, motivi unik në shumicën dominuese të rasteve është siguri i dobisë materiale apo avantazhe tjera për veten dhe familjen në rrugë të kundërligjshme në dëm të interesit publik dhe institucioneve ku ata punojnë.
- Sa i përket legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, konkretisht Kodit penal i cili hyri në fuqi në Janar të vitit 2013 dhe ligjeve tjera pozitive të cilat direkt apo tërthorazi rregullojnë disa nga veprat penale të kësaj kategorie, mund të themi se Republika e Kosovës ka infrastrukturë të bollshme juridike për parandalimin dhe luftimin e kësaj kategorie të veprave penale por shikuar rezultatet e kësaj lufte dhe gjendjen reale rreth prezencës dhe intensitetit të kësaj dukurie (korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare) mund të

përfundojmë me përgjegjësi se implementimi në praktikë i kësaj infrastrukture ligjore dhe funksionalizimi i disa agjencive (si psh.: Agjencia Kundër Korrupsionit), në praktikë çalon dukshëm dhe gjendja reale nuk është fare e kënaqshme, së paku deri në fund të vitit 2014.

Këtë konkludim e mbështesim në gjetjet kërkimore nga pjesa hulumtuese empirike e bërë për periudhën kohore të fokusuar në Republikën e Kosovës me ç'rast përfundojmë se sfidë serioze për Republikën e Kosovës, sidomos sistemin e sigurisë do të jetë luftimi i korrupsionit dhe i veprave tjera të keqpërdorimit të detyrës zyrtare si një dukuri shqetësuese, e cila ka ndikuar dhe ndikon me të madhe në humbjen e besimit të qytetarëve në shtetin ligjor si synim afatmesëm i institucioneve të Republikës së Kosovës dhe synimit afatgjatë për tu bërë pjesë e familjes së madhe evropiane.

- Po ashtu edhe mos bashkëpunimi i duhur i prokurorisë, policisë dhe gjyqësisë ishte njëra ndër vështirësitë dhe pengesat e mos luftimit të duhur dhe mos procedimit të gjyimit të rasteve të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.
- Nepotizmi dhe lidhjet klanore si dy dukuri negative janë të pranishme në institucionet e Kosovës dhe pikërisht lidhja e fuqishme e nepotizmit dhe ajo klanore janë faktorët gjenerues të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga se në këtë kontekst nepotizmi dhe lidhja klanore rezultojnë të jenë shkaktarë dhe pasojë të keqpërdorimeve të ndryshme në kuadër të kategorisë së veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.
- Militantizmi partiak, dukuri e pashmangshme në shoqëritë e pasluftës dhe presioni politik kanë vështirësuar performancën cilësore të zyrtarëve publikë në Republikën e Kosovës, duke shkaktuar shpeshherë nga ana e tyre shkelje të dispozitave ligjore, përkatësisht kryerjen e veprave penale të kategorisë së keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Pikërisht lidhjet farefisnore, përkatësia partiake, e afërsitë tjera janë paraqitur si dukuri përcjellëse negative e administratës publike në kuptimin e gjerë të fjalës dhe zyrtareve tjerë nga shtyllat tjera të pushtetit.
- Duhet thënë krejtë në fund si konkludim gjeneral se veprat penale të kategorisë së Korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare në Republikën

Kosovës në intenzitetin e manifestuar në periudhën e fokusuar kohore , e të paraqitur përmes këtij studimi, atakojnë sigurinë Juridike të qytetarëve dhe pengojnë funksionimin dhe fuqizimin e shtetit ligjor parakusht për një demokraci të mirëfilltë dhe mirëqenje të qëndrueshme për qytetarët.

Nëse i qasemi gjendjes reale nga aspekti i perspektivës së shtetit ligjor dhe synimit të konsolidimit të demokracisë së mirëfilltë dhe integritetit në BE atëherë mund të përfundojmë se institucionet e shtetit të Ri të Kosovës kanë intensifikuar aktivitetet dhe kanë përmirësuar performancën ku bashkë me ndihmën dhe format e asistimit të institucioneve ndërkombëtare kanë arritur rezultate në identifikimin, zbulimin, argumentim dhe procedimin të rasteve deri në gjykim përfundimtar në fillim dhe gjatë tërë vitit 2015, gjë që krahasuar me vitin 2014 vërehet një sukses i dukshëm në luftimin e dukurisë së keqpërdorimit të detyrës zyrtare si kategori e veçantë e veprave penale dhe luftimin e korrupsionit si një kategori emblematike e keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

REKOMANDIME

Nga gjetjet e këtij hulumtimi, në fund mund të rekomandojmë si në vijim:

1. Rekomandojmë një bashkëpunim më të ngjeshur në mes të Policisë , Prokurorisë e Gjykatave si institucione që e kanë mandat primar luftimin dhe parandalimin e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, luftimin e korrupsionit dhe forcimin e rendit dhe ligjit
2. Rekomandojmë Qeverinë e Kosovës dhe institucionet tjera të Republikës së Kosovës për implementimin konsekuent në praktikë të legjislacionit penal të R. së Kosovës dhe luftimin e nepotizmit e keqpërdorimeve të ndërlidhura me te.
3. Rekomandojmë fushatë edhe më të fuqishme të mediave dhe shoqërisë civile në vetëdijësimin e qytetarëve për një bashkëpunim më të mirë me institucionet e ndjekjes , sensibilizim të opinionit publik për të kontribuar në parandalimin e dukurisë së keqpërdorimit me detyrën zyrtare përmes denoncimit dhe bashkëpunimit të tyre më të ngjeshur me institucionet përkatëse.
4. Rekomandojmë Këshillin Gjyqësor të Kosovës për rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe propozimin për ngritje të pagave, ku do të duhej të llogaritej edhe komponenta e rrezikshmërisë së lartë në përlllogaritjen e pagës.
5. Rekomandojmë Këshillin Prokurorial të Kosovës për shtimin e numrit të prokurorëve dhe propozimin për ngritje të pagave, ku do të duhej të llogaritej edhe komponenta e rrezikshmërisë së lartë në përlllogaritjen e pagës.
6. Rekomandojmë Ministrinë e Drejtësisë dhe Bordin e Institutit Gjyqësor të Kosovës për kthimin e kompetencës ekzekutive të IGJK- së për përgatitjen, trajnimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve të ardhshëm dhe dekretimi i tyre të bëhet pasi të përfundohet trajnimi fillestar dhe pasi të evaluohet performanca e tyre.
7. Rekomandojmë Institutin Gjyqësor të Kosovës që të ridizajnoj programe trajnuese të avansuara në të cilat duhet përfshirë modulën e deontologjisë profesionale, duke ngritur cilësinë e trajnimit në nivel më të lartë me ndihmën e

ekspertëve cilësor të fushave përkatëse e jo domosdo me trajner gjyqtarë të cilët shpeshherë janë të korruptuar dhe jo fleksibil.

8. Rekomandojmë Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe atë Prokurorial, si dhe Zyrën e Prokurorit Disiplinor që të monitorojnë më me kujdes performancën e prokurorëve dhe gjyqtarëve që lufta kundër korrupsionit dhe veprave tjera penale të abuzimit me detyrën zyrtare nga ana e tyre të jetë e pa kompromis dhe strategji afatgjatë e punës së këtyre institucioneve.

Bibliografia

- Abed, G. T., & Gupta, S. (2002). *Governance, Corruption, and Economic Performance*. Washington D.C.: International Monetary Fund.
- Alfred, C., Daniel, T., Bacarese, A., & Hatchard, J. (2011). *Corruption and Misuse of Public Office*. Oxford: Oxford University Press.
- Alighieri, D. (2003). *The Divine Comedy: Purgatorio*. Oxford: Oxford University Press.
- Capussela, A. L. (2015). *State-Building in Kosovo: Democracy, Corruption and the EU in the Balkans*. New York: I.B.Tauris.
- Cassese, A. (2005). *Međunarodno krivično pravo*. Beograd: Štampa.
- Crawford, J., & Koskeniemi, M. (2012). *The Cambridge Companion to International Law*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Deming, S. H. (2014). *Anti-Bribery Laws in Common Law Jurisdictions*. Oxford: Oxford University Press.
- Frederic, L., Dilip, D. K., & Heyer, G. d. (2015). *Economic Development, Crime, and Policing: Global Perspectives*. CRC Press.
- Gounev, P., & Ruggiero, V. (2012). *Corruption and Organized Crime in Europe: Illegal partnerships*. New York: Routledge.
- Hajdari, A. (2014). Corruption in Kosovo Public Administration. *European Academic Research*, 5427-6449.
- Haller, D., & Shore, C. (2005). *Corruption Anthropological Perspectives*. Pluto Press: Londo.
- Hetemi M, Jashari N, (2013) Konventa e Kombeve të bashkuara kundër Korrupsionit me komentim, Prishtinë
- Jansens, J. (2015). *Stete-building in Kosove: A plural policing perspective*. Antwrtpen: Maklu.

- Jeremy Horder, J., & Alldridge, P. (2013). *Modern Bribery Law: Comparative Perspectives*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Johnson, V. E. (2010). *Corruption in William Shakespeare's Hamlet*. Greenhaven Press.
- Johnston, M. (2005). *Civil Society and Corruption: Mobilizing for Reform*. Lanham: University Press of America.
- Jovasevic, D. (2012). *Sluzbena krivicna dela*. Nis: Univerzitet u Nisu.
- Kastrati, B. (2015). *Rastet e korrupsionit në Kosovë gjatë vitit 2014, "peshqit e mëdhenj" të paprekshëm*. Prishtinë.
- Kaṭṭalya. (1987). *Arthashastra*. Rangarajan: Penguin Classics.
- KE. (2015). *Raport i vlerësimit mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare*. Prishtinë: Këshilli i Evropës.
- Mbaku, J. M. (2010). *Corruption in Africa: Causes, Consequences, and Cleanups*. Lanham: Rowman & Littlefield Publishers Inc.
- Noonan, J. T. (1987). *Bribes*. Berkeley: University of California Press.
- Nordio, C. (1997). *Giustizia*. Cantiere Italia.
- Perritt, H. H. (2010). *The Road to Independence for Kosovo: A Chronicle of the Ahtisaari Plan*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Pieth, M., Low, L. A., & Cullen, P. J. (2007). *The OECD Convention on Bribery: A Commentary*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Pradel, J., Corstens, G., & Vermeulen, G. (2009). *E Drejta Penale Evropiane*. Tiranë: Papirus.
- Roehner, N. (2012). *UN Peacebuilding: Light Footprint or Friendly Takeover?* Boca Ration.
- Rotberg, R. I. (2009). *Corruption, Global Security, and World Order*. Cambridge, Massachusetts: World Peace Foundation and American Academy of Arts & Sciences.

- Sadikaj, B. (2010). *Sociologjia e së Drejtës*. Prishtinë.
- Salihu, I. (2011). *E Drejta Penale Ndërkombëtare*. Prishtinë: Universiteti Fama.
- Salihu, I. (2014). *E Drejta Penale (Pjesa e posaçme)*. Prishtinë: Kolegji Fama.
- Salihu, I., Zhitija, H., & Hasani, F. (2014). *Komentar: Kodi Penal i Republikës së Kosovës* (bot. i 1). Prishtinë: Giz.
- Simis, K. M. (1982). *USSR--the Corrupt Society: The Secret World of Soviet Capitalism*. Simon and Schuster.
- Szarek-Mason, P. (2010). *The European Union's Fight Against Corruption*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Shah, A. (2007). *Performance Accountability and Combating Corruption (Public Sector Governance and Accountability)*. Washington D.C.: The World Bank.
- Tanzi, V. (1998). *Corruption Around the World: Causes, Consequences, Scope, and Cures*. International Monetary Fund.
- Tonry, M. (2011). *The Oxford Handbook of Crime and Criminal Justice*. Oxford: Oxford University Press.
- Zaum, D., & Cheng, C. (2012). *Corruption and Post-Conflict Peacebuilding: Selling the Peace?* New York: Routledge.

Burime sekundare

- AKK 2007. (2008). *Raport vjetor*. Prishtinë: Agjencia Kundër Korrupsion e Kosovës.
- AKK 2008. (2009). *Raport vjetor*. Prishtinë: Agjencia Kundër Korrupsion e Kosovës.
- AKK 2009. (2010). *Raport Vjetor*. Prishtinë: Agjencia Kundër Korrupsion e Kosovës.
- AKK 2010. (2011). *Raport Vjetor*. Prishtinë: Agjencia Kundër Korrupsion e Kosovës.
- AKK 2011. (2012). *Raport Vjetor*. Prishtinë: Agjencia Kundër Korrupsion e Kosovës.
- AKK 2012. (2013). *Raport Vjetor*. Prishtinë: Agjencia Kundër Korrupsion e Kosovës.

AKK. (2012). *Analizë mbi ndjekjen dhe gjykimet e rasteve korruptive në Kosovë*.
Prishtinë: Agjencia kundër Korrupsionit.

AKK 2013. (2014). *Raport Vjetor*. Prishtinë: Agjencia Kundër Korrupsion e Kosovës.

AKK. (2013). *Analizë mbi ndjekjen dhe gjykimet e rasteve korruptive në Kosovë*.
Prishtinë: Agjencia kundër Korrupsionit.

AKK 2014. (2015). *Raport Vjetor*. Prishtinë: Agjencia Kundër Korrupsion e Kosovës.

Korniza Kushtetuese. (2002). *Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme*.
Prishtinë.

Kushtetuta. (2008). *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Kuvendi i
Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Kosovës. (2004). *Ligji kundër korrupsionit*. Prishtinë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011). *Ligj për deklarimin, prejardhjen dhe
kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe
kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011). *Ligj për parandalimin e konfliktit të interesit
në ushtrimin e funksionit publik*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011). *Ligji për mbrojtjen e informatorëve*.
Prishtinë: Gazeta Zyrtare.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011). *Ligji për përgjegjësinë e personave juridik
për vepra penale*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2012). *Kodi i Procedurës Penale*. Prishtinë: Gazeta
Zyrtare.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2012). *Ligji për Policinë*. Prishtinë. Gjetur në
http://www.kosovopolice.com/repository/docs/Ligji_i_Policise1.pdf

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2013). *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*. Prishtinë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2013). *Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2014). Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Prishtinë: Gazeta Zyrtare.

PPRK 2007. (2008). *Raporti vjetor për punën e Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës për vitin 2007*. Prishtinë.

PPRK 2008. (2009). *Raporti vjetor për punën e Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës për vitin 2008*. Prishtinë.

PPRK 2009. (2010). *Raporti vjetor për punën e Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009*. Prishtinë.

PPRK 2010. (2011). *Raporti vjetor për punën e Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010*. Prishtinë.

PPRK 2011. (2012). *Raport për punën e prokurorit të shtetit të Republikës së Kosovës 2011*. 2011.

Prokurori i Shtetit. (2013). *Raport Vjetor 2012*. Prishtinë.

Prokurori i Shtetit. (2014). *Raport Vjetor 2013*. Prishtinë.

Prokurori i Shtetit. (2015). *Raport Vjetor 2014*. Prishtinë.

Przetacznik, F. (1983). *Protection of Officials of Foreign States According to International Law*. The Hague: Kluwer Academic Publishers Group.

Raporti i Policisë 2008. (2009). *Raporti vjetor i Policisë së Kosovës 2008*. Prishtinë.

Raporti i Policisë 2011. (2012). *Raporti vjetor i Policisë së Kosovës 2011*. Prishtinë.

Raporti i Policisë 2012. (2013). *Raporti vjetor i Policisë së Kosovës 2012*. Prishtinë.

Raporti i Policisë 2013. (2014). *Raporti vjetor i Policisë së Kosovës 2013*. Prishtinë.

Raporti i Policisë 2014. (2015). *Raporti vjetor i Policisë së Kosovës 2014*. Prishtinë.

UNMIK/Rreg/2003/25. (2003). *Kodi i përkohshëm penal i Kosovës*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare.

UNODC. (2004). *United Nations Convention against corruption*. New York: United Nations.

UNODC. (2014). *Integriteti gjyqësor në Kosovë*. Vjenë: Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër drogë dhe krimit.

Burimet terciare

Balkan Insight. (2014, 12 03). Kosovo, Albania ‘Most Corrupt Countries in Region’.

Gjetur në <http://www.balkaninsight.com/en/article/ti-kosovo-and-albania-worst-corrupt-countries-in-the-region>

Bota Sot. (2014). Institucionet e drejtësisë, me efikasitet të ulët kundër luftimit të korrupsionit. Prishtinë.

Code Penal. (1791). Code Penal. Paris. Gjetur në

http://ledroitcriminel.free.fr/la_legislation_criminelle/anciens_textes/code_penal_25_09_1791.htm

European Commision. (2014, October). Kosovo* Progress Report. Gjetur në

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

FOL. (2013). *Monitoruesi i Korrupsionit*. Prishtinë: Lëvizja FOL.

IPK. (2014). Inspektorati Policor i Kosovës: Raport Vjetor 2014. Prishtinë. Gjetur në

<http://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/02/Raporti-vjetor-2014.pdf>

JIWP. (1983). Montreal Declaration, The Universal Declaration on The Independence of Justice. Montreal. Gjetur në <http://www.jiwp.org/#!/montreal-declaration/c1bue>

- Kazneni Zakon. (2013). Zagreb: Narodne Novie. Gjetur në <https://pravosudje.gov.hr/UserDocsImages/dokumenti/Kazneni%20zakoneslu%C5%BEbeni%20pro%C4%8Di%C5%A1%C4%87eni%20tekst.pdf>
- KIPRED. (2014). *Hetimi i Korrupsionit në Kosovë*. Prishtinë: KIPRED.
- Koha Ditore. (2011, 12 09). Për keqpërdorim të detyrës zyrtare 20 të akuzuar. Prishtinë. Gjetur në <http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=80059>
- Koha Ditore. (2015, 02 15). Lëndët për korrupsion zvarriten më së shumti në Gjykata. Prishtinë. Gjetur në <http://koha.net/?id=27&l=44918>
- KGJK. (2015). Raport Vjetor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (2014). Prishtinë. Gjetur në http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Raporti-Vjetor-2014-Shqip_813901.pdf
- Musliu, B. (2014). Raport vlerësues gjithëpërfshirës mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit. Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi.
- Prizren Press. (2015). Reagon Gjykata në Prizren: Abdullah Thaçi u dënua për zbulim të fshetësisë. Prizren. Gjetur në <http://prizrenpress.com/lajme/reagon-gjykata-ne-prizren-abdullah-thaci-u-denua-per-zbulim-te-fshetesise/>
- Sluzbeni List. (1948). Zakon o krivicnim delima protiv sluzbene duznosti. Beograd. Gjetur në <http://www.e-glasnik.rs/SIGlasnikPortal/viewdoc?uuid=ce7906cf-5383-4071-a406-dbe7006da58c>
- Strafgesetzbuch. (1871, 05 15). Berlin. Gjetur në <http://www.gesetze-im-internet.de/bundesrecht/stgb/gesamt.pdf>
- Transparency International. (2014). Corruption Perceptions Index 2014: Results. Gjetur në <http://www.transparency.org/cpi2014/results>
- Tryeza Tematike. (2013). Tryeza Tematike nr. 2 (për Drejtësi, Liri dhe Siguri). Prishtinë: Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës.

UN. (1946). Affirmation of the Principles of International Law recognised by the Charter of the Nüremberg Tribunal. Resolution 95 (I) of the United Nations General Assembly, 11 December 1946. ICRC. Gjetur në <https://www.icrc.org/applic/ihl/ihl.nsf/Treaty.xsp?documentId=53D11A6719F4627BC12563CD002D6ACA&action=openDocument>